

**RAPORTI PËRFUNDIMTAR**

**I**

**KOMISIONIT PËR KËRKESA**

**PRONËSORE DHE BANESORE**



**2007**  
**Prishtinë**

## **TABELA E PËRMBAJTJES**

Parathënie  
Përmbledhja Ekzekutive  
Tabela e Legjislacionit  
Tabela e Shkurtesave

### KAPITULLI 1

HISTORIATI I THEMELIT TË KOMISIONIT PËR KËRKESA PRONËSORE DHE BANESORE

- 1. Historiati dhe Zhvillimet në Kosovë**
- 2. Intervenimi i NATO-së**
- 3. Përgjigjja e UNMIK-ut në Krizat e Çështjes së Banimit dhe të Pronës në Kosovë**

### KAPITULLI 2

KOMISIONI PËR KËRKESA PRONËSORE DHE BANESORE

- 1. Themelimi**
- 2. Jurisdiksioni**
- 3. Përbërja dhe Anëtarësia**
- 4. Seancat e HPCC-së**

### KAPITULLI 3

DISPOZITA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE ADMINISTRATIVE DHE LIGJORE PËR HPCC-në

**1. Udhëheqja dhe Mbështetja Administrative**

**2. Mbështetja Ligjore**

**3. Marrëdhëniet me UNMIK-un**

KAPITULLI 4

KORNIZA LIGJORE E APLIKUAR DHE PROCEDURAT

**1. Ligji i Aplikueshëm në Kosovë**

**2. Ligji i Aplikuar në Zgjidhjen e Kërkesave Pronësore**

- (i) Rregulloret e UNMIK-ut
- (ii) Rregullat dhe Udhëzimet Plotësues të HPCC-së
- (iii) Ligjet vendore
- (iv) Korniza e aplikueshme e të Drejtave të Njeriut

KAPITULLI 5

MBLEDHJA DHE REGJISTRIMI I KËRKESAVE

**1. Formulari i kërkesës**

**2. Procedura mbi Paraqitjen e kërkesave**

**3. Statistikat mbi Numrin e Kërkesave të Regjistruara**

**4. Njoftimi mbi Kërkesat dhe Publikimi**

KAPITULLI 6

HETIMI I NDËRMARRË DHE PËRPUNIMI I KËRKESAVE

**1. Shqyrtimi Fillestar**

**2. Shqyrtimi i Pavarur**

- 3. Qasja në të Dhënat Pronësore dhe Verifikimi i Dokumenteve**
- 4. Hartimi i Parashtrësive Ligjore të Kërkesave për HPCC-në**
- 5. Tërheqja e Kërkesave**
- 6. Përpunimi i Kërkesave në HPCC dhe Roli i Kryesekretarisë**

## KAPITULLI 7

### VENDIMET E HPCC-së

- 1. Procedurat e aplikueshme**
  - (i) Sasia e Kërkesave të Proceduara**
  - (ii) Procedurat e Evidentimit**
  - (iii) Delegimi i Autoritetit për Shqyrtim të kërkesave**
- 2. Procedurat para HPCC**
- 3. Vendimet e HPCC-së**
- 4. Forma e Vendimeve**
- 5. Urdhërat dhe mjetet ligjore të HPCC-së**
- 6. Përmirësimi i Gabimeve Administrative në Procesin e Vendimmarrjes**

## KAPITULLI 8

### DËRGIMI DHE IMPLEMENTIMI I VENDIMEVE TË HPCC-së

- 1. Dërgimi i Vendimeve**
- 2. Publikimi i Vendimeve**
- 3. Procedura për Implementimin e Vendimeve**

## KAPITULLI 9

### KËRKESAT PËR RISHQYRTIM

- 1. Procedura dhe Bazat për të Paraqitur Kërkesat për Rishqyrtim**
- 2. Përpunimi i Kërkesave për Rishqyrtim**
- 3. Numri dhe Natyra e Kërkesave të Paraqitura për Rishqyrtim**

## **KAPITULLI 10**

### VËRETJEJT PËRFUNDIMTARE

### **ANEKSET**

ANEKSI I: Profili i Anëtarëve të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore

ANEKSI II: Rregullorja e UNMIK-ut 1999/23 mbi Themelimin e Drejtoratit për Çështje Pronësore dhe Banesore dhe të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore;  
Rregullorja e UNMIK-ut 2000/60 mbi Rregullat e Procedurës dhe Dëshmime për Drejtoratin për Çështje Pronësore dhe Banesore dhe për Komisionin për Kërkesa Pronësore dhe Banesore.

ANEKS III: Rregullat Plotësuese të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore.

ANEKS IV: Drejtorët Ekzekutiv të HPD-së dhe Kryesekretarët.

ANEKS V: Statistikat e Kërkesave dhe Vendimet.

## TABELA E LEGJISLACIONIT

1. Rregullorja e UNMIK-ut 1999/23 mbi Themelimin e Drejtoratit për Çështje Pronësore dhe Banesore dhe të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore
2. Rregullorja e UNMIK-ut 2000/60 mbi Rregullat e Procedurës dhe Dëshmisë për Drejtoratin për Çështje Pronësore dhe Banesore dhe për Komisionin për Kërkesa Pronësore dhe Banesore.
3. Qartësimi nga PSSP mbi Rregulloren e UNMIK-ut 2000/60 të datës 31 Tetor 2000.
4. Urdhëresa Administrative 2000/45 mbi Implementimin e Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 mbi Themelimin e Drejtoratit për Çështje Pronësore dhe Banesore dhe të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore.
5. Ligji mbi Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, Nr. 11/83, 29/86, 42/86)
6. Ligji mbi Bashkë-pronësinë mbi Apartamentet (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, Nr. 43/80, 22/87)
7. Ligji mbi Ndërtimin e Anekseve të Ndërtesave dhe Shndërrimi i Objekteve të Përbashkëta në Apartamente (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, Nr. 14/88).
8. Ligji mbi Bartjen e Patundshmërisë (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, Nr. 45/81, 29/86, 26/88)
9. Ligji mbi Regjistrimin e Patundshmërisë me Pronësi Shoqërore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, Nr. 37/71)
10. Ligji mbi Kushtet e Veçanta të Aplikueshme në Transaksionet e Pronës së Patundshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë, Nr. 30/89)
11. Ligji mbi Banimin të vitit 1992 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë, Nr. 50/92)

## **TABELA E SHKURTESAVE**

CCPU	Njësiti Qëndror i HPD-së për Përpunimin e Lëndëve
CRPC	Komisioni për Kërkesat mbi Patundshmërinë për Personat e Zhvendosur dhe Refugjatët në Bosnjë e Hercegovinë
DCA	Departamenti i Administratës Civile, UNMIK
DPKO	Departamenti i Operacioneve për Ruajtjen e Paqes i Kombeve të Bashkuara
ECHR	Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive themelore të Njeriut
EU	Bashkimi Evropian
EAR	Agjencioni Evropian për Rindërtim
FRY	Republika Federale e Jugosllavisë
fYROM	ish Republika Federale e Maqedonisë
HPD	Drejtorati për Çështje Pronësore dhe Banesore
HPCC	Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore
IDPs	Personat Përkohësisht të Zhvendosur
KCA	Agjencioni Kadastral i Kosovës, IPVQ
KCB	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
KFOR	Forca e Kosovës, NATO
KPA	Agjencia Kosovare e Pronës
KPCC	Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës
KPS	Shërbimi Policor i Kosovës, UNMIK
KTA	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, UNMIK
NATO	Organizata e Traktatit Veri Atlantik
NGO	Organizata Jo-Qeveritare
OLA	Zyra e Këshilltarit Ligjor, UNMIK
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

PISG	Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse
SC	Këshilli i Sigurimit
SRS	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara
UN	Kombet e Bashkuara
UNCHS	Qendra e Kombeve të Bashkuara për Vendbanime të Njerëzve
UNOPS	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime Projektuese
UN-Habitat	Programi i Kombeve të Bashkuara për Vendbanime të Njerëzve
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNOB	Zyra e Kombeve të Bashkuara në Beograd



## PARATHËNIE

Kosova ka qenë një prej vendeve pas-konfliktuozë deri më sot në të cilin Kombet e Bashkuara janë marrë intenzivisht në kthimin e pronës, duke themeluar dhe duke i dhënë mandatin organit të pavarur për të zgjidhur kontestet pronësore dhe zbatimin e të drejtave pronësore jashtë kornizës së sistemit vendor të drejtësisë.<sup>1</sup>

Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore është organ i pavarur quasi-gjyqësor i themeluar nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) në nëntor 1999. Iu ishte dhënë mandati të siguroj zgjidhje të suksesshme dhe efikase të kontesteve mbi pronën e banimit që rrjedhin nga konflikti i armatosur në Kosovë gjatë vitit 1999. HPCC ka filluar shqyrtimin e kërkesave në janar 2001 dhe deri në kohën e përgatitjes së këtij raporti, në mënyrë të suksesshme ka përmbushur mandatin e tij; për rreth 29,000 konteste pronësore janë vendosur, dhe deri më tani 98.5% të vendimeve të HPCC-së janë implementuar në favor të bartësve të së drejtës pronësore. Kjo është arritje e rëndësishme dhe është dhënë kontribut i rëndësishëm në ndihmën e ofruar bartësve të së drejtës të pronës të shpronësuar për të marr riposedimin e shtëpive të tyre. Gjithashtu është dhënë kontribut në idealet e përkrahura në Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244 (SC1244) dhe ka kontribuar në rehabilitimin e konfliktit. Zgjidhja e kërkesave për shtëpitë e refugjatëve dhe të personave të zhvendosur në Kosovë ka siguruar që mijëra paraqitësve të kërkesës dhe familjeve të tyre, të cilët ishin shpronësuar nga shtëpitë e tyre si rezultat i diskriminimit apo zhvendosjes, u është dhënë mundësia të kthehen në shtëpi, apo të shesin pronat e tyre në pajtim me ligjin, duke përmbushur njërin nga synimet kryesore të dhënë në Këshillin e

---

<sup>1</sup> Gjersa një mekanizëm i ngjashëm gjithashtu ishte themeluar si pasojë e luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë, ky mekanizëm ishte bazuar në Marrëveshjen e Dayton-it dhe KB nuk ishin të përfshira drejtpërdrejt në implementimin e saj. Ka gjithashtu dallime themelore në kornizën legislative.

Sigurimit 1244 dhe Rregulloren e UNMIK-ut 1999/23 duke themeluar procesin e HPCC-së.

## **Përmbledhje Ekzekutive**

Ky raport është përgatitur nga Komisioni i Kërkesave Pronësore dhe Banesore (HPCC) dhe përmban një raport të gjerë të punës së HPCC-së lidhur me zgjidhjen e kërkesave pronësore të cilat janë në juridiksionin e tij të veçantë. Ai përshkruan historiatin në themelimin e HPCC-së dhe përshkruan mandatin, përbërjen dhe funksionet e tij. Mbulesë gjithëpërfshirëse i është dhënë kornizës ligjore që ka udhëhequr zgjidhjen e kërkesave pronësore. Raporti është dokument administrativ dhe si i tillë nuk ka për qëllim të ofroj ndonjë sqarim apo koment mbi vendimet e marra nga HPCC në kapacitetin e vet quasi gjyqësor. HPCC dëshiron të falenderoj Znj. Margaret Cordial BL (Juriste e Diplomuar) për ndihmën e saj në përgaditjen e raportit dhe HPD-së për verifikim të informatës statistikore.

Kapitulli 1 paraqet historiatin në themelimin e procesit të HPCC-së. Në të përshkruhen zhvillimet historike në Kosovë që nga humbja e autonomisë në vitin 1989 deri në miratimet legjislative në fillim të viteve 1990 e cila ka imponuar kufizimet në gëzimin e të drejtave pronësore duke pasur ndikim në grupe të ndryshme etnike. Në të merret parasysh mjedisi i cili ishte prezentuar në Kosovë në Qershor 1999, dhe një mori të sfidave komplekse ligjore dhe çështje të sundimit të ligjit, përfshirë sfidat e të drejtës pronësore, me të cilat UNMIK-u ishte ballafaquar. Në të shqyrtohet mandati i dhënë në Administratën e Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (“UNMIK”) dhe Forcën Kosovare (“KFOR”) e cila përfshiu përgjegjësinë për të ofruar siguri dhe kthim të lirë të të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur nëpër shtëpitë e tyre.

Kapitulli 2 përshkruan shqyrtimin e jurisdiksionit të HPCC-së për zgjidhjen e kërkesave për pronat e banimit dhe kapitulli 3 përshkruan rolin e Drejtoratit për Çështje Pronësore dhe Banesore (HPD) i cili ka pasur mandat të mbledhë kërkesat dhe t'i ofrojë shërbime mbështetëse juridike dhe administrative HPCC-së.

Kapitulli 4 përshkruan kornizën ligjore që është me rëndësi në zgjidhjen e kërkesave dhe specifikon dispozitat kyçe procedurale dhe materiale siç janë përcaktuar në Rregulloret e UNMIK-ut dhe ligjet shtesë, ligjet vendore, udhëzimet e HPCC-së dhe standardet ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut.

Kapitulli 5 dhe 6 shqyrton pranimin e kërkesave dhe natyrën dhe numrin e kërkesave të mbledhura. Ato përshkruajnë procesin e para marrjes së vendimit, që ka pasur të bëjë me shqyrtimin e kërkesave, njoftimi i palëve, verifikimin e dokumenteve dhe hartimi i parashtrësive dhe rekomandimeve ligjore. Procedura e cila rregullon përpunimin e kërkesave, udhëzimet e HPCC-së dhe jurisprudencën janë shqyrtuar gjithashtu.

Kapitulli 7 përshkruan procesin e marrjes së vendimit. Në të shqyrtohen rregullat e procedurës së HPCC-së dhe teknikat e miratuara për t'u marrë me sasinë vuluminoze të rasteve. HPCC duhej të siguronte përpunimin e lëndës dhe në të njëjtën kohë shpejtësinë dhe efikasitetin lidhur me shqyrtimin e kërkesave. Format i vendimeve dhe urdhërave, ndihma shtesë dhe mjetet ligjore të cilat mund të aprovoheshin lidhur me secilën kategori të kërkesës, shqyrtohen në detaje në këtë kapitull, gjithashtu.

Kapitulli 8 fokusohet në implementimin e vendimeve të HPCC-së, gjë që ishte në kompetencë të HPD-së. Procesi ishte pajisur me fuqi për implementim dhe për t'u marrë me uzurpim ilegal të pronës dhe të zbatojë në tërësi dhe të sigurohet pëlqimi ndaj vendimeve detyruese ligjore. Procesit të HPCC-së/HPD-së në mënyrë eksplicite iu ishte lejuar që nën legjislacionin e tij të implementoj vendimet përfundimtare dhe detyruese, dhe të bëjë këtë përmes ekzekutimit të urdhërave të dëbimit, aty ku është e nevojshme. Ky kapitull shqyrton aplikimin e këtyre teknikave implementuese të cilat kanë përfshirë dëbimin e banuesve të paligjshëm, apo duke e vënë pronën nën administrim të

përkohshëm. Statistikat e detajuara mbi implementimin e vendimeve të HPD-së/HPCC-së gjithashtu janë përfshirë.

Kapitulli 9 shqyrton procedurën rishqyrtuese nga perspektiva e përpunimit dhe shqyrtimit të kërkesave për rishqyrtim të vendimeve të HPCC-së.

Kapitulli 10 përmban vërejtjet përfundimtare të anëtarëve të HPCC-së mbi procesin dhe rekomandon zhvillimin e një kornize të qartë institucionale dhe të politikave për adresimin e të gjitha çështjeve pronësore legjitime, dhe duke siguruar barazi në trajtimin e paraqitësve të kërkesave të cilët kanë pësuar shkelje të të drejtave pronësore në situatën e pas-konfliktit.

## KAPITULLI 1

### HISTORIATI NË THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR KËRKESA PRONËSORE DHE BANESORE

#### 1. Historiati dhe Zhvillimi historik në Kosovë

Kosova ishte njëra nga tetë njësit përbërëse të ish Jugosllavisë. Me Kushtetutën e Jugosllavisë të vitit 1974 ishte shpallur të jetë krahinë autonome e Serbisë me administratën, kuvendin dhe gjyqësinë e vet, dhe ishte anëtare e të dyja institucioneve federale të Serbisë dhe Jugosllavisë.

Si rezultat i shtetëzimit në vitin 1945, prona ishte deklaruar shoqërore dhe shumë tokë dhe pronë private ishte bartur tek Ndërmarrjet Shoqërore (SOEs). Ashtu që në vitin 1999, 43% e pronës ishte pronë jo-private, duke qenë ose pronë shoqërore (e cila i takonte ndërmarrjeve shoqërore) apo të zotëruara nga shteti (përfshirë tokat të cilat ju takonin komunave dhe qeverisë qendrore për shërbime publike siç janë rrugët, shkollat, spitalet, etj.). Prona private, e cila përbënte 57% (që ju takonte personave fizik, kompanive dhe entiteteve fetare),<sup>2</sup> përbëhej nga pronat të cilat nuk ishin shtetëzuar dhe apartamentet me pronësi shoqërore të cilët ishin privatizuar sipas Ligjit mbi Banim të vitit 1992.<sup>3</sup>

---

<sup>2</sup> Kishte numër të vogël të apartamenteve private, përfshirë ato të cilat nuk ishin shtetëzuar gjatë viteve të 1950-së apo 1960-së, dhe apartamentet shoqërore të cilët ishin privatizuar para konfliktit, sipas dispozitave të Ligjit mbi Banimin të vitit 1992 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë Nr. 50/92). Për vlerësim të detajuar dhe real të pronës me pronësi shoqërore shih Perritt H., Zgjidhja e Kërkesave kur Shtetet janë Shpërbërë: Sfida e Kosovës, në Voll. 80, Chicago-Kent Shqyrtimi i Ligjit, 119 (2005).

<sup>3</sup> Ligji mbi Banimin, Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë, Nr. 50/92 (tash e tutje “Ligji mbi Banimin”). Shih raportin e Bankës Botërore, i titulluar “Të Drejtat mbi Tokën dhe Pronat në Kosovë”, 2006.

Prona e banimit ishte përfshirë në dy kategori kryesore: shtëpi familjare private të veçanta të cilat gjendeshin kryesisht në periferi të qyteteve dhe në zonat rurale, dhe apartamentet shoqërore të cilat deri në fillim të viteve 1990-ta kanë përbërë burimin kryesor të strehimit banesor. Këto apartamente ishin ndërtuar dhe administruar gjithashtu nga SOEs dhe Ndërmarrjet me Pronësi Publike (POEs) dhe u ishin ndarë të punësuarve të këtyre ndërmarrjeve me qëllim të përmbushjes së nevojave të tyre të banimit, dhe ishin financuar përmes kontributeve të detyruara nga të ardhurat e të punësuarve.

Të punësuarve u kishin dhënë të drejtën e përhershme për shfrytëzim të këtyre apartamenteve, e njohur si “të drejtat e banimit”, e cila ishte e drejtë e parashikuar me statut që kishte rrjedhur nga Ligji mbi Marrëdhëniet e Banimit.<sup>4</sup> E drejta e banimit ishte e drejtë më e vogël se e drejta e pronësisë, por shumë më shumë se e drejta e dhënies me qira.<sup>5</sup> E drejta e banimit ka mundur të anulohet vetëm në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Banimit.<sup>6</sup> Ky regjim kryesisht u ka përmbushur nevojat e banimit të gjitha grupeve etnike nga vendet urbane deri në humbjen e autonomisë në vitin 1990. Vetëm në vitin 1992 ishte paraqitur privatizimi me miratimin e Ligjit mbi Banim, i cili i ka lejuar bartësve individual të së drejtës së banimit të blejnë apartamentet e tyre, duke e shndërruar të drejtën e tyre të banimit në të drejtën plotësisht të transferuar pronësore.<sup>7</sup>

Me 23 Mars 1989 ndryshimet kushtetuese lejuan Beogradin të ketë kontroll në punët e brendshme të Kosovës, duke ia hequr përfundimisht të drejtën e vetëqeverisjes që e kishte sipas Kushtetutës së Jugosllavisë, dhe e shndërron në pjesë integrale të Republikës së Serbisë.<sup>8</sup> Popullata Shqiptare e Kosovës ka demonstruar kundër humbjes së autonomisë duke organizuar grevë masive.<sup>9</sup> Republika Socialiste e Serbisë ka reaguar me 22 Mars

---

<sup>4</sup> Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr. 11/83, 29/86, 42/86.

<sup>5</sup> Për më tutje shih dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Banimit, Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr. 11/83, 29/86, 42/86.

<sup>6</sup> E drejta e banimit ka mundur të ndërpritet kur bartësi i së drejtës së banimit ka dështuar të shfrytëzoj apartamentin për nevojat e tij apo saj të banimit pandërprerë për periudhë kohore prej gjashtë (6) muajsh apo më tepër, pa baza të arsyeshme. Bazat e arsyeshme kishin përfshirë shërbimin ushtarak, mbajtjen e detyrimit të burgut, punën jashtë vendit, apo mungesës për shkollim apo trajtim mjekësor, shih Nenin 47, LMB. Sipas LMB, një ndërprerje e tillë ka mundur të bëhet me largimin nga puna për shkak të shkeljes serioze të detyrës apo për vepër penale. Megjithatë, largimi nga puna në Kosovë ishte i rrallë dhe kjo dispozitë rrallë ishte përdorur për këtë qëllim. Me përmbushjen e dhjetë (10) viteve të punësimit në ndërmarrje apo njëzet (20) viteve në përgjithësi, e drejta e banimit nuk ka mundur të revokohet në asnjë rrethanë. Asnjë nuk ka mundur të ketë më shumë se një të drejtë të banimit apo të ketë ndërtesë tjetër të banimit gjersa ishte bartës i së drejtës së banimit.

<sup>7</sup> Çmimi blerës ishte paguar nga kontributi i bartësve të së drejtës së banimit dhënë në fondin e banimit gjatë jetës së tij apo saj.

<sup>8</sup> Shih gjithashtu raportin e Misionit të OSBE-së në Kosovë të titulluar “Kosovo/Kosova: Si është parë si është thënë”; në faqen 27; Raporti i Komisionit të Pavarur Ndërkombëtar në Kosovë i titulluar “Raporti mbi Kosovën”, Tetor 2000. Komisioni, i cili ishte udhëhequr nga Justice Richard Goldstone, Gjykatës i Gjykatës Kushtetuese të Afrikës Jugore, ka ekzaminuar zhvillimet kryesore para, gjatë dhe pas konfliktit të armatosur në rajon të vitit 1999. Komisioni ishte bërë me iniciativën e Kryeministrit të Suedisë. Z. Goran Persson, dhe ishte miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, i mundshëm në [www.kosovocommission.org](http://www.kosovocommission.org).

<sup>9</sup> Shih raportin e Komisionit të Pavarur Ndërkombëtar, *op. cit.* shënimi 8 në faqen 14 dhe raportin e Misionit të OSBE-së në Kosovë, *op. cit.* shënimi 8 në faqen 27.

1990 duke paraqitur një mori të ligjeve<sup>10</sup> dhe masave administrative të njohura si “masat e dhunshme”<sup>11</sup> të cilat kanë rezultuar me shkarkimin e shumë Shqiptarëve të Kosovës nga pozitat e tyre në kompanitë publike dhe më vonë në humbjen e të drejtave të tyre pronësore mbi apartamentet shoqërore,<sup>12</sup> të cilat më vonë u ishin rindarë Serbëve të Kosovës.<sup>13</sup> Si rezultat i këtyre zhvillimeve kryesisht ishin bartësit Serb të së drejtës së banimit të cilët ishin në pozitë që të drejtën e tyre të banimit të shndërrojnë në pronësi duke e blerë apartamentin nga bartësi i së drejtës së ndarjes sipas procesit të privatizimit të paraparë me Ligjin mbi Banim të vitit 1992.<sup>14</sup> Si plotësim, në vitin 1991 legjislacioni i dizajnuar të kufizojë transaksionet e pasurisë së patundshme ishte miratuar, saktësisht Ligji për Ndryshim dhe Shtesa në Kufizimin e Transaksioneve të Pasurisë së Patundshme.<sup>15</sup> Dispozitat e saj kanë kërkuar që çdo kontratë mbi shitblerjen, qiranë dhe shitjen e patundshmërisë në Kosovë të aprovohet nga Drejtorati për Çështjet e së Drejtës Pronësore në Ministrinë e Financave të Republikës së Serbisë. Ministria ka mundur të refuzoj për të aprovuar shitjen po të shqyrtonte se do të mund të ndikonte në “*strukturën nacionale të popullatës*” apo në “*emigrimin e anëtarëve të nacionalitetit të “caktuar”...*”. Ky ligj e kishte synim dhe qëllim të kufizoj shitjen e pronave nga Serbët e Kosovës tek Shqiptarët e Kosovës, që kishte për qëllim për t’u siguruar që numri i popullatës Serbe të mos zvogëlohet.<sup>16</sup> Rreth 98% e transaksioneve të prezantuara Ministrisë së Financave raportohet të jenë refuzuar me këtë arsye.<sup>17</sup> Shumë qytetar duket t’i jenë shmangur këtyre masave legjislative dhe kanë bërë transaksione jozyrtare të paregjistruara të cilat nuk ishin regjistruar në të dhënat kadastrale apo të pronës. Kjo praktikë, e cila ka vazhduar deri në vitin 1999, gradualisht ka ndikuar që sistemi i regjistrimit kadastral dhe i pronës të jetë i dyshimtë.<sup>18</sup>

## 2. Intervenimi i NATO-së

Meqë konflikti etnik në vitin 1999 ishte zgjeruar në tërë Kosovën, kishte rezultuar me largimin e 800,000 Shqiptarëve të Kosovës nga shtëpitë e tyre.<sup>19</sup> Pasi që negociatat mbi

---

<sup>10</sup> Për shembull, Ligji mbi Qarkullimin e Patundshmërisë në Kushte të Veçanta, Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë, Nr. 30/89.

<sup>11</sup> I ashtuquajtur Programi për Zbatimin e Paqes, Lirisë, Barazisë, Demokracisë dhe Prosperitetit në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës.

<sup>12</sup> *Ibid.*

<sup>13</sup> Shih raportin e Misionit të OSBE-së në Kosovë “*Krizat e Pashmangshme Pronësore në Kosovë*” 25 Shtator 2000; Leckie, S., “Sfida e ardhshme e Kosovës: Rregullimi i Rrëmujës së Banimit”, Tribuna për të Drejtat e Njeriut, Dhjetor 1999, Vol. 6, Nr. 4.

<sup>14</sup> Shumica e apartamenteve të privatizuara më vonë i janë shitur palës së tretë, çështje të cilën procesi i kthimit duhet ta ketë parasysh, shih nenin 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>15</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste të Serbisë 22/91, 18 Prill 1991. Njoftohu gjithashtu për Ligjin mbi Kushtet, Mënyrat dhe Procedurat e Aprovimit të Tokës Bujqësore për Qytetarët e Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë; Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste të Serbisë 43/91.

<sup>16</sup> Leckie, S., *op. cit.*, shënimi 13.

<sup>17</sup> Leckie, S., *op. cit.*, shënimi 13.

<sup>18</sup> Shih raportin e misionit të OSBE-së në Kosovë, *op. cit.*, shënimi 8.

<sup>19</sup> Shih Raportin e Sekretarit të Përgjithshëm për UNMIK-un, UN SCOP, Seanca e 54-të, UN Doc. S/1999/779 (1999); raporti i misionit të OSBE-së në Kosovë, *op. cit.*, shënimi 8. Ata ishin zhvendosur në kampet e refugjatëve në vendet fqinje, kryesisht në Shqipëri dhe në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë (tash e tutje “IRJM”), gjersa disa përmes linjave ajrore kishin shkuar në disa shtete anëtare të BE-së, SHBA-së dhe Kanada.

paqen në Rambouillet kishin dështuar,<sup>20</sup> me 24 Mars 1999 NATO kishte filluar fushatën e bombardimit kundër Republikës Federative të Jugosllavisë. Fushata e bombardimit kishte mbaruar me 10 Qershor 1999 me nënshkrimin e Marrëveshjes Tekniko-Ushtarake,<sup>21</sup> dhe miratimin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të KB 1244 (“SC1244”).<sup>22</sup> Hyrja në Rezolutë ka ripërsëritur angazhimin e komunitetit ndërkombëtar në sovranitetin dhe integritetin e RFJ-së, si dhe thirrjet për autonomi substanciale dhe kuptimplotë të vet-qeverisjes së Kosovës. Këshilli i Sigurimit (SC)1244 ka autorizuar prezencën civile ndërkombëtare në Kosovë, të quajtur Misioni i Përkohshëm i Administrativ së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (“UNMIK”) dhe prezencën ndërkombëtare të sigurisë në Kosovë, Forcën e Kosovës (“KFOR”).<sup>23</sup>

Mandati i dhënë UNMIK-ut ishte i pashembullt sipas natyrës dhe detyrave dhe kompleksitetit kur krahasohet me mandatin e operacioneve tjera të mëhershme paqësore të KB-së.<sup>24</sup> Iu ishte dhënë fuqi ekzekutive dhe legjislativ dhe mandat për të themeluar prezencën civile ndërkombëtare e cila do të ofronte administrim të brendshëm në Kosovë deri në arritjen e zgjidhjes afatgjate politike.<sup>25</sup> KFOR-i, i udhëhequr nga Organizata e Traktatit Veri-Atlantik (“NATO”), ishte përgjegjës për sigurimin e paqes dhe ambientit të sigurt në Kosovë, dhe për mbështetjen e punës së prezencës civile ndërkombëtare.<sup>26</sup> Këshilli i Sigurimit (SC) 1244 kishte emruar Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së (“PSSP”) për të drejtuar dhe kontrolluar implementimin e SC 1244.<sup>27</sup> I gjithë autoriteti legjislativ dhe ekzekutiv iu ishte dhënë UNMIK-ut dhe ekzekutohej nga PSSP-ja.<sup>28</sup>

Këshilli i Sigurimit (SC) 1244 i ka bërë disa rekomandime në të drejtën e refugjatëve dhe personave të zhvendosur për t’u kthyer në shtëpitë e tyre. Rezoluta ka përcaktuar “*të zgjidh situatën e rëndë humanitare në Kosovë*”<sup>29</sup> dhe të ofroj “*të drejtën e të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur për t’u kthyer të sigurt në shtëpitë e tyre.*”<sup>30</sup> Njëra ndër përgjegjësitë kryesore të prezencës civile ndërkombëtare ishte të “*garantoj*

<sup>20</sup> Marrëveshja e Brendshme mbi Paqen dhe Vetë-qeverisjen në Kosovë, 23 Shkurt 1999. Nga Marrëveshja e Rambouillet ka rrjedhur korniza mbi intervenimin për paqe në Kosovë, për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

<sup>21</sup> Me Marrëveshjen Tekniko-Ushtarake parashihej që forcat Jugosllave dhe Serbe të tërhiqeshin nga Kosova.

<sup>22</sup> Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1244 (1999) Kosovë, UN Doc. S/RES/1244 (1999), e adoptuar nga Këshilli i Sigurimit në seancën e tij të 4011-të me 10 Qershor 1999, tash e tutje Këshilli i Sigurimit “SC1244”. Për detale të mëtejshme të saj, shih raportin e Komisionit të Pavarur Ndërkombëtar, *op. cit.*, shënimi 8 në f. 35 dhe 54 dhe raporti i Misionit të OSBE-së në Kosovë, *op. cit.*, shënimi 8 në f. 29-32.

<sup>23</sup> Shih paragrafin 5 të SC 1244. KFOR-i ishte caktuar në mënyrë specifike, forcë e cila përbëhej nga NATO, (përfshirë shtetet anëtare të saj dhe shtabin e përgjithshëm, trupat e saj ndihmëse, elementet e saj ushtarake dhe kombëtare) dhe trupat kontribuuese jashtë NATO-së nga kombet kontribuuese.

<sup>24</sup> Matheson, M., “Qeverisja e Kombeve të Bashkuara në Shoqëritë Pas Konfliktit”, 95 Revista Amerikane mbi Ligjet Ndërkombëtare, 76, 2001.

<sup>25</sup> Përgjegjësitë e prezencës civile ndërkombëtare ishin dhënë në paragrafin 11(a) – (k) të SC 1244.

<sup>26</sup> KFOR-i përbëhej mes 40,000-50,000 trupave në Kosovë.

<sup>27</sup> Shih paragr. 6.

<sup>28</sup> Shih Raportin e Sekretarit të Përgjithshëm për UNMIK-un, UN SCOR, Seanca e 24-të, UN Doc. S/1999/779 (1999) në paragr. 35 dhe 39.

<sup>29</sup> Shih hyrjen në SC 1244.

<sup>30</sup> Shih faqen e parë në SC 1244, klauzolën e ri-afirmimit.

*kthim të sigurt dhe të papenguar të të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre*” dhe kërkoi nga “*të gjitha shtetet dhe organizatat ndërkombëtare për të kontribuar në ... kthim të sigurt të të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur*”.<sup>31</sup> KFOR-i ishte për të mbështetur UNMIK-un në përmbushjen e kësaj detyre duke siguruar “*mjedis të sigurt në të cilin refugjatët dhe personat e zhvendosur do të mund të ktheheshin të sigurt në shtëpi*”.<sup>32</sup>

### **3. Përgjigjja e UNMIK-ut në Krizat Pronësore dhe të Banimit në Kosovë**

Mjedisi pas-konfliktit ka paraqitur sfida të shumta mbi të drejtat pronësore dhe të banimit si rezultat i zhvendosjes së popullatës i përcjellur me shkatërrim të gjerë dhe uzurpim të paligjshëm të pronave. Më tutje kjo është paraprirë nga periudha para vitit 1999 e diskriminimit etnik, e cila gjithashtu kishte përfunduar me zhvendosjen dhe kontestet pronësore.

Shumica e shqiptarëve të Kosovës, të cilët ishin larguar në Mars 1999, janë kthyer pas hyrjes së NATO-së në Kosovë në Qershor,<sup>33</sup> por në të njëjtën kohë dhuna ndaj minoriteteve mbizotëroi dhe përshpejtoi eksodin masiv të Serbëve të Kosovës, Romëve dhe jo-Shqiptarëve<sup>34</sup> të cilët ishin larguar nga frika e reprezalieve të popullatës Shqiptare të Kosovës. Ka supozime të ndryshëm të të larguarve, së paku dhjetëra mijëra.<sup>35</sup> Shumica e shtëpive ishin shkatërruar gjatë konfliktit. Një anketë tregon se pothuajse gjysma e shtëpive të banueshme ishin shkatërruar apo ishin shndërruar në shtëpi të pabanueshme.<sup>36</sup> Pasi që shumë prej të kthyerve shqiptarë konstatuan që shtëpitë e tyre ishin dëmtuar apo shkatërruar gjatë konfliktit, kishin hyrë në pronat të cilat ishin braktisur nga Serbët e Kosovës dhe minoritetet tjera, duke sjellë rritje të shpejtë në “uzurpim dytësor” të parregullt dhe të paautorizuar të pronave.<sup>37</sup>

<sup>31</sup> Paragr. 11(k) dhe 13. Aneksi 2 i SC1244, paragr. 7 i ka dhënë mandatin Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) të mbikëqyrë kthimin e sigurt dhe të lirë të të gjithë refugjatëve dhe të personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre dhe i ka dhënë qasje të papenguar në Kosovë përmes organizatave humanitare.

<sup>32</sup> Paragr. 9(c).

<sup>33</sup> Shih raportin e Komisionit të Pavarur Ndërkombëtar, *op. cit.*, shënimi 8, në faqen 43.

<sup>34</sup> Përfshirë Ashkalit, Egjiptianët dhe Sllavët Mysliman.

<sup>35</sup> Korniza për Kthim (2001) e Komitetit të Bashkuar për Kthim të Serbëve të Kosovës kishte raportuar se rreth 215,104 persona ishin zhvendosur në Serbi dhe Mal të Zi deri në Janar 2001, por janë raportuar numra të ndryshëm, shih më tutje në raportin e Misionit të OSBE-së në Kosovë, *op. cit.*, shënimi 8; Raporti i Qendrës mbi Monitorimin e Zhvendosjes së Brendshme në Serbi dhe Mal të Zi; Raporti i Komisionit të Pavarur Ndërkombëtar, *op. cit.*, shënimi 8, f. 43; dhe raporti i Human Rights Watch i titulluar “Abuzimi i Serbëve në Kosovën e Re”, Gusht 1999, Volumi 11, Nr. 10 (D) në faqet 2 dhe 67.

<sup>36</sup> Das, H., “Rregullimi i të Drejtave Pronësore dhe të Banimit në Kosovë”, në faqen 2, [www.unhabitat.org](http://www.unhabitat.org); Në disa qytete si Gjakovë, Rahovec dhe Pejë më tepër se 75% të ndërtesave të tyre të para-luftës janë në gërmadha, për më tepër shih, Leckie, Scott, *op. cit.*, shënimi 13; raportin e Misionit të OSBE-së në Kosovë, *op. cit.*, shënimi 8 në Kapitullin 12; Von Carloëitz, L., “kalimi i kufijve nga sfera ligjore ndërkombëtare tek ajo e brendshme: ligjëvënia e UNMIK-ut dhe të drejtat pronësore në Kosovë” në Qeverisjen Globale, Vol. 10, Nr. 3, 2004.

<sup>37</sup> Leckie, S., *op. cit.*, shënimi 13; Das, H., *op. cit.*, shënimi 36; Beardsley, “Kush Cka Zotëron? Përpjekjet e UNMIK-ut shkaktojnë rrëmujë në çështjen e banimit në Kosovë” (10 Janar 2002) Christina Science Monitor, [www.csmonitor.com](http://www.csmonitor.com)



Kjo gjendje ishte keqësuar për shkak të paqartësve ligjore në regjistrat pronësore. Kadastra dhe regjistri mbi të drejtat pronësore ishin të pakompletuara dhe të pasakta për shkak të faktit se sistemi i para-1999-së, i cili rregullonte atë, nuk kishte ofruar regjistrim adekuat të të gjitha bartjeve pronësore. Më tutje, bartjet e paregjistruara dhe jozyrtare të cilat ishin bërë mes viteve 1991 dhe 1999, gjithashtu i paraqesin të dhënat si të pakompletuara dhe të dyshimta.<sup>38</sup> Kjo situatë më tutje ishte rënduar me shkatërrimin e të dhënave pronësore gjatë konfliktit, dhe zhvendosja e tyre nga autoritetet e RFJ-së kur ishin tërhequr në vitin 1999.<sup>39</sup> Armata Jugosllave kishte zhvendosur të gjitha arkivat e saj, derisa policia kishte zhvendosur pothuajse 50% të të dhënave të saj, dhe ndërmarrjet shoqërore kishin tërhequr sasi të konsiderueshme të dokumentacionit të tyre.<sup>40</sup> Më tutje, shumica e të dhënave Kadastrale ishin zhvendosur në territorin e Serbisë, dhe një numri të konsiderueshëm të komunave ju mungonin të dhënat pronësore.<sup>41</sup> Të gjithë këta faktor kanë vështirësuar shumë përcaktimin e saktë të pronës.

Për shkak të shkatërrimit të madh të shtëpive gjatë konfliktit, dhe mungesës së mekanizmit të pavarur alternativ për të zgjidhur kontestet pronësore, uzurpimin e paligjshëm dhe shpronësimi ka ekzistuar.<sup>42</sup> Në këtë mjedis sektori i pronës është bërë burim i tensionimit të vazhdueshëm, si uzurpimi i vazhdueshëm vazhdoi në mënyrë të pandërprerë i cili ka qar në një mjedis shumë të tensionuar politik.<sup>43</sup>

Në njohjen e krizave me të cilat ballafaqohet UNMIK-u në sektorin e çështjeve pronësore dhe banesore, PSSP në fund të vitit 1999 ka pranuar shërbimet e Programit të Kombeve të Bashkuara për Vendbanime të Njerëzve (UN-HABITAT) që t'i ndihmojë në koordinimin e procesit të kthimit të pronave dhe shtëpive. UN-Habitat ndihmon Grupin Punues për çështje pronësore dhe të banimit të bëjë hetime dhe të ofroj udhëzime dhe ndihmë teknike në mënyrë që të përcaktohen çështjet pronësore dhe të banimit. Tri fushat primare që kërkonin intervenim urgjent ishin identifikuar nga UN-Habitat-i dhe janë rekomanduar veprimet si në vijim që të merren:

- (i) themelimi i mekanizmit për vendimmarrjen mbi të drejtat pronësore dhe të banimit;
- (ii) krijimi i centralizuar i të dhënave Kadastrale dhe pronësore;
- (iii) përmirësimi i qeverisjes dhe administrimit komunal.

UN-Habitati ka prezantuar planin për veprim për mbështjetjen dhe mbrojtjen e të drejtave pronësore dhe të banimit në Kosovë. Plani sugjeronte rekomandimet gjithëpërfshirëse për reformën legjislativë dhe krijimin e Drejtoratit për Çështje Pronësore dhe Banesore.<sup>44</sup>

---

<sup>38</sup> Është shqyrtuar hollësisht në 1 të këtij raporti.

<sup>39</sup> Për më tutje shih raportin e Misionit të OSBE-së në Kosovë, *op. cit.* shënimi 13; Leckie, S., *op. cit.*, shënimi 13; raporti i Departamentit mbi të Drejtat Njerëzore dhe Rregullat e Ligjit mbi të Drejtat Pronësore në Kosovë i OSBE-së 2002-2003, në Kapitullin 1.

<sup>40</sup> *Ibid.*

<sup>41</sup> *Ibid.*

<sup>42</sup> Shih raportin e Komisionit të Pavarur Ndërkombëtar, *op. cit.*, shënimi 8, në faqen 40.

<sup>43</sup> Shih gjithashtu Von Carloëitz, L., *op. cit.*, shënimi 36, në faqet 605-606; Das, H., *op. cit.*, shënimi 36, në faqet 433-435.

<sup>44</sup> Plani ishte titulluar “Çështja e Banimit dhe Prona në Kosovë: të Drejtat, Ligjet dhe Drejtësia – propozimet për planin gjithëpërfshirës së veprimit për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave pronësore

Mandej i propozoi kësaj të fundit që t'i jepet përgjegjësia për koordinimin dhe centralizimin e përpjekjeve të UNMIK-ut në fushën e të drejtave pronësore dhe të banimit dhe ajo i rendit një numër të detyrave që do të duhej t'i caktoheshin atij, përfshirë zgjidhjen e kontesteve mbi pronat e banimit dhe administrimin dhe ndarjen e pronave të braktisura.<sup>45</sup>

Në Nëntor 1999, PSSP-ja ka miratuar këto rekomandime përmes nxjerrjes së Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 duke themeluar një organ të pavarur ad hoc për të zgjidhur kontestet për pronat e banimit dhe të merret me disa çështje tjera të banimit. Ishte i përbërë nga dy organe plotësisht të ndryshme, organi quazi gjyqësor, Komisioni për Çështje Pronësore dhe Banesore (“HPCC”) dhe organi administrativ (“Drejtorati për Çështje Pronësore dhe Banesore – HPD”), ku që të dy kishin mandatin të bëjnë *“zgjidhjen efikase dhe të suksesshëme të kërkesave që i përkasin pronës së banimit.”*

## KAPITULLI 2

### KOMISIONI PËR KËRKESA PRONËSORE DHE BANESORE

#### 1. Themelimi

Sipas Nenit 2 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 ishte themeluar HPCC, i cili ishte element i pavarur quazi-gjyqësor i mekanizmit për kthimin e pronës dhe i ishte dhënë jurisdikcion ekskluziv të *“zgjidh kontestet e pronave jo-komerciale të banimit gjersa PSSP-ja [ka] përcakton[uar] se gjykatat vendore [mundeshin] mund të zbatojnë mandatin e besuar Komisionit.”*<sup>46</sup>

HPCC ishte themeluar si organ i pavarur dhe ka operuar jashtë sistemit gjyqësor vendor, duke pasur rregullat e veta të procedurës dhe dëshmitë për zgjidhjen e kërkesave të cilat janë pranuar pas rekomandimit nga HPCC, të përfshira në Rregulloren e UNMIK 2000/60.<sup>47</sup> Më tutje Rregullorja kishte autorizuar HPD dhe HPCC të miratoj rregullat e mëtutjeshme të procedurës për implementimin e mandatit të tij që i është ofruar atyre në përputhje me Rregulloren.

---

dhe të banimit në Kosovë”, dhe ishte përgatitur nga Z. Scott Leckie, S (UNCHS (Habitat)) 30 Gusht 1999, i mundur në [www.unhabitat.org](http://www.unhabitat.org).

<sup>45</sup> *Ibid.*

<sup>46</sup> Shih nenin 2.5 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23. Për shkak të paaftësisë së gjykatave, PSSP-ja asnjëherë nuk kishte përcaktuar që gjykatat vendore ishin kompetente të zbatonin mandatin e besuar HPCC-së. Sa i përket aftësisë së gjykatave kryesisht në Kosovë, më tutje shih raportin periodik të Misionit të OSBE-së në Kosovë mbi Sistemin e Drejtësisë Penale që është i mundur në [www.osce mission in kosovo.org](http://www.osce mission in kosovo.org) dhe shih Shqyrtimi i OSBE-së mbi Sistemin e Drejtësisë Penale të titulluar “Administrimi i Drejtësisë në Gjykata Komunale”, Mars 2004 në f. 9; Raporti Përfundimtar i përgatitur nga ECO dhe i paraqitur Agjencisë Evropiane për Rindërtim (EAR) i datës 13 Dhjetor 2004 në f. 13 dhe 25; dhe raportet tremujore të Sekretarit të Përgjithshëm për Këshillin e Sigurimit mbi Administratën e Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

<sup>47</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2000/60 ishte nxjerr në Tetor 2000.

HPCC ishte mbështetur nga Drejtorati për Çështje Pronësore dhe Banesore (“HPD”), i cili ishte përgjegjës për mbledhjen dhe përpunimin e kërkesave, implementimin e vendimeve të HPCC-së dhe udhëheqjen e përgjithshme të mekanizmit.<sup>48</sup> Më tutje, ishte ndihmuar në kryerjen e funksioneve të tij juridike Kryeserkretaria, i cili i ka ofruar mbështetje administrative, teknike dhe juridike.<sup>49</sup>

Vendimet e HPCC-së mbi kërkesat ishin të detyrueshme dhe të zbatueshme, dhe nuk ishin lëndë të shqyrtimit nga asnjë autoritet tjetër juridik apo administrativ në Kosovë<sup>50</sup>, meqenëse nga Rregullorja e UNMIK-ut 2000/60, e cila u ka lejuar palëve në kërkesë procedurën e shqyrtimit ndaj vendimeve, apo të ndonjë pale të interesuar për të paraqitur kërkesë për rishqyrtimin e vendimit.<sup>51</sup>

## 2. Jurisdiksioni

HPCC nuk e ka pasur jurisdiksionin ekskluziv për të vendosur mbi të gjitha kërkesat në lidhje me pronën, jurisdiksioni i tij vendimmarrës ishte i kufizuar në mënyrë specifike për të vendosur mbi tri kategori të kërkesave për pronat e banimit të cilat i referoheshin nga HPD, siç është dhënë në nenin 1.2(a)-(c) të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23. Këto kërkesa më tutje kufizoheshin sa i përket periudhës gjatë së cilës kërkesat duhet të paraqiten (*ratione temporis*); mundësia e paraqitësit të kërkesës të paraqesë kërkesë (*ratione personae*); lloji i humbjes i së drejtës për të cilën mund të urdhërohet kthimi (*ratione materiae*), dhe kërkesa që prona të jetë në Kosovë (*ratione loci*).

Neni 1.2 i Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 ka cekur tri kategori të kërkesave për pronat e banimit të cilat HPD mund t’i pranoj dhe regjistroj, si përjashtim i jurisdiksionit të gjykatave. Kategoritë e kërkesave përputhen me shkatërrimin e pronës e cila kishte ndodhur në Kosovë mes viteve 1989 dhe 1999. Neni 2 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 ka përmbajtur dispozitat relevante themelore të kriterëve të cilat duhet të përmbushen për kërkesë të suksesshme dhe ndihmës ligjore që është në dispozicion për paraqitësit e kërkesave.

Kërkesat janë përshkruar në pajtueshmëri me dispozitat e Rregullores 1999/23 si kërkesa të kategorisë A, B dhe C.

### ***Kërkesat e kategorisë A***

Neni 1.2(a) i Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 definton kategorinë e parë të kërkesave për pronën e banimit, (“kërkesat e kategorisë A”), të cilat mund të paraqiten në HPD si në vijim:

---

<sup>48</sup> Shih nenin 1 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23.

<sup>49</sup> Shih nenin 17.13 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>50</sup> Shih nenin 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23.

<sup>51</sup> Shih nenin 14 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

*“Kërkesat e paraqitura nga personat fizik, të cilëve pronësia, posedimi apo të drejtat e banimit mbi pronat e patundshme të banimit u janë anuluar pas 23 Marsit 1989 bazuar në legjislacionin i cili ishte diskriminues në aplikimin apo qëllimin e tij”*

Kjo kategori e kërkesave ka ofruar ndihmë ligjore për personat të cilët kanë humbur të drejtat pronësore në mes 23 Marsit 1989 dhe 24 Marsit 1999, si rezultat i masave diskriminuese të instaluar nga autoritetet gjatë asaj periudhe<sup>52</sup>, përmes së cilave shumë shqiptarë të Kosovës ishin shkarkuar nga pozitat e tyre të punësimit dhe i kishin humbur të drejtat e banimit mbi pronat e tyre të cilat ndërlidheshin me punësimin e tyre aktual.<sup>53</sup>

Paraqitësi i kërkesës i cili ka paraqitur kërkesën e kategorisë A duhet të dëshmoj pajtueshmërinë me kriterët e nenit 1.2(a) të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 dhe nenit 2.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60, dhe të dëshmoj si në vijim:

- a) se ai apo ajo e ka pasur të drejtën pronësore, që do të thotë dhe të drejtën e banimit apo të drejtën e pronësisë në pronën e banimit;
- b) se e drejta ishte revokuar apo humbur;
- c) se humbja apo revokimi i pronës ka ndodhur në mes 23 Marsit 1989 dhe 24 Marsit 1999,<sup>54</sup> dhe
- d) se humbja apo revokimi ishte si rezultat i diskriminimit.

Paraqitësit e suksesshëm të kërkesës së kategorisë A kishin të drejtë në kthim, e cila do të merrte formën e *“rikthimit të së drejtave pronësore (tash e tutje “kthimit në lloj”) apo kompensim.”*<sup>55</sup> Qartësimi i mëtutjeshëm mbi të drejtën në kthim ishte paraqitur në nenin 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60, e cila përshkruan atë se kur konstatohet nga HPCC që paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në kthim, atij apo asaj do t’i jepet kthimi në lloj, nëse pronësia mbi pronën ishte fituar nga personi fizik përmes transaksionit valid vullnetar për vlerën para ditës kur kjo rregullore ka hyrë në fuqi. Më tutje, neni 4 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 ka paraqitur përjashtim në nenin 3.3, në lidhje me apartamentet shoqërore të cilat, më vonë me anulimin e së drejtës së banimit kur ishte blerë nga pronari aktual prej bartësit të së drejtës së ndarjes sipas Ligjit mbi Banim, duke i lejuar paraqitësit të kërkesës që së bashku me të drejtën e banimit të ketë të drejtë të blejë të drejtën e pronësisë duke i paguar HPD-së shumën e përcaktuar nga vet ajo.<sup>56</sup>

### ***Kërkesat e kategorisë B***

---

<sup>52</sup> Shih gjithashtu nenin 2.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>53</sup> Humbja diskriminuese e pronës së banimit është shqyrtuar në Kapitullin 1 të këtij Raporti.

<sup>54</sup> Shëno se 23 Marsi 1989 ishte dita në të cilën Kosova kishte humbur autonomin dhe 24 Marsi 1999 ishte dita në të cilën NATO kishte filluar fushatën e saj të bombardimit ndaj Republikës Federative të Jugosllavisë, e shqyrtuar në Kapitullin në të këtij Raporti.

<sup>55</sup> Shih nenin 2.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>56</sup> Në raste të tilla kompensimi i ishte paguar pronarit aktual për humbjen e së drejtës së tij apo saj të pronësisë mbi pronën. Dispozitat e nenit 4 të Rregullores së UNMIK-ut janë shqyrtuar në Kapitullin 7 të këtij Raporti.

Neni 1.2(b) i Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 definton kategorinë e dytë të kërkesave për pronën e banimit, (“kërkesat e kategorisë B”) të cilat mund të paraqiten në HPD si në vijim:

*“Kërkesat e paraqitura nga personat fizik të cilët kanë bërë transaksione jozyrtare për pronat e banimit, bazuar në vullnetin e lirë të palëve pas 23 Marsit 1989”.*

Kërkesat e kategorisë B kërkojnë të vërtetojnë të drejtën për personat të cilët kanë bërë transaksione jozyrtare për pronën e banimit pas 23 Marsit 1989, me qëllim të shmangies së dispozitave të Ligjit mbi Ndërrimin dhe Plotësimin e Kufizimit të Transaksioneve për Patundshmërinë.<sup>57</sup>

Paraqitësi i kërkesës i cili ka paraqitur kërkesën e kategorisë B duhet të dëshmoj pajtueshmërinë me kriteret e nenit 1.2(b) të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 dhe nenit 2.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60, dhe të dëshmoj si në vijim:

- a) që ai apo ajo ka bërë transaksionin për pronën e banimit në mes 23 Marsit 1989 dhe 13 Tetorit 1999;<sup>58</sup>
- b) që transaksioni ishte i paligjshëm sipas dispozitave të Ligjit mbi Qarkullimin e Patundshmërisë në Kushte të Veçanta apo ligjeve tjera diskriminuese;
- c) që transaksioni përndryshe do të kishte qenë i ligjshëm; dhe
- d) që transaksioni ishte i bazuar në vullnetin e lirë të palëve.

Çdo person i cili kishte fituar pronësinë mbi pronën përmes transaksionit jozyrtar kishte të drejtë për *“urdhër nga Drejtorati apo Komisioni për regjistrimin e së drejtës së tij/saj në të dhënat publike përkatëse.”*<sup>59</sup> Regjistrimi i së drejtës në të dhënat publike ishte njohur nga komuniteti ndërkombëtar, kur kishte intervenuar në vitin 1999, si një nga parakushtet kryesore për rregullimin e sektorit të pronës.

### ***Kërkesat e kategorisë C***

Neni 1.2(c) i Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 definton kategorinë e tretë të kërkesave për pronën e banimit, (“kërkesat e kategorisë C”) të cilat mund të paraqiten në HPD si në vijim:

*“Kërkesat nga personat fizik të cilët ishin pronarë, posedues apo bartës të së drejtës së banimit të pronës së patundshme të banimit para 24 marsit 1999, dhe të cilët tash nuk e gëzojnë posedimin e pronës, dhe ku prona nuk ishte bartur vullnetarisht.”*

<sup>57</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste të Serbisë 22/91, 18 Prill 1991. Dispozitat e këtij ligji dhe ndikimi i tij në transaksionet mbi pronën janë shqyrtuar në Kapitullin 1 të këtij Raporti.

<sup>58</sup> Shëno se 13 Tetori 1999 ishte data në të cilën UNMIK-u kishte nxjerr Rregulloren 1999/10 e cila shfuqizonte ligjet diskriminuese.

<sup>59</sup> Shih nenin 2.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

Kjo kategori e kërkesave kishte për qëllim adresimin e popullatës së zhvendosur me forcë, anëtarët e së cilës popullatë i kishin të drejtat pronësore mbi pronën e banimit me 24 Mars 1999, dhe të cilët ishin larguar nga shtëpitë e tyre për shkak të rrethanave të krijuara nga fushata ajrore e NATO-së dhe të cilët nuk mund të ktheheshin, duke iu pamundësuar qartësisht kthimi në pronën e tyre të uzurpuar në mënyrë të paligjshme.

Paraqitësi i kërkesës i cili ka paraqitur kërkesën e kategorisë C duhej të dëshmonte pajtueshmërinë me kriteret e nenit 1.2(c) të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 dhe nenit 2.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60, dhe të dëshmoj si në vijim:

- a) që ai apo ajo ka pasur të drejt pronësore (d.m.th. të drejtën e pronësisë, të drejtën e banimit apo të drejtën e ligjshme të posedimit) mbi pronën e banimit para 24 Marsit 1999; dhe
- b) humbjen e posedimit të pronës në rrethanat e krijuara nga fushata ajrore e NATO-së; dhe
- c) që ai apo ajo nuk ka hequr dorë vullnetarisht nga e drejta e tij/saj pronësore.

Neni 2.6 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 parashihte që një person i tillë i cili e ka humbur posedimin e pronës me 24 Mars 1999 dhe nuk ka hequr dorë vullnetarisht nga ajo ka të drejtë “*për urdhër ... për riposedit të pronës.*” Kjo dispozitë duhet të siguroj përmbushjen e nenit 2.5 të Rregullores, që do të thotë të sigurohet që “*çdo refugjat apo person i zhvendosur me të drejtën mbi pronën ka të drejtë të kthehet në pronë, apo të heq dorë nga ajo në pajtim me ligjin, në bazë të rregullores së prezantuar*”.

Neni 2.6 ka mbrojtur të drejtën e të gjithë refugjatëve dhe të Personave Përkohësisht të Zhvendosur të kthehen në shtëpitë e tyre sipas natyrës së të drejtave të tyre pronësore. I ka mbrojtur ata me të drejtë të pronësisë dhe me të drejta të ngjashme të posedimit, ndërsa posedimi i ofruar nuk ishte qartësisht i paligjshëm. Lëndë e kësaj dispozite ishte të rikthej status quo-në e cila ishte para konfliktit, ashtu që personat të cilët ishin në posedim të ligjshëm të pronave iu ishte lejuar atyre e drejta për të kthyer, dhe kontestet vijuese në lidhje me të drejtën apo me të drejtat themelore ligjore të mund të zgjidhen nga institucionet vendore.

### ***Jurisdiksioni i veçantë i HPCC-së***

Në marrveshje me jurisdiksonin e tij të veçantë për të zgjidhur kërkesat e përshkruara në nenin 1.2 të Rregullores, HPCC ka mundur të referoj pjesë të veçanta të kërkesave të tilla në gjykatat vendore apo organet administrative, nëse nga to rrjedhin çështje të cilat nuk ndërlidhen me kategoritë e kërkesave nën jurisdiksonin e tij të veçantë.<sup>60</sup> Me qëllim të ndihmesës së gjykatave në interpretimin e tyre të dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60, në lidhje me kompetencat dhe jurisdiksonin e veçantë të HPCC-së, PSSP-ja me 12 Prill 2001, ka lëshuar një sqarim mbi dispozitat e Rregullores e cili ka shërbyer kryesisht si ndihmë për gjykatat vendore mbi përcaktimin nëse kërkesa për pronën binte brenda kompetencave të tyre apo të HPCC-së. Sqarimi qartazi ka ofruar që kur kërkesa ka përfshirë çështje ligjore, disa nga të cilat ishin nën jurisdikson të HPD-së dhe të tjerat të

<sup>60</sup> Shih nenin 22.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

cilat ishin nën juridiksion të gjykatave, çështjet ligjore nën kompetencë të HPD-së do të duhej të zgjidheshin së pari.<sup>61</sup> Duke pasuar vendimin e HPCC-së mbi kërkesën, gjykatave vendore i kishte mbetur juridiksioni të vendosin mbi çdo çështje ligjore mbi të cilën nuk ishte vendosur nga HPCC.<sup>62</sup>

### 3. *Përbërja dhe Anëtarësimi*

Për shkak të ndarjes së thellë etnike e cila kishte ekzistuar në Kosovë dhe me qëllim të inkurajimit të mbështetjes dhe konfidencës së paraqitësve të kërkesave dhe të publikut në tërësi në proces, neni 2.2 i Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 parashihte që kolegji i HPCC-së të përbëhej nga dy Komisioner ndërkombëtarë dhe një vendor, të cilët është duhej të emëroheshin nga PSSP-ja. Në vitin 2001, PSSP-ja ka emëruar tre anëtarë të HPCC-së. Anëtarët ndërkombëtarë ishin Z. Alan Dodson nga Afrika e Jugut dhe Z. Veijo Heiskanen nga Finlanda. Anëtari vendor ishte Z. Aqif Tuhina i cili kishte shërbyer si Gjykatës në Gjykatën Supreme të Kosovës para humbjes së autonomisë në vitin 1989.<sup>63</sup> Të gjithë anëtarët ishin ekspert të drejtësisë dhe disiplinave të tjera<sup>64</sup> dhe ishin gjyqtarë të shquar, duke i sjellë HPCC-së shumëllojshmëri të gjerë të përvojës me kualifikim të ndryshëm, përfshirë drejtësinë, fushën akademike, praktiken juridike private, kërkesat ndërkombëtare dhe ligjin ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut.<sup>65</sup> Emërimet e tyre sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 ishte për periudhë njëvjeçare<sup>66</sup> dhe që të tre anëtarët ishin emëruar prapë në baza njëvjeçare dhe qëndruan në HPCC gjerë në përmbushjen e mandatit të tij. PSSP-ja kishte emëruar Z. Dodsonin për kryetar të HPCC-së. PSSP e ka pasur mundësinë të themeloj kolegje plotësuese bashkëvepruese, por nuk ishin caktuar kolegje shtesë për shkak të numrit të caktuar të rasteve dhe ngarkesës së punës, e gjithashtu edhe të fondit të kufizuar.<sup>67</sup>

Anëtarët nuk ishin të vendosur gjatë tërë kohës në Prishtinë, por në shumicën e rasteve takoheshin në Prishtinë për seanca të komisionit.

Prezenca shumicë e anëtarëve ndërkombëtarë ishte konsideruar e rëndësishme nga perspektivat e shumta. Qëllimi i saj ishte të garantoj vendime të drejta, objektive dhe të paanshme në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare dhe kanë zvogëluar brengën e paanshmërisë vendore. Garancat e tilla ishin përcaktuar për të rritur besueshmërinë e Serbëve të Kosovës dhe minoriteteve të tjera në proces. Përfshirja e komisionerit vendor kishte ndihmuar për t'u siguruar se vendimi i marrë ishte në përputhje me ligjin e aplikueshëm vendor.

---

<sup>61</sup> Shih paragr. 13 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 të dhënë nga PSSP, i mundur në [www.unmikonline.org](http://www.unmikonline.org)

<sup>62</sup> Shih nenin 22.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>63</sup> Profili i secilit anëtarë është bashkangjitur në Aneksin 1.

<sup>64</sup> Kjo ishte në pajtim me nenin 2.2 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23, e cila kërkonte që anëtarët të jenë kompetent të mbajnë poste gjyqësore.

<sup>65</sup> Referoju profileve të anëtarëve të HPCC-së në Aneksin 1.

<sup>66</sup> Shih nenin 17.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>67</sup> Shih nenin 2.2 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23.

Anëtarët kanë shërbyer vetëm në cilësinë e tyre personale dhe qartësisht ishin të përjashtuar që të marrin pjesë në ndonjë procedurë të kërkesës nëse:

- a) ata kishin interesa personale, apo nëse ishin konsultuar nga pala apo ishin bashkuar me palën në kërkesës; apo
- b) ata kishin qenë të përfshirë në ndonjë procedurë ligjore në kërkesë tjetër nga procedura para HPD-së apo HPCC-së; apo
- c) ka pasur rrethana tjera të cilat do të ndikonin në paanshmërinë e tyre.<sup>68</sup>

Para se të merrnin detyrën, anëtarët ishin nën obligim të parashikuar me statut për të u betuar dhe nënshkruar deklaratën si në vijim:

*“Solemnisht deklaroj se do të përmbush detyrat e mia dhe të ushtroj fuqinë time si anëtar i Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore me ndershmëri, besnikëri, paanshmëri dhe ndërgjegjshmëri.”<sup>69</sup>*

Anëtari i HPCC-së ka mundur të largohet nga detyra nga PSSP-ja, me rekomandimin e shumicës së anëtarëve, për dështim në përmbushjen e kualifikimit për detyrën, apo në ngulmimin apo refuzimin e paarsyeshëm në përmbushjen e funksionit të tij sipas detyrës.<sup>70</sup> Anëtarët e HPCC-së kanë pasur imunitet ndaj procedurave penale dhe civile për çdo veprim të kryer në kuadër të detyrave zyrtare.<sup>71</sup>

#### **4. Seancat e HPCC-së**

Selia e HPCC-së ishte në Prishtinë.<sup>72</sup> HPCC-së iu ishte lejuar të kryej funksionet e veta vendimmarrëse përmes thirrjeve të seancave në Prishtinë apo mbajtjen e seancave gjetiu, apo përmes paisjeve elektronike kur ishte e nevojshme.

Seancat zakonisht mbaheshin gjashtë herë në vit në sallën e takimeve e cila ishte në dispozicion për seancat e drejtëpërdrejta anëtarëve të Komisionit në zyrat e HPD-së.<sup>73</sup> Në tetë raste procedurat anë kryer përmes telefonit dhe pajisjeve elektronike.<sup>74</sup>

---

<sup>68</sup> Shih nenin 17.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>69</sup> Shih nenin 2.3 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23. Ishte kërkuar që kjo Deklaratë të regjistrohet në arkivat e HPD-së.

<sup>70</sup> Shih nenin 17.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>71</sup> Shih nenin 17.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60. Shëno gjithashtu se nëse anëtari i HPCC-së në të vërtetë ka dhënë dorëheqje, ai apo ajo është dashur që së paku një muaj paraprakisht t'i ofrojnë Regjistrin dhe kryetarit të HPCC-së njoftimin me shkrim, dhe të vazhdoj të kryej të gjitha funksionet e tij apo saj gjer në përfundim të periudhës së njoftimit, shih nenin 17.5(a)-(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60. Kërkohej gjithashtu nga ai apo ajo të vazhdoj të shërbej edhe pas periudhës së njoftimit për qëllime të caktuara të finalizimit të ndonjë kërkesë apo grupi të kërkesave të cilat ishin ende të pazgjidhura, shih nenin 17.5(c) të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>72</sup> Shih nenin 17.8 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>73</sup> Nëntë seancat e para të HPCC-së ishin mbajtur në zyrat ekzekutive të HPD-së në Rr. Goleshit Nr. 2, Prishtinë. Seanca e 10-të ishte mbajtur në Selinë Kryesore të UNMIK-ut. Pas kësaj të gjitha seancat, me përjashtim të atyre që janë mbajtur në mënyrë elektronike, ishin mbajtur në zyrat e shërbimit të kartotekës



Seancat zgjasnin përafërsisht 3-5 ditë. Në fillim të secilës seancë, HPCC takohej me Drejtorin Ekzekutiv të HPD-së, Kryesekretarin dhe stafin tjetër të Zyrës së Kryesekretarisë dhe zyrtarët juridik të cilët punonin në përpunimin dhe implementimin e kërkesave. Në këtë takim Drejtori Ekzekutiv i raportonte HPCC-së mbi statusin dhe progresin e përgjithshëm të përpunimit dhe implementimit të kërkesave, sfidat e ndryshme me të cilat ballafaqohej institucioni dhe veprimet specifike të ndërmarra për t'u tejkaluar këto sfida. Anëtarët e HPCC-së kanë shfrytëzuar këtë forum për shkëmbim të informatave ndërmjet saj dhe HPD-së mbi çështjet relevante në hetimin dhe përpunimin e kërkesave, dhe për përgatitjen e raporteve mbi përpunimin e kërkesës. Referim i veçantë ishte bërë në çështjet juridike të cilat kishin rrjedhur në lidhje me kërkesën, në lidhje me verifikimin apo notifikimin jo adekuat të kërkesave apo raportet e përpunimit të kërkesave të pakompletuara.

Pas hapjes së takimit, HPCC fillonte shqyrtimet e veta dhe vendimmarrjen mbi kërkesat. HPCC ka mund të lëshoj vendime mbi aprovimin apo refuzimin e kërkesës. Gjithashtu ka mundur t'i kthej mbrapa kërkesat HPD-së për shqyrtim të mëtutjeshëm kur është menduar që një shqyrtim i tillë i mëtutjeshëm ishte i domosdoshëm për t'i mundësuar atyre të vendosin mbi kërkesën. Me qëllim të përmirësimit të gabimeve administrative, të mospërfshirjes apo të metave procedurale pasi që ishte vendosur kërkesa, HPCC lëshoi një Rezolutë zyrtare të cilat *inter ali* shfuqizonin vendimin e tyre të mëhershëm dhe i ktheu kërkesën mbrapa HPD-së për hetim dhe përpunim në pajtim me procedurën e rregullt.<sup>75</sup>

HPCC ka kryer punën e tij me seancë të mbyllur në prezencë të Kryesekretarit dhe zyrtarëve juridik, dhe të gjitha shqyrtimet e tij ishin të besueshme, përveç procesverbalit të tij të lëshuar pas çdo seance me aprovimin dhe nënshkrimin e Kryetarit të Komisionit. Kryetari udhëhiqte dhe kryesonte me punën e HPCC-së.<sup>76</sup> Ai udhëhiqte rregullin në të cilin shqyrtoheshin kërkesat dhe datat e seancave të Komisionit. Gjuhët zyrtare të HPCC-së ishin Gjuha Shqipe, Angleze dhe Serbe, por puna e Komisionit bëhej në Gjuhën Angleze duke iu ofruar përkthim adekuat dhe Kryetari i Komisionit ka mundur t'i lejoj çdo personi, i cili ka folur para komisionit, të flas në secilën gjuhë tjetër.<sup>77</sup>

Në fund të çdo seance, HPCC ka mbajtur seancën përmbyllëse në të cilën ka diskutuar me Zyrën e Kryesekretarit dhe Drejtorin Ekzekutiv mbi çështjet të cilat ngritur në lidhje

---

të HPD-së, sekretarisë dhe në selinë kryesore të përpunimit të rastit në Rr. Vllaznim-Bashkimi Nr. 51, Prishtinë.

<sup>74</sup> Kur një anëtarë i HPCC-së nuk ka mundur të marr pjesë në seancë, atij apo asaj i është dashur ta njoftoj me shkrim së paku dy javë paraprakisht sekretarinë dhe Kryetarin e Komisionit mbi arsyet e mungesës, shih nenin 17.11 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60. Asnjëherë nuk është paraqitur një njoftim i tillë, pasi që anëtarët gjithmonë ishin në gjendje të marrin pjesë në seanca.

<sup>75</sup> Më tutje shqyrtohet në Kapitullin 6 të këtij Raporti.

<sup>76</sup> Shih nenin 17.9 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60. Neni 17.2 i Rregullores parasheh që nëse Kryetari i HPCC-së ka dhënë dorëheqje apo ishte larguar apo nuk ishte caktuar prapë, anëtarë që ka shërbyer më së gjati në panel duhet të jetë ushtrues detyre i Kryetarit të Komisionit, duke pritur emërtimin e kryetarit të Komisionit nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

<sup>77</sup> Shih nenin 17.15 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 dhe shëno se Kryetari i Komisionit ka mundur të lejoj çdo anëtarë apo person që paraqitet para tij të flas në çdo gjuhë tjetër.

me përpunimin e kërkesave, dhe arsyet e kthimit mbrapa të disa kërkesave për përpunim dhe hetim të mëtutjeshëm. Me qëllim të sigurimit të pajtueshmërisë dhe saktësisë në vendimmarrje, ka lëshuar parime udhëzuese në formë të udhëzimeve, të cilat qarkullonin në organizatë nga Zyra e Kryesekretarit, së bashku me procesverbalin e HPCC-së. Udhëzimet drejtonin punën e HPD-së dhe siguronin që gabimet apo mospërfshirja e njëjtë të mos përsëritet. Të dhënat e të gjitha procesverbaleve dhe udhëzimeve të HPCC-së iu ishin dërguar nëpunësve ekzekutiv të HPD-së nga Kryesekretari për përfshirje në të dhënat zyrtare dhe mbajtje të sigurt.

Me rritjen e numrit të kërkesave të paraqitura, HPCC në vjeshtë të vitit 2002 kishte vendosur që detyrën për shqyrtimin e kërkesave të caktuara ta kryej anëtari vendor në koordinim me Zyrën e Kryesekretarit në mes të seancave.

Procedurat e aplikuara mbi procesin dhe procedurat e vendimmarrjes në HPCC janë shqyrtuar në detaje në Kapitullin 7 të këtij Raporti.

## KAPITULLI 3

### DISPOZITA E SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE DHE PËRKRAHËSE JURIDIKE PËR HPCC

#### 1. Përkrahja Administrative dhe Udhëheqja

HPD e cila kishte formuar njësitin administrativ të HPCC-së, e cila ishte themeluar sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 dhe mandatin kryesor e kishte t'i ofroj shërbime të sekretarisë HPCC-së përmes mbledhjes, regjistrimit dhe përpunimit të kërkesave për pronat e banimit. Ajo nuk kishte organ të pavarur për vendimmarrje. Sipas neneve 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 dhe 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60, HPD ishte nën obligimin të parashikuar me statut të referoj të gjitha kërkesat, në të cilat nuk mund të ndërmjetojë,<sup>78</sup> tek HPCC-ja për vendimmarrje, të regjistroj vendimet që kanë mundur të lëshohen në rastet jokontestuese të kategorisë B mbi regjistrimin e transaksioneve jozyrtare.<sup>79</sup> Neni 1.2 i Rregullores parasheh si në vijim:

*“Drejtorati duhet t'i referojë këto kërkesa tek Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banësore për vendim apo, nëse është e përshtatshme, të kërkojë ndërmjetësimin në konteste të tilla dhe, nëse është i pasuksesshëm, t'i referojë ato tek Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banësore për zgjidhje.”*

<sup>78</sup> Roli i ndërmjetësimin i akorduar HPD-së sipas nenit 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 nuk ishte shfrytëzuar kur palët kishin zgjedhur që kërkesat e tyre të zgjidhen nga HPCC.

<sup>79</sup> Shih nenin 11.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60, për më tutje shih Kapitullin 6 të Këtij Raporti.

Përpunimi i kërkesave ka përfshirë hetimet në kërkesat, njoftimi i palëve, verifikimi i dokumenteve dhe hartimi i propozimeve dhe rekomandimeve për HPCC-në. HPD-së gjithashtu i ishte dhënë përgjegjësia për implementimin e vendimeve të HPCC-së. Rregullorja e UNMIK-ut 2000/60 ka ofruar baza ligjore për ekzekutimin e vendimeve përmes dëbimit të uzurpuesve të paligjshëm, kur ishte e domosdoshme, me mbështetje të autoriteteve zbatuese ligjore.<sup>80</sup>

HPD gjithashtu kishte mandatin të ofroj direktiva gjithëpërfshirëse në të drejtat pronësore në Kosovë<sup>81</sup> dhe të mbikëqyrë administrimin e pronave të braktisura.<sup>82</sup> Duke u mbështetur në komponentën e mekanizmit të kthimit të pronës e cila kishte bazë dhe personel të përhershëm në Kosovë, përgjegjësit e HPD-së ishin vazhduar mirë jashtë këtyre funksioneve. I ishte besuar përgjegjësia kryesore për administrimin e tërë procesit . Duke iu dhënë ndërlikime teknike dhe administrative të përfshirë në përpunimin e kërkesave, HPD-së i është dashur të rekrutoj personel, të zhvilloj infrastrukturën mbështetëse kompjuterike, të siguroj hapësirë për zyre, pajisje dhe vetura në pajtim me rregulloren aktive, dhe sigurimin e fondit për përpunim. Gjithashtu ishte një lidhje mes procesit dhe UNMIK-ut dhe një herë në javë i ishte raportuar udhëheqësisë së UNMIK-ut përmes Shtyllës së II-të. Procedurat të cilat udhëheqin punën e HPD-së ishin caktuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/60.<sup>83</sup>

Gjuha në të cilën punonte HPD ishte Gjuha angleze, por dokumentet publike lëshoheshin në gjuhën Shqipe dhe Serbe.

### Struktura institucionale e HPD-së

Zyra Kryesore e HPD-së fillimisht gjendeshin në Rr. Vllaznim Bashkimi Nr. 51 në Prishtinë. Më vonë Zyra Ekzekutive ishte bartur në Rr. Goleshit Nr. 2 në Prishtinë, ku shërbimi i kartotekës, kryesekretarinë dhe përpunimi i rasteve ishte bartur në ndërtesën tjetër.

Rregullorja e UNMIK-ut 2000/60 kishte autorizuar themelimin e zyrave që të ndihmojnë në regjistrimin e kërkesave në tërë Kosovën dhe në lokacione të tilla që mendoheshin si të përshtatshme.<sup>84</sup> HPD kishte themeluar rrjet të gjerë të zyrave regjionale dhe zyra

<sup>80</sup> Shih nenin 13 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>81</sup> Shih nenin 1.1 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 i cili numëronte disa nga funksionet të cilat ishin nën këtë aspekt të mandatit të HPD-së si në vijim:-

- a) të bëjë inventarin e pronave të braktisura private, shtetërore dhe shoqërore;
- b) të mbikëqyr shfrytëzimin apo qiranë e pronave të tillë të braktisura në baza të përkohshme për qëllime humanitare; të hollat e qirasë për pronat e braktisura private dhe shoqërore duhet të mbahen në konto të ndryshme të besueshme për pronarin e ligjshëm, duke hequr shpenzimet relevante;
- c) t'i ofroj ndihmë UNMIK-ut, përfshirë CIVPOL-it dhe UNHCR-it, e gjithashtu edhe KFOR-it në çështje specifike në lidhje me të drejtat pronësore; dhe
- d) të bëjë hulumtime që dërgojnë në rekomandimin e rregullores dhe legjislacionit në lidhje me të drejtat pronësore.

<sup>82</sup> Shih nenin 1.1 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 dhe nenin 12 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>83</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2000/60 ishte shpallur me 31 Tetor 2000.

<sup>84</sup> Shih nenin 7.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

terreni në tërë Kosovën.<sup>85</sup> Nga këto zyre, grupet mobile ishin pozicionuar në vendet të popullzuara nga anëtarët e komunitetit minoritar të cilët nuk gëzojshin lirinë e lëvizjes për shkak të ndjenjës së frikës apo situatës reale të sigurisë.

Më tutje, në njohjen e faktit që shumica e paraqitësve të kërkesës ishin të shpërndarë në tërë Serbinë, në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (IRJM) dhe në Mal të Zi, që nga viti 2001 e tuje ishin hapur zyre përfaqësuese në Shkup (IRJM) dhe Beograd (Serbi) me filialën në Podgoricë (Mal të Zi), me qëllim të lehtësimit të pranimit të kërkesës.<sup>86</sup>

Qysh nga fillimi i saj në vitin 1999, HPD ishte drejtuar nga Drejtori Ekzekutiv i cili ishte emruar nga PSSP-ja pas konsultimit me Drejtorin Ekzekutiv të UN-Habitatit.<sup>87</sup> Fillimisht për shkak të fondit të kufizuar, Kryekëshilltari Teknik në UN-Habitat ishte ushtrues i detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të HPD-së, por kjo kishte ndryshuar në Gusht 2001 me emrimin e Drejtorit të parë të përhershëm Ekzekutiv.

Drejtori Ekzekutiv kishte përcaktuar strukturën organizative të HPD-së dhe ishte autorizuar të caktoj stafin e tij vendor dhe ndërkombëtarë.<sup>88</sup> Ai apo ajo ishte përgjegjës/e për udhëheqjen e përgjithshme të HPD-së dhe për formulimin e politikës, sigurimin e fondit për institucionin dhe raportimin e saj ndaj UNMIK-ut përmes komponentës së saj të administratës civile (Shtylla e II-të, prej pranverës 2006 Departamenti për Administratë Civile). Ai apo ajo gjithashtu i ka raportuar IPVQ-së dhe komunitetit të donatorëve dhe grupit të interesuar në fushën e të drejtave pronësore. Qysh nga fillimi i saj, katër persona kanë qenë Drejtor Ekzekutiv të HPD-së.<sup>89</sup> Institucioni është rritur gjatë kohës për të përfshirë 250 punëtorë profesional dhe punëtorë tjetër, përfshirë avokatë, asistentë juridik, përkthyes, llogaritar, ekspertë për kompjuterë dhe TI dhe staf mbështetës administrativ.

Përveç zyrës së Drejtorit Ekzekutiv, njësitet kryesore organizative të HPD-së ishin Njësi Qendror për Përpunimin e Lëndës (CCPU), Njësi për Verifikim, Departamenti i Operativës, Kryesekretaria, Njësi i TI, Njësi i Shërbimit të Kartotekës dhe Njësi për Informim.<sup>90</sup>

---

<sup>85</sup> Zyra regjionale ishin hapur në Gjilan, Mitrovicë, Pejë dhe Prishtinë në vitin 2001 dhe në Prizren në vitin 2003. Më tutje, në vende më të gjera të minoriteteve (të ashtuquajtura enklava) ishin hapur zyre fushore të cilat fillimisht shërbenin si qendra për pranimin e kërkesave dhe lehtësimin e dorëzimit palëve të vendimeve të HPCC-së, dhe dhënia e informatave mbi statusin e kërkesave dhe procedurave të HPD-së në tërësi. Zyra fushore ishte hapur në Graçanicë.

<sup>86</sup> Me 1 Nëntor 2001, pas negociatave të stërzgjatura me RFJ- zyrtarët e qeverisë, ishte nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit mes Qeverisë së Republikës së Jugosllavisë dhe UN-Habitatit, i cili i kishte lejuar HPD-së të operoj në Serbi. Shëno gjithashtu se Raporti Vjetor i HPD-së për vitin 2004, i cili ofron shpjegime në detale në strukturën e saj institucionale, është i mundur në [www.hpdkosovo.org](http://www.hpdkosovo.org). Regjistri i plot i adresave dhe detalet për kontakt për Zyrat Kryesore dhe të gjitha Zyret Regjionale të HPD-së janë të mundura në [www.hpdkosovo.org](http://www.hpdkosovo.org).

<sup>87</sup> Shih nenin 3 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23.

<sup>88</sup> Shih nenin 3 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23.

<sup>89</sup> Shih Aneksin 4.

<sup>90</sup> Detyra e Zyrës Ekzekutive ishte të kryej shërbime të veçanta në lidhje me rekrutimin, prokurimin, llogaritjen, logjistikën përfshirë mbështetjen e TI, dhe marrëdhëniet me publikun. Departamenti i Operativës ka koordinuar të gjitha aktivitetet operative në fushë përmes zyrave të saj regjionale. CCPU

Me qëllim të udhëheqjes së portofolit të funksioneve të saj, në mënyre efikase, HPD-së duhej të siguronte që themelimi administrativ, struktura dhe shpërndarja e personelit e cila ishte rregulluar gjatë kohës me qëllim të përmbushjes së nevojave dhe nxjerrjen e prioriteteve të institucionit. Në periudhën e fillimit të saj, fokusimi kryesor ishte në marrjen dhe përpunimin e kërkesës, ndonëse kjo gjatë kohës ishte bartur në implementimin e kërkesës, përmes zbatimit të urdhrave për dëbim dhe udhëheqjes së pronave të cilat ishin vënë nën administrimin e saj të përkohshëm.

## 2. Mbështetja Juridike

Komponenta kryesore e HPCC-së ishte Kryesekretaria, e cila ka ofruar HPCC-së mbështetje të domosdoshme administrative, teknike dhe juridike<sup>91</sup> dhe ka paraqitur lidhjen në mes HPD-së dhe HPCC-së. Kryesekretaria ishte me staf dhe administrohej nga HPD në konsultim me HPCC-në.<sup>92</sup> Përbëhej nga një numër kryesekretarësh dhe stafit plotësues mbështetës juridik dhe administrativ. E kishte Kryesekretarin për vendimmarrje, i cili ishte përgjegjës për ndihmë HPCC-së në periudhën e cila të qonte deri në vendimmarrje, përfshirë kategorizimin dhe referimin e kërkesave tek HPCC-ja dhe hartimin e vendimeve. Kryesekretaria për vendimmarrje ishte nën kontroll të HPCC-së.<sup>93</sup>

Kryesekretaria gjithashtu e kishte kryesekretarin për implementim, i cili ishte përgjegjës për lëshimin e urdhrave për dëbim të domosdoshëm për implementimin e vendimeve të HPCC-së. Në vitin 2006 zyra përbëhej nga Kryesekretari i cili ishte përgjegjës për mbylljen dhe përgatitjen e dorëzimit të të gjitha dosjeve të rasteve tek institucionet e caktuara vendore.

---

ishite përgjegjës për shqyrtimin dhe procedimin e kërkesave, dhe draftimin e propozimeve mbi kërkesat në referimin tek HPCC. Shërbimet e Kartotekës kanë mbajtur dhe mirëmbajtur të dhënat e reja të të gjitha dosjeve dhe ishte përgjegjës për përditësimin e data-bazës për secilën kërkesë sa i përket dokumenteve të pranuar dhe statutin e procedimit të kërkesës. Njësitë për Verifikim ishte përgjegjës për të bërë hetime dhe verifikim të dokumenteve, e cila ishte bërë nga njësitë i specializuar i nëpunësve për verifikim dhe që ishte kërkuar në secilin rast nga zyrtarët juridik të njësitit qendror mbi procedimin e lëndës të përfshirë në hetimin dhe procedimin e kërkesave. Në dy vitet e para të operimit njësitë për verifikim ishte centralizuar në Zyrat Kryesore të HPD-së. Në fund të vitit 2002 ato njësitë ishin decentralizuar dhe ishin shpërndarë në zyrat regjionale, përveç bërthama e njësitit për verifikim për kategoritë e kërkesave A dhe B kishte mbetur në Zyrat Kryesore të HPD-së në Prishtinë. Njësitit për Informim ishte përgjegjës për njoftimin e palëve mbi statutin e kërkesave të tyre, dhe gjithashtu njoftimin e paraqitësve të kërkesave mbi vendimin e HPCC-së, duke njoftuar ata mbi mundësitë e tyre për implementim të vendimit dhe duke caktuar me ata për dorëzimin e vendimit të tyre. Njësitë gjithashtu ka pasur për detyrë të merret me pyetjet e përgjithshme në lidhje me statutin e kërkesave dhe që nga viti 2005 e tutje kjo informatë ishte e mundur gjithashtu në faqen elektronike të HPD-së. Njësitë për Zbatim ishte përgjegjës për ekzekutimin e urdhrat për dëbim, kur ishte e domosdoshme, me kërkesën e paraqitësve të suksesshëm të kërkesës për riposëdimit apo që të vëjë pronën e tyre nën administrim të HPD-së.

<sup>91</sup> Shih nenin 17.13 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>92</sup> Shih nenin 17.13 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>93</sup> Shih nenin 17.13 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

Kryesekretarët janë emruar nga Drejtori Ekzekutiv i HPD-së në konsultim me Kryesuesin e HPCC-së.<sup>94</sup>

### 3. Raporti me UNMIK-un

Pas nxjerrjes së Rregullores së UNMIK-ut 1999/10 mbi themelimin e HDP-së/HPCC-së, për shkak të natyrës specifike të çështjeve të pronës, PSSP kishte kërkuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Vendbanime të Njerëzve UN-HABITAT<sup>95</sup> t'i ofrojë UNMIK-ut politikën e nevojshme, ndihmë teknike dhe juridike në çështjet e pronës dhe i kishte dhënë mandatin të udhëheq dhe implementoj operacionet e HPD-së. Me Letrën e Marrëveshjes të datës 14 Janar 2000, UNMIK-u zyrtarisht kishte ftuar UN-Habitatin t'i ofroj mbështetje të politikave HPD-së dhe të marr përgjegjësin për të udhëhequr, rekrutuar dhe të koordinoj programin dhe mekanizmat e tij institucional. UNMIK-u kishte marrë përsipër të ofroj udhëheqjen e politikave, të mbikëqyrë dhe monitorojë aktivitetet e HPD-së, dhe duke pasur parasysh kufizimet operative, të ofrojë mbështetje logjistike dhe të përfshihet në grumbullimin e përbashkët të fondeve për projektin me UN-Habitatin . Kjo marrëveshje ka pasur domethënie që HPD, në kohën e fillimit të saj, nuk e kishte aftësinë e vet administrative dhe në mënyrë operative ishte e varur nga agjencia e saj implementuese (UN-Habitati) dhe në një masë më të vogël nga UNMIK-u.

Kjo ka pasur implikime domethënëse për efektivitetin e operacioneve të HPD-së. Si pasojë e drejtpërdrejt, mbështetje administrative dhe logjistike për institucionin ishte e dobët gjatë tërë periudhës së fillimit e cila ka rrjedhur në procesin fillestar duke qenë kryesisht i ngadalshëm se sa fillimisht kur ishte parashikuar.<sup>96</sup>

Në Korrik 2002, UN-Habitati dhe UNMIK-u kishin nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit (MOU) i cili obligonte që të gjitha operacionet e HPD-së/HPCC-së brenda Kosovës të barten tek UNMIK-u. Kjo HPD-në/HPCC-në e themelonte si entitet të pavarur juridik me kapacitetin e vet administrativ dhe financiar që të kryej funksionet themelore operative dhe administrative. Megjithatë, me qëllim të sigurimit të mbështetjes dhe udhëheqjes, Paragrafi 4, Neni 1 i MOU-së qartazi kërkonte që UNMIK-u, UN-Habitati dhe përfaqësuesit e donatorëve t'i ofronin këshilla dhe mbikëqyrje të përgjithshme HPD-së përmes themelimit të Bordit Këshilldhënës. Gjithashtu në atë kohë ishin pajtuar që mbështetja e UNMIK-ut do të ishte e rëndësishme të vazhdohet tutje dhe që UN-Habitati do të transferonte përgjegjësit e implementimit tek HPD, përveç në lidhje me operacionet

<sup>94</sup> Shih nenin 17.13 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>95</sup> UN-Habitati qendër kryesore e ka në Nairobi, Kenya, dhe ka mandatin të mbështesë qytetet dhe qytezat që do të ishin të qëndrueshme në kuptimin shoqëror dhe mjedisor, me synim të ofroj strehim adekuat për të gjithë, për më tutje shih [www.unhabitat.org](http://www.unhabitat.org).

<sup>96</sup> Fondet e donatorëve për HPD-në dërgoheshin drejtpërdrejt më UN-Habitat. Më vonë, të gjitha kërkesat për prokurim, personel dhe ato administrative është dashur të shkojnë përmes procesit të prokurimit të UN-Habitatit, i cili fillimisht ishte i centralizuar në Zyrat Kryesore të tij (HQ) në Nairobi, Kenya. Kjo e bënte që për logjistikën të kishte shpenzime të mëdha dhe tepër të komplikuar, duke bërë që operacionet në terren të jenë shumë të kufizuara. Procesi i aprovimit të prokurimit kërkonte përfshirjen e gjashtë niveleve të ndryshme të menagjmentit, duke përfshirë tri organizata të ndryshme të cilat gjendeshin në tri kontinente të ndryshme, gjë që ishte dëshmuar të jetë shumë e pavolitshme dhe humbje kohe. Kishte rezultuar me shtyrje të stërzgjatura administrative në prokurim, për lëshimin dhe zgjatjen e kontratave dhe pagesën e rrogave, ku të gjitha këto kishin ndikuar negativisht në efektivitetin e përgjithshëm të institucionit.

në Serbi, ku UNMIK-u nuk kishte mandatin të operoj. Sipas MOU-së, UN-Habitati i kishte dorëzuar UNMIK-ut operacionet në Kosovë në nëntor 2002. Fakti se Serbia nuk e kishte njohur prezencën ndërkombëtare në Kosovë kishte rezultuar me marrëveshjen përmes së cilës përgjegjësit zyrtarë për operacionet e HPD-së në Serbi dhe Mal të Zi i kishin mbetur UN-Habitatit. Kjo pozitë ishte deri në Gusht 2004 kur ishte bërë dorëzimi zyrtar i operacioneve tek Zyra e Kombeve të Bashkuara në Beograd (UNOB). Operacionet e mëvonshme mbi këtë çështje ligjshmërisht ishin mbuluar nga Zyra e Kombeve të Bashkuara në Beograd.

Anëtarët e HPCC-së kishin marr pjesë në takimin e Bordit Këshilldhënës në dhjetor 2005 dhe kishin prezantuar vërejtjet e tyre në hartimin e legjislacionit për të themeluar kornizën ligjore për të zgjidhur kontestet e pronës bujqësore dhe komerciale. Duke vepruar sipas kërkesës së Kryesuesit të Bordit, anëtarët e HPCC-së më vonë kanë ofruar komente gjithëpërfshirëse mbi hartimin e legjislacionit.<sup>97</sup>

---

<sup>97</sup> Më pas, me 4 Mars 2006, UNMIK-u nxjerr Rregulloren 2006/10 e cila themelon Agjencinë Kosovare për Pronën (KPA) dhe Komisionin i Kosovës për Kërkesa Pronësore (HPCC).

## -KAPITULLI 4

### KORNIZA E APLIKUESHME LIGJORE DHE PROCEDURAT

#### 1. Ligji i aplikueshëm në Kosovë

Tërë kompetenca legjislativë dhe ekzekutive i është dhënë UNMIK-ut dhe do të ushtrohet nga PSSP-ja.<sup>98</sup> Në korrik të vitit 1999, PSSP-ja shpalli Rregulloren e UNMIK-ut 1999/1 e cila përveç tjerash parashihte që UNMIK-u të kryente detyrat e tij sipas KS 1244<sup>99</sup> duke lëshuar veprimet ligjore në formë të Rregulloreve.<sup>100</sup>

Rregullorja e UNMIK-ut 1999/1 mbi kompetencën e administrimit të përkohshëm në Kosovë, e ndryshuar sipas Rregullores 1999/24, regulloi sistemin ligjor në Kosovë e cila përbënte një përzierje të ligjeve Autonome të Kosovës para vitit 1989, ligjeve të RFJ-së të pas vitit 1989, Rregulloreve të UNMIK-ut, instrumenteve ndihmëse dhe standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.<sup>101</sup>

Rregulloret e UNMIK-ut dhe instrumentet ndihmëse zëvendësuan të gjitha ligjet e mëparshme të cilat rregullonin lëndën e njëjtë. Ligjet vendore në fuqi deri në mars të vitit 1989, kur Kosova humbi autonominë e saj, ishin të zbatueshme për sa i përket rregullimit të çështjeve të cilat UNMIK-u nuk i mbulonte. Sa i përket legjislacionit pas vitit 1989, ajo mund të zbatohet vetëm në rrethana të kufizuara si për shembull kur gjykata apo organi apo personi që kërkohej të zbatonte dispozitën e ligjit përcaktonte se çështja në fjalë apo situata nuk ishte përfshirë në ligjet e para vitit 1989, por ishte përfshirë në një ligj tjetër në fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989, i cili nuk ishte diskriminues apo në mospërputhje me standardet për të drejtat e njeriut.<sup>102</sup>

#### 2. Ligjet e aplikueshme për Zgjidhjen e kërkesave pronësore

---

<sup>98</sup> Shih raportin e sekretarit të përgjithshëm mbi UNMIK-un, UN, UN SCOR, séances së 54, dokumenti UN S/1999/779 (1999) në Pragrafin 35 dhe 39.

<sup>99</sup> Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1244, e shqyrtuar në kapitullin 1 të këtij raporti

<sup>100</sup> Shih Rregulloren e UNMIK-ut 1999/1 mbi kompetencat e administrimit të përkohshëm në Kosovë.

<sup>101</sup> Shih nenin 1.1 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 mbi ligjin e aplikueshëm në Kosovë të ndryshuar sipas Rregullores së UNMIK-ut 2000/59.

<sup>102</sup> Shih nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24



Korniza ligjore dhe procedurat që udhëheqnin zgjidhjen e kërkesave pronësore bazohej në kombinimin e Rregulloreve të UNMIK-ut, vendimeve të HPCC-së dhe udhëzimeve dhe ligjeve vendore pronësore.

### ***Rregulloret e UNMIK-ut***<sup>103</sup>

Rregullorja e UNMIK-ut 1999/23 themeloi institucionet, mandatet dhe funksionet e tyre përkatëse. Kjo rregullore gjithashtu parashihte cakun e kërkesave që bien nën juridiksionin e HPD/HPCC-së dhe juridiksionin vendimmarrës të HPCC-së, por nuk përcakton rregullat e procedurës në zgjidhjen e kërkesave me përjashtim që neni 2.6 të parashihte që PSSP-ja “*themelon rregullat e procedurës me rregullore dhe dëshmitë e Komisionit, me rekomandim të Komisionit*” dhe kërkoi që rregullat e tilla “*të garantonin veprime të drejta dhe të paanshme në përputhshmëri me standardet për të drejtat e njeriut.*”<sup>104</sup> Më pas, Rregullorja e UNMIK-ut 2000/60 mbi kërkesat pronësore banesore dhe rregullat e procedurës dhe dëshmitë e HPD-së dhe HPCC-së u shpallën, dhe përcaktuan rregulla në detaje të procedurës dhe dëshmi që drejtonin zgjidhjen dhe zbatimin e kërkesave.<sup>105</sup> Kjo Rregullore u shpall pas përpjekjeve të mëdha të HPCC-së dhe shtyllës së II të UNMIK-ut, në konsultim me pushtetin lokal përmes Këshillit të Bashkuar Këshillues (JAC) dhe Këshillit të përkohshëm administrative (IAC).<sup>106</sup> Dispozitat e hartuara të Rregullores gjithashtu iu nënshtruan një rishikimi të gjerësishëm para se të shpalleshin në tetor të vitit 2000.

Në hartimin e rregullave të procedurës dhe të dëshmimeve është e njohur se miratimi i procedurave të zakonshme kundërthënëse që rrespektonin seancat dëgjimore dhe të drejtat e hollësishme procedurale – shqyrtimin e plotë dhe trajtimin e veçantë të kërkesave, me qasje lëndë - për - lëndë dhe proces kundërthënës – nuk mund të siguronte vendimmarrje të shpejtë dhe duhej të balancohej me të drejtën e kundërveprimit të paraqitësit të kërkesës që kërkesa e tyre të dëgjohej brenda një periudhe të arsyeshme kohore.<sup>107</sup> Gjithashtu ishte pranuar nga HPCC-ja dhe hartuesit e tjerë të Rregullores se përpunimi i lëndës, derisa plotësisht i njohur dhe i respektuar nga HPCC-ja, nuk mund të aplikohet në mënyrën me të cilën do të vinte në pyetje të drejtën përkatëse të paraqitësit të kërkesës për të dëgjuar kërkesën e tyre brenda një periudhe të arsyeshme kohore,

<sup>103</sup> Rregulloret e UNMIK-ut 1999/23 dhe 2000/60 janë të bashkangjitura në shtojcën II.

<sup>104</sup> Në veçanti, rregullat duhej të përfshinin dispozitat mbi rishqyrtimin e vendimeve të HPCC-së

<sup>105</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2000/60 u shpall më 31 tetor 2000.

<sup>106</sup> JAC është Këshilli i bashkuar këshillues në çështje legjislativë dhe IAC është Këshilli I përkohshëm administrativ. Këto organe janë themeluar për të përfaqësuar komunitetin vendor derisa institucionet legjitime të vinin në vend.

<sup>107</sup> Kjo është një konsideratë primare në dizajnimin e çfarëdo procesi të një numri të madh kërkesash, shih Heiskanen, V., Komisioni i Kombeve të Bashkuara për kompensim: Rregullat e vjetra, procedurat e reja mbi riparimet, 13 Revista Europiane e Ligjit ndërkombëtar (2002), faqe 161; Korigjimin e padrejtësisë përmes proceseve të një grumbulli kërkesash, Përgjigje përptëritëse ndaj sfidave unike’ Kapitujt 1-3; “Qasje të reja ndaj dëshmimeve dhe zgjidhjeve të kërkesave në proceset ndërkombëtare të numrit të madh të kërkesave” Thesalonica, 7 tetor 2005 në fq. 1-2 dhe fq. 5-8.

<sup>107</sup> HPCC/RES/7/2003 i datës 11 prill 2003.

meqenëse lënja mënjatë e aspektit kohor në mënyrë të pashmangshme do të nënkuptonte mohimin e drejtësisë – ‘drejtësia e vonuar është drejtësia e mohuar’.<sup>108</sup> Ekstrakti në vijim nga rezoluta e HPCC-së përshkroi ekuilibrin që duhej të arrihej në hartimin e dispozitave:

*“një organizim i drejtë dhe efikas i procesit të një numri të kërkesave kërkon që mjetet e një numri të kërkesave siç është grupimi i kërkesave dhe gjurmimi i shpejtë i kërkesave të thjeshta janë përdorur për organizimin e procesit të kërkesave; në këto rrethana, i pari që vjen i pari shërbehet nuk mund të përdoret si kriter më dominant në përcaktimin se cilat kërkesa duhet të përpunohen së pari, meqenëse përqëndrimi në kërkesa individuale në bazë të të dhënave të dosjes do të pengonte dhe ngadalësonte procesin dhe në këtë mënyrë do të ndikonte kundër interesave legjitime të një numri të madh të paraqitësve të kërkesës.”<sup>109</sup>*

Prandaj theksi i është kushtuar hartimit të rregullave të procedurave që bëjnë ekuilibrimin duke siguruar përpunimin e lëndës, në të njëjtën kohë duke arritur shpejtësinë dhe efikasitetin. Procesi miratoi procedura të cilat kërkuan teknika për përpunimin e një numri të madh kërkesash duke paraqitur kriteret të rrepta dhe objektive për të përcaktuar nëse kërkesa binte brenda kategorisë së caktuar me pak vend për liri të veprimit, një qasje të inkuizicionit në nivelin e përpunimit të kërkesave, qasje jo armiqësore dhe procedurë me shkrim në nivelin vendimmarrës, dhe standarde të dëshmimeve të përshtatshme për natyrën e veçantë të procesit. Korniza gjithashtu u ofroi palëve të drejta të rëndësishme procedurale në mënyrë që të siguroj integritetin e procesit dhe procedura të drejta. Hartimi i rregullores gjithashtu u ndikua nga përvoja e marrë në Bosnjë e Hercegovinë ku u krijua një mekanizëm i ngjashëm i kthimit për zgjidhjen e kërkesave pronësore në vitet e fundit të 1990-ve.<sup>110</sup>

Kapitulli I i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 përcaktoi një numër të dispozitave të pavarura dhe parimeve të përgjithshme që drejtonin procesin e kthimit si në vijim:

- (i) Çdo e drejtë në pronë që është fituar në mënyrë të drejtë në pajtim me ligjin në fuqi në kohën kur është fituar mbetet e vlefshme, përveç në rastet kur kjo Rregullore përcakton ndryshe;
- (ii) Çdo person i cili ka humbur pronën banesore pas vitit 1989 si rezultat i diskriminimit kishte të drejtë në kthimin e asaj prone;
- (iii) Çdo transaksion i lidhur pas vitit 1989 ishte i paligjshëm për shkak të aplikimit të ligjit diskriminues, por që përndryshe do të ishte i vlefshëm, ishte i vlefshëm;

<sup>108</sup> Heiskanen, V., *op. cit.* shenimi 107

<sup>109</sup> HPCC/RES/7/2003 i datës 11 prill 2003 në përgjigjen e letrës së datës 25 shkurt 2003 nga ombudspersoni, Marek Antony Novicki.

<sup>110</sup> CRPC-ja kishte përgjegjësi të ngjashme lidhur me pranimin e kërkesave, verifikimit të dokumenteve, hetimit të kërkesave dhe mbledhjes së dëshmimeve plotësuese. Megjithatë ato ndryshonin në atë se procesi i HPD/HPCC-së kishte elemente të rëndësishme gjyqësore dhe u ngarkua me kompetencën e zbatimit të vendimeve, përmes lëshimit të përmbarimit të urdhrave për dëbim në rastet kur kjo ishte e nevojshme.

- (iv) Çdo refugjat apo person i zhvendosur i cili ka humbur posedimin e pronës banesore ka të drejtë kthimi në atë pronë apo të heq dorë nga ajo në pajtim me ligjin.<sup>111</sup>

Neni 4 parashihte një skemë të kthimit dhe kompensimit në mënyrë që të zgjidh rastet ku e drejta banesore dhe pronësore e kërkesave konkurrese ishin parashtruar në lidhje me pronën.<sup>112</sup> Neni 5 përpiquej të mbronte procesin e kthimit të pronës dhe të ruante status quon duke imponuar kufizime mbi disponueshmërinë e banesave të cilat mund të ishin objekt shqyrtimi të kërkesës para HPCC-së, deri në zgjidhjen e procedurës.<sup>113</sup> Ky kufizim vleu deri pas skadimit të afatit për parashtrimin e kërkesave, përkatësisht korrik 2003 apo deri në zgjidhjen e kërkesës, cilado që ishte më e vonuar, dhe parandaloi personat që të bënin bartjen e banesave çfarëdo personi tjetër, përveç në rastet kur bartja ishte pjesë e ndonjë marëveshjeje miqësore të kërkesës. Çdo kontratë që kishte të bënte me shitjen, shkëmbimin apo dhuratën e bërë në kundërtënie me nenin 5 ishte i pavlefshëm dhe i anuluar.<sup>114</sup>

Kapitulli II udhëhoqi punën e HPD-së dhe përcaktoi procedurat për mbledhjen dhe regjistrimin e kërkesave, notifikimin dhe pjesëmarrjen e palëve, zbatimin e vendimeve të

---

<sup>111</sup> Neni 2 parashihte parimet e përgjithshme dhe mjetet ndihmëse në vijim: “ 2.1 Çdo e drejtë në pronë, që është fituar në mënyrë të drejtë në pajtim me ligjin në fuqi në kohën e fitimit të saj, mbetet e vlefshme përkundër ndërrimeve në ligjislacionin në fuqi të Kosovës, përveç në ato raste kur kjo Rregullore përcakton ndryshe. 2.2 Çdo person i cili e ka humbur të drejtën në pronë në periudhën ndërmjet datës 23 mars 1989 dhe datës 24 mars 1999 si pasojë e diskriminimit, ka të drejtë për rikthimin e saj në pajtim me këtë Rregullore. Kthimi mund të jetë në formë të rikthimit të së drejtës mbi pronën (tash e tutje “kthimi në lloj”) ose kompensim. 2.3 Çdo transaksion i pronës i bërë ndërmjet datës 23 mars 1989 dhe datës 13 tetor 1999, që ka qenë i paligjshëm në bazë të dispozitave të Ligjit mbi kushtet e veçanta për qarkullimin e paluajtshmërive (Gazeta zyrtare e RSS 30/89, sipas ndryshimeve me ligjet e publikuara në Gazetën zyrtare të RSS nr. 42/89 dhe 22/91) apo të ndonjë ligji tjetër diskriminues, që përndryshe do të ishte qarkullim i ligjshëm, është i vlefshëm. 2.4 Çdo person që ka fituar të drejtën e pronësisë në një pronë nëpërmjet ndonjë transaksioni jozyrtar ndërmjet datës 23 mars 1989 dhe 13 tetor 1999, bazuar në vullnetin e lirë të palëve, ka të drejtë në urdhëresën e Drejtorisë ose të Komisionit për regjistrimin e pronësisë së vet në regjistrat përkatës publik. Një urdhër i këtillë nuk vën ndonjë obligim për të paguar ndonjë taksë apo ngarkesë lidhur me pronën ose qarkullimin e pronës. 2.5 Çdo refugjat ose person i zhvendosur, me të drejtë mbi pronën, gëzon të drejtën e kthimit të pronës ose të heq dorë nga ajo në pajtim me ligjin dhe në përputhje me këtë rregullore. 2.6 Çdo person me të drejtë në pronë më 24 mars 1999, i cili e ka humbur posedimin në atë pronë dhe nuk ka hequr dorë vullnetarisht nga e drejta në pronë, i lejohet të marrë një urdhër nga Komisioni për riposëdim të pronës. Komisioni nuk do të pranojë kërkesa për kompensimin e dëmtimeve apo të shkatërrimeve të pronës.

<sup>112</sup> Shih më tej kapitullin 7 të këtij raporti.

<sup>113</sup> Ky kufizim vlente për secilin person i cili kishte blerë banesën nga bartësi i së drejtës së ndarjes në përputhje me ligjin mbi banimin, ku as ai person dhe as ndonjë anëtar i familjes së tij të ngushtë nuk ishte bartës i të drejtës së banimit para 23 marsit 1989, shih nenin 5.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>114</sup> Shin nenin 5.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

HPCC-së dhe dosjimin e kërkesave për rishqyrtim. Kapitulli II përcaktoi rregullat e procedurës dhe të dhënave të aplikueshme në shqyrtimin e kërkesave para HPCC-së.

UNMIK-u gjithashtu lëshoi rregullore tjera që ishin të rëndësishme në çështjet e të drejtave pronësore si në vijim:

- Rregullorja 1999/2 mbi parandalimin e hyrjes së individëve dhe largimit të tyre me qëllim të ruajtjes së qetësisë dhe rendit publik;<sup>115</sup>
- Rregullorja 1999/10 mbi shfuqizimin e legjislacionit diskriminues lidhur me çështjet banesore dhe të drejtat mbi pronën;<sup>116</sup>
- Rregullorja 2000/47 mbi statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe të Personelit të tyre në Kosovë.<sup>117</sup>
- Rregullorja 2001/9 mbi kornizën kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme në Kosovë.<sup>118</sup> Kjo Rregullore gjatë transferimit të fushave të rëndësishme të administrimit institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse (IPVQ-të) qartë mbajti HPD-në nën fuqitë e veçanta të PSSP-së.
- Rregullorja 2001/17 mbi regjistrimin e kontratave për shitje të pronës së patundshme në zona të veçanta gjeografike në Kosovë.<sup>119</sup>

### ***Rregullat plotësuese dhe udhëzimet e HPCC-së***

Rregullorja lejoi HPD-në dhe HPCC-në që të mirtoj rregulla plotësuese për kryerjen e funksioneve të tyre përkatëse, me kusht që të jenë në përputhje me Rregulloren.<sup>120</sup> Në pajtim me këtë kompetencë HPCC-ja miratoi rregulla plotësuese në format të konsoliduar të cilat jepnin hollësi të mëtejme mbi procedurat e përcaktuara në Rregulloren e UNMIK-ut 200/60,<sup>121</sup> dhe lëshoi udhëzime të cilat rregulluan procesin e rishikimit të kërkesave.

Udhëzimet të cilat me kohë u zhvilluan plotësuan procedurat ekzistuese të përcaktuara në Rregulloren e UNMIK-ut 2000/60 dhe gjithashtu adresuan gabimet dhe mungesat sistematike që u shfaqën në hetimet dhe përpunimin e kërkesave. Këto udhëzime krijuan procedura që duhej të përdreshin në zgjidhjen e kërkesave të përbashkëta dhe pyetjeve të ngritura në të gjitha kërkesat e ardhshme, se sa në baza lëndë pas lënde. Në

---

<sup>115</sup> Kjo Rregullore është shpallur më 12 gusht 1999.

<sup>116</sup> Kjo Rregullore është shpallur më 13 tetor 1999

<sup>117</sup> Kjo Rregullore është shpallur më 18 gusht 2000 dhe kishte komplikime për zbatimin e vendimeve të HPCC-së sa i përket pronave që ishin të banuara nga KFOR-i dhe personeli i tij.

<sup>118</sup> Kjo Rregullore u shpall më 15 maj 2001.

<sup>119</sup> Kjo Rregullore u shpall më 22 gusht 2001. Ajo impononte kontrollin mbi shitjen e pronës private të minoritarëve kur shitja kishte potencialin e ndryshimit të bazave etnike në atë zone, apo mund të ndikonte në situatën e sigurisë në dëm të bartësve të së drejtës pronësore të minoriteteve tjera.

<sup>120</sup> Shin nenin 16 dhe 26 të Rregullores së UNMIK-ut, respektivisht 2000/60.

<sup>121</sup> Shin aneksin III. Rregullat plotësuese që kishin shumë lidhshmëri me masat e përkohshme, kërkesat rishqyrtuese dhe zbatimin e vendimeve të HPCC-së.

secilën nga seancat e saj HPCC-ja identifikoi fushat ku nevojiteshin udhëzime të mëtutjeshme në mënyrë që të siguroj pajtim në zgjidhjen e kërkesave dhe përputhshmëri me ligjin në fuqi.

Këto kritere dhe udhëzime që u zhvilluan me kohë u përfshinë në grupin e udhëzimeve të cilat iu komunikuan gjithë personelit të përfshirë në procesin e zgjidhjes së kërkesave nga zyra e Kryesekretarisë dhe siguroi që kërkesat e përpunimit të lëndës të respektoheshin në procesin e rishikimit të kërkesave. Udhëzimet u lëshuan për një sërë çështjesh, përfshirë verifikimin e dokumenteve, njoftimin e kërkesave, përgatitjen dhe përmbajtjen e raporteve përpunuese, hartimin e raporteve përpunuese mbi kërkesat (d.m.th. parashtresat ligjore) për HPCC-në, dhe përgatitjen e drafteve për vendimet e HPCC-së. Ata siguruan që praktika të jetë në pajtueshmëri me procedurën në përpunimin dhe prezentimin e kërkesave. HPD-ja duhej të vëzhgonte me kujdes dhe të siguronte pajtueshmëri me procedurat e përcaktuara në jurisprudencën dhe udhëzimet e HPCC-së, në lidhje me çështjet procedurale dhe dëshmuese.

Këto udhëzime përmenden dhe shqyrtohen më tej në kapitujt që kanë të bëjnë me përpunimin e kërkesave dhe me vendimmarrjen.

### ***Ligjet vendore***

Ligjet e pavarura ndaj të cilave HPD/HPCC-ja kishte konsiderate në mënyrë që të përcaktoj të drejtat pronësore ishin kryesisht në përbërje të ligjeve pronësore vendore në fuqi, kryesisht në ligjet mbi marrëdhëniet banesore<sup>122</sup> dhe ligjit mbi banimin.<sup>123</sup> Disa ligje tjera të rëndësishme vendore ndaj të cilave HPD/HPCC-ja kishte konsiderate ishin:

- Ligji mbi marrëdhëniet themelore pronësore (gazeta zyrtare e RSFJ-së, nr.6/80);
- Ligji mbi eksproprijimin (gazeta zyrtare e KSA Kosovës, nr. 37/71);
- Ligji mbi bashkëpronësinë e banesës (gazeta zyrtare e KSA të Kosovës, nr.43/80, 22/87);
- Ligji mbi ndërtimin e anekseve për ndërtesat dhe shndërrimin lokaleve të përbashkëta në banesa (gazeta zyrtare e KSA të Kosovës, nr.14/88);
- Ligji mbi bartjen e pasurisë (gazeta zyrtare e KSA të Kosovës, nr.45/81, 29/86, 26/88);
- Ligji mbi Regjistrimin e Pronave të Paluajtshme në pronësi shoqërore (gazeta zyrtare e KSA të Kosovës, nr. 37/71).

### ***Korniza e aplikueshme e të drejtave të njeriut***

Rregullorja e UNMIK-ut 1999/1 përcaktoi se si duhet të ushtrohet kompetenca ekzekutive dhe legjislative nga UNMIK-u dhe detyroi të gjithë personat të cilët ndërmerrnin detyra publike apo mbajnë poste shtetërore të vëzhgonin standardet e

<sup>122</sup> Gazeta zyrtare e KSA të Kosovës nr. 11/83, 29/86, 42/86.

<sup>123</sup> Gazeta zyrtare e republikës së Serbisë nr. 50/92.

njohura ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.<sup>124</sup> Më tej, standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut ishin pjesë e ligjit të aplikueshëm përmes, *inter alia*, Rregullorja e UNMIK-ut 1999/24, (e ndryshuar nga 2000/59).<sup>125</sup> Neni 1.3 i Rregullores kërkonte pajtueshmëri me standardet e përcaktuara në instrumentet në vijim.

- Deklarata Univerzale e të Drejtave të Njeriut;
- Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe protokolet në të sipërpërmendurën;
- Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike dhe protokolet në të;
- Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat ekonomike Sociale dhe Kulturore;
- Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
- Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave;
- Konventa Kundër Torturimit dhe Trajtimeve apo Degradimet Tjera Jonjerëzore apo Degraduese;
- Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Fëmijëve.

---

<sup>124</sup> Shih nenin 2 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/1 e cili ndalon diskriminimin ndaj çdo personi në çfarëdo baze si gjinia, raca, ngjyra, gjuha, feja, pikëpamjet politike dhe të tjera, origjina shoqërore apo kombëtare, asosimit me komunitetin kombëtar, pronën, lindjen apo statusin tjetër.

<sup>125</sup> Megjithatë duhet të vihet re se këto Rregullore dështuan që në mënyrë të qartë të krijonin sovranitetin e standardeve për të drejtat e njeriut si kornizë brenda të cilit KFOR-i dhe UNMIK-u duhet të përcaktojnë përmasën dhe kualitetin e veprimeve të tyre, shih Cordial M., Aplikueshmëria e ligjit humanitar Ndërkombëtar dhe Ligjit Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut ndaj forcave me mandat nga KB, i publikuar në Komisionin Ndërkombëtar të Raportit të Kryqit të Kuq në takimin e ekspertëve në Gjenevë, dhjetor 2003, që gjindet në [www.icrc.org](http://www.icrc.org). Komisioni nga Venediku i Këshillit Europian identifikoi këtë mungesë të përgjegjësisë dhe propozoi krijimin e një institucioni vendor ad hoc për rishikimin e ankesave për të drejtat e njeriut kundër UNMIK-ut dhe KFOR-it, shih Raportin e Komisionit të Venedikut, tetor 2004. Rekomandimi i Komisionit nga Venedikut ishte marrë nga PSSP-ja dhe rezultoi në shpalljen e Rregullores së UNMIK-ut 2006/12 mbi themelimin e Kolegjit Këshillues për të Drejtat e Njeriut.

## KAPITULLI 5

### PRANIMI DHE REGJISTRIMI I KËRKESAVE

#### 1. Formulari i kërkesës

Procedurat që rregullonin pranimin dhe regjistrimin e kërkesave ishin përcaktuar në nenin 7 dhe 8 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60. Në pajtim me këto dispozita, HPD-ja krijoi procedurat e brendshme vepruese e cila u përqëndrua në mundësinë e qasjes së të gjithë paraqitësve potencial të kërkesave në process. Meqenëse procedurat para HPCC-së ishin jo kundërthënëse dhe kërkesat u vendosën në bazë të parashtrësive me shkrim, procesi i dha HPD-së rolin hetues i cili ishte përgjegjës për gjetjen e fakteve dhe mbledhjen e dëshmive.

Kërkesat janë paraqitur në formular standard të kërkesës të cilat janë dizajnuar nga HPD-ja në shqip, anglisht apo serbisht dhe mund të plotësoheshin në njërën prej këtyre gjuhëve.<sup>126</sup> Zyrtarët e HPD-së ndihmuan paraqitësit e kërkesave në plotësimin e formularëve.

#### 2. Procedura për paraqitjen e kërkesave

Rregullat e procedurës kërkonin që kërkesat të paraqiteshin personalisht, apo përmes personit të autorizuar, por në rastet kur pala “ *nuk ishte në gjendje të bënte kërkesë*” personalisht, kërkesa mund të paraqitjej prej njerit nga anëtarët e tij të ngushtë të familjes.<sup>127</sup>

Opcioni për të paraqitur kërkesë përmes personit të autorizuar ishte i hapur për të gjithë paraqitësit e kërkesës dhe kushti i vetëm ishte që personi i autorizuar të ketë autorizim të

---

<sup>126</sup>Shih nenin 8.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60. Janë pregaditur broshura informative, që ofronin informata mbi procedurën e kërkesave.

<sup>127</sup> Shih nenin 7.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000./60 e cila definoi termin ‘ *anëtarë i ngushtë i familjes*’ në pajtim me pikën 9 të ligjit mbi marrëdhëniet banesore e cila përfshinte një sërë anëtarë të familjes po të banonin me palën që kërkon të drejtën pronësore. Më pas HPCC-ja në interpretimin e termit duke marrë parasysh kategoritë e kërkesave me të cilat merrej, përcaktoi se meqenëse pika 9 ishte formuluar në kontekst të formulimit të të drejtave të banimit, dhe i shqyrtonte kërkesat të cilat merreshin me një mori të të drejtave pronësore, anëtarët e familjes të përmendur në pikën 9 mund të konsideroheshin si të tillë, pavarësisht nëse ata në të vërtetë banonin me bartësin e së drejtës pronësore , udhëzimi i HPCC-së, séanca e 24-të, 18 qershor 2004.

vlefshëm.<sup>128</sup> Ligji gjithashtu parashihte që në rastet e posaçme ku sigurimi i autorizimit ishte problematik, HPD-ja mund të vërtetonte ndonjë dokument tjetër që autorizonte përfaqësimin e paraqitësit të kërkesës.<sup>129</sup> Në rastet kur pala që kërkonte të parashtronte kërkesë në cilësi të përfaqësimit nuk kishte autorizim të vlefshëm apo nuk kualifikohej si anëtarë i ngushtë i familjes, HPCC-ja refuzonte kërkesën në bazë të asaj se palës i mungonte statusi që të veprojnë në emër të personit të cilin ai apo ajo kërkonte ta përfaqësojë.<sup>130</sup>

Në praktikë paraqitësit e kërkesës gjithashtu duhet të kishin letërnjoftimin e tyre në dispozicion për kontrollë kur të parashtronin kërkesën e tyre; një kopje e letërnjoftimit apo të dokumenteve të identifikimit i është bashkangjitur formularit të kërkesës për përfshirje në dosje. Gjithashtu kërkohej që paraqitësi i kërkesës të parashtrojë origjinalet apo kopjet e vërtetuara të çfarëdo dokumenti të rëndësishëm për kërkesën, që ishin nën posedimin e tij apo saj apo një fuqi të arsyeshme përfaqësimi.<sup>131</sup> Një kopje e këtyre dokumenteve dhe dokumentet e identifikimit të paraqitësit të kërkesës u bashkangjiteshin formularit të kërkesës dhe origjinalet u ktheheshin dhe mbeteshin tek paraqitësi i kërkesës meqenëse HPD-ja nuk i mbante dokumentet origjinale në dosje. Në njohjen e situatës historike në të cilën dëshmitë dokumentare që kishin të bënin me të drejtat pronësore në shumë raste ishin të shkatërruara apo të humbura, apo nuk mund të siguroheshin arsyeshëm, rregullat e procedurës u lejonin paraqitësve të kërkesës të parashtronin kërkesë në rastet kur ata nuk ishin në pozitë të parashtronin dëshmi plotësuese. Në raste të tilla nga paraqitësit e kërkesës kërkohej që të parashtronin të gjitha informatat e rëndësishme në lidhje me kërkesën e tyre, dhe HPD-ja ishte ngarkuar me oblogimin statutar që të bëjë hetimin dhe të vërtetojë këtë informatë, dhe të kryejë hetimet në të gjitha regjistrat publik për dokumentet përkatëse.<sup>132</sup>

Në mënyrë që të sigurohej qasja e lehtë në process neni 7 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 autorizoi HPD-në që të mbledhte dhe të regjistronte kërkesat në zyrë nëpër tërë Kosovën si dhe në vendet tjera ashtu siç përshtatej për mbledhjen.<sup>133</sup> Fillimisht zyrat ishin të hapura në Kosovë në katër regjionet e saj dhe njësitë e lëvizshme shërbenin në enklavat e minoriteteve dhe zonat rurale.<sup>134</sup> Megjithatë, meqenëse më pas ishte e dukshme se shumica e paraqitësve potencial të kërkesës ishin të shpërndarë jashtë Kosovës, në Serbi, Mal të Zi, dhe në përmasa më të vogla në ish republikën Jugosllave të Maqedonisë (FYROM), zyrat përfaqësuese ishin themeluar në këtë regjion në fund të viteve 2001 pas negociatave të gjata me autoritet në Serbi, përkatësisht në Beograd

---

<sup>128</sup> Neni 7.3 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>129</sup> *Ibid.*

<sup>130</sup> Opcioni i vetëm i cili është në dispozicion për palën në raste të tilla kur afati përfundimtar për paraqitjen e kërkesave ka skaduar ishte të kërkohej që HPD-ja ta vinte pronën nën administrimin e saj të përkohshëm në përputhje me jurisdiksionin e saj për administrimin e pronave të braktisura siç parashihet në nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>131</sup> Shih nenin 8.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>132</sup> Shih nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>133</sup> Shih nenin 7.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>134</sup> Tashmë e shqyrtuar në Kapitullin 3 të këtij raporti që kishte të bënte me strukturën institucionale të HPD-së.



(Serbi), Podgoricë (Mal të Zi). Një zyrë e vogël bashkëpunimi u hap gjithashtu në Shkup (FYROM).<sup>135</sup>

Meqenëse kërkesat duhej të nënshkruheshin në presence të një zyrtari të HPD-së, paraqitësit e kërkesave që jetonin në shtetet ku HPD-ja nuk ishte prezente nuk mund të parashtronin kërkesat. Në mënyrë që t'u ndihmohet atyre paraqitësve në parashtrimin e kërkesave është arritur një marrëveshje me Këshillin Norvegjez për Refugjatë me të cilën HPD-ja do të pranonte Autorizimet të lëshuara nga paraqitësit e kësaj oganizate, duke autorizuar parashtrimin e kërkesave. HPD-ja gjithashtu mblodhi kërkesat në Sarajevë përmes shfrytëzimit të shërbimeve të zyrës së UNHCR-it. Kjo ndihmoi pranimin e kërkesave në Bosnjë e Hercegovinë në mënyrë që t'i shërbej efikasitetit së mbledhjes së kërkesave dhe të siguroj trajtimin e barabartë të paraqitësve të kërkesës.

HPD-ja nuk filloi mbledhjen e kërkesave deri nga mesi i vitit 2000. Neni 3.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 përcaktoi afatin përfundimtar për parashtrimin e kërkesave më 1 dhjetor 2001 dhe lejoi shtyerjen e tij nga PSSP-ja. Meqenëse në kohën e themelimit të HPD-së në vitin 1999 burimet që i kishte në dispozicion ishin të kufizuara, që rezultoi me fillimin e pranimit të kërkesave dhe veprimeve jashtë Kosovës vetëm në fund të vitit 2001, afati përfundimtar u vazhdua me shtyerjen e fundit që skadonte më 1 korrik 2003.

### 3. Statistikat mbi numrin e kërkesave të regjistruara

Rreth 29.160 kërkesa janë parashtruar HPD-së.<sup>136</sup> Shumica e kërkesave (93.2%) janë parashtruar në pajtim me nenin 1.2 (c) të Rregullores (kërkesat e kategorisë C); 4.2% u parashtruan në pajtim me nenin 1.2 (a) (kërkesat e kategorisë A), derisa 2.6% u parashtruan në pajtim me nenin 1.2 (b) (kërkesat e kategorisë B). Numri më i madh i kërkesave të lidhura me pronat në regjionin e Pejës dhe Prishtinës, dhe tabela e mëposhtme përcakton natyrën, ndarjen gjeografike dhe kërkesat e pranuar.

Regjioni/ Kategoria	Gjilani	Mitrovica	Peja	Prishtina	Prizreni	Totali	% totali i kërkesave
A	112	203	97	698	102	1.212	4.2
B	45	65	57	579	20	767	2.6

<sup>135</sup> Këto zyre më pas luanin rolin qendror në dorëzimin e vendimeve të HPCC-së palëve dhe u ndihmoi atyre në parashtrimin e kërkesave rishqyrtuese dhe dokumenteve tjera të nevojshme për përpunimin e kërkesave të tyre. Më pastaj, u hapën zyret e terrenit në qytete të vogla dhe njësite terreni ishin pozicionuar për të shërbyer në zonat malore qendrat kolektive. Krijimi i rrjetit të zyreve në tërë RFJ mori me vetë kufizimet e lirisë së lëvizjes dhe çështjeve të sigurisë, që kanë penguar shumë paraqitës të kërkesave për të udhëtuar në Kosovë për të paraqitur kërkesat.

<sup>136</sup> Me kohë numri i përgjithshëm i kërkesave të pranuar u luhat pak. Kjo ndodhi për shkak të korigjimeve teknike gjatë përpunimit të kërkesave, të cilat kërkonin që kërkesat të ndaheshin apo të konsolidoheshin. Për shembull në rastet kur një paraqitës i kërkesës ka paraqitur disa kërkesa për pronën e njëjtë, këto kërkesa u përpunuan së bashku dhe u trajtuan si një kërkesë. Në rastet kur paraqitësi i kërkesës parashtrroi një kërkesë e cila përfshinte disa prona, kërkesa duhej të ndahej në disa kërkesa, dhe u krijua një dosje e re e kërkesave për secilën pronë.

C	3.617	3.542	7.975	8.293	3.7556	27.182	93.2
Totali	3.774	3.810	8.129	9.570	3.877	29.160	
% e kërkesave të përgjithshme	12.9	13	27.9	32.9	13.3	100	

Meqenëse diku rreth 20.000 kërkesa u mblodhën në Serbi, Mal të Zi dhe IRJM, mbledhja e kërkesave jashtë Kosovës u dëshmuar si jetike në ndihmën e qasjes në process për shumicën e paraqitësve të kërkesës.

Shumica e kërkesave, përkatësisht 93.2%, u ngritën nga ngjarjet që pasuan nga fushata ajrore e NATO-së në të cilën serbët e Kosovës dhe minoritetet tjera u detyruan të braktisnin shtëpitë e tyre (d.m.th. kërkesat e kategorisë C). Një numër i shqiptarëve të Kosovës të cilët kishin ikur nga Mitrovica e Veriut dhe enklavat tjera gjithashtu parashtruan kërkesat e kategorisë C.<sup>137</sup>

#### 4. Njoftimi i kërkesave dhe Publikimi

Dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 adresuan dhe rregulluan pjesëmarrjen e palëve në proces për të siguruar se procedurat e saj kanë plotësuar standardet e kërkuara të përpunimit. Kapitulli II i Rregullores përcaktoi shkallët procedurale që duhej të merreshin në mënyrë që të sigurohej që palët me interes ligjor në pronën e kërkuar ishin të njoftuar mbi kërkesën dhe u jepte mundësinë e pjesëmarrjes në procedurë. Kjo qasje ishte qëndrore në sigurimin e paanësisë në procedure dhe përpunim të lëndës bazuar nga fakti që kërkesat vendoseshin në bazë të parashtrësve me shkrim dhe palët nuk mund të jepnin dëshmi gojore apo argumete para HPCC-së.<sup>138</sup>

HPCC-ja përmes udhëzimeve të saj impresionoi personelin e HPD-së, rëndësinë e sigurimit të pajtueshmërisë me këto procedura të notifikimit dhe të siguroj se palët kuptuan natyrën e rastit të paraqitësit të kërkesës, dhe iu lejua mundësia që t'i përgjigjet kërkesës ashtu që procesi të siguronte pjesëmarrje kuptimplotë për të gjitha palët në kërkesë në procesin e vendimmarrjes.

Me pranimin e formularit të kërkesës është regjistruar në bazën e të dhënave të kërkesave dhe është transferuar në zyrën përkatëse regionale aty ku ndodhej prona për të ndihmuar notifikimin e kërkesave. Nga HPD-ja kërkohej e tërë përpjekja e arsyeshme për të njoftuar banuesin e pronës së kërkuar dhe çdo pale tjetër me interes ligjor në pronë për parashtrimin e kërkesës, dhe të drejtës së tyre të pjesëmarrjes në procedurë.<sup>139</sup> Palët janë njoftuar përmes shërbimit në formular të njohur si 'Njoftim mbi formularin e kërkesës' i

<sup>137</sup> Rreth 700 kërkesa u parashtruan mbi pronat që ndodheshin në pjesën veriore të qytetit të ndarë të Mitrovicës.

<sup>138</sup> Shih nenin 12.1 dhe 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>139</sup> Shih nenin 9.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

cili përcakton detajet e kërkesës dhe natyrën e të drejtës pronësore të kërkuar mbi pronën. Njoftimi i formularit shoqërohej me njoftim të formularit për pjesëmarrje i cili njoftoi palën mbi të drejtën e tij apo saj për pjesëmarrje në procedurë<sup>140</sup> ose me plotësimin e njoftimit dhe kthimit të tij HPD-së brenda tridhjetë (30) ditësh<sup>141</sup> (duke përkthyer detajet e tyre të kontaktimit<sup>142</sup> dhe natyrën e të drejtës ligjore që u pohua mbi pronën) apo në mënyrë alternative duke shkuar personalisht në zyrën e HPD-së për të ofruar një informatë të tillë.

Për të ndihmuar pjesëmarrjen e palëve në procedure, HPD-ja mund t'u ofroj palëve përmbledhjen e kërkesës së palës tjetër në gjuhën e tij apo saj të zgjedhur.<sup>143</sup>

Në rastet kur personi me interes ligjor në kërkesë nuk mori njoftimin mbi kërkesën, rregullat e procedurës parashihnin që ai apo ajo mund të lejoheshin si palë në çfarëdo faze të procedurës, me kusht që kërkesa të mos ishte shqyrtuar përfundimisht.<sup>144</sup> Në rastet kur kërkesa është shqyrtuar përfundimisht, mundësia e vetme e hapur për pjesëmarrjen e palës në procedure ishte parashtrimi i kërkesës për rishqyrtim të vendimit, por jo më vonë se një (1) vit nga data e vendimit.<sup>145</sup>

Njoftimi mbi kërkesën duhej t'i dorëzohej banorit personalisht, por kur dorëzimi personal nuk ishte i mundshëm, njoftimi mund t'i dorëzohej çdo personi tjetër të rritur që banon në pronë. Në rastet kur personi që pranoi dorëzimin e njoftimit nuk ishte banori, ai apo ajo duhej të nënshkruanin listen e dorëzimit që të vërtetonte pranimin e njoftimit.<sup>146</sup> Në rastet kur banori mendohej që t'i shmanget dorëzimit, shërbyesi i procesit pas dy përpjekjeve për t'i dorëzuar asaj pale, është lejuar që t'i ngjesh njoftimet në derë të lokaleve.<sup>147</sup>

Në shumë raste njoftimi mbi qëllimin e palës që të marrë pjesë në procedurë u parashtrua jashtë afatit kohor prej tridhjetë (30) ditësh, por këto kërkesa administroheshin në mënyrë fleksibile. Në shumë raste HPD-ja pranoi parashtrimin e vonshëm të njoftimit. Ky fleksibilitet procedural është paraparë në rregullore përmes të cilit HPD-ja është autorizuar që të shtyjë afatin përfundimtar për dorëzimin e njoftimeve në rastet kur kjo ishte në interes të zgjidhjes efektive dhe të drejtë të kërkesave, dhe nuk paragjykonte materialisht të drejtat e asnjërës pale.<sup>148</sup>

---

<sup>140</sup> Zyrtarët me bazë në zyrat regjionale të HPD-së, të njohur si 'shërbyes të procesit' të cilët vepruan nën mbikqyrjen e shefit të zyrës regjionale ishin përgjegjës për njoftimin e kërkesës.

<sup>141</sup> Shih nenin 9.5 të Rregullores UNMIK-ut

<sup>142</sup> Shih nenin 9.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60

<sup>143</sup> Shih nenin 9.7 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>144</sup> Neni 9.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>145</sup> Shih nenin 14.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>146</sup> Shërbyesi i procesit duhej të shenonte emrin dhe numrin e letërnjoftimit të personit të cilit u janë dorëzuar njoftimet së bashku me lidhshmërinë e tij me banorin.

<sup>147</sup> Në të gjitha rastet ku njoftimi mbi kërkesën ishte dorëzuar shërbyesi i procesit duhej të plotësonte një formë e cila i vërtetonte këto fakte.

<sup>148</sup> Shih nenin 9.10 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60. Në rastet kur banuesi i pronës së kërkuar apo ndonjë pale tjetër nuk parashtrroi njoftimin e formularit të pjesëmarrjes apo përndryshe mori pjesë në procedurë ky fakt u regjistrua në formularin e kërkesës.

Procesi i njoftimit përfshinte publikimet zyrtare të listës së të gjitha kërkesave të parashtruara në HPD në buletin e njohur si revista e HPD-së. Gazeta regjistronte adresën e pronës mbi të cilën ishte parashtruar kërkesa së bashku me numrin e kërkesës. Ajo iu shpërnda gjykatave, komunave, zyrave konsullore, enklavave, organizatave për persona të zhvendosur përkohësisht dhe OJQ-tve<sup>149</sup> dhe gjithashtu u publikua në web faqen e HPD-së.

## KAPITULLI 6

### HETIMI I KËRKESAVE DHE PËRPUNIMI

#### 1. Rishikimi fillestar

Kërkesat fillimisht janë rishikuar në mënyrë që të sigurohet se binin nën jurisdiksionin e HPCC-së në pajtim me nenin 1.2 (a)-(c) të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 dhe i përmbajtën kritereve formale të parashtrimit siç ishte e përcaktuar në kapitullin II të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

Në rastet kur ishte përcaktuar se kërkesa nuk binte dukshëm nën jurisdiksionin e HPCC-së, HPD-ja lejohej që të lëshonte vendim me shkrim e cila nënshkruhej nga Drejtori ekzekutiv duke refuzuar kërkesën, dhe duke pregaditur arsyet për refuzim.<sup>150</sup>

Kërkesat refuzoheshin kryesisht në bazë të këtyre arsyejeve në vijim:

- (i) prona e kërkuar ndodhej jashtë teritorit të Kosovës;
- (ii) Prona e kërkuar nuk ishte banesore dhe nuk binte nën definimin e pronës siç parashihej në nenin 1 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 (*ratione materiae*);
- (iii) e drejta e pohuar e pronës është humbur jashtë periudhës kohore të përcaktuar me Rregullore (*ratione temporis*); dhe
- (iiii) kërkesa nuk është parashtruar nga personi fizik (*ratione personae*).

Rreth 120 kërkesa janë refuzuar nga HPD-ja meqenëse qartë bien jashtë jurisdiksionit të HPCC-së.

Në rastet kur HPD-ja refuzoi kërkesën paraqitësi i kërkesës mund të kundërshtonte refuzimin. Në raste të tilla rregullat e procedurës së HPD/HPCC-së kërkonin që HPD-ja të përpunonte kërkesën në mënyrë të zakonshme, dhe t'ia përcillte HPCC-së për vendim.<sup>151</sup>

---

<sup>149</sup> Njoftimet e kërkesave janë publikuar në lokacionet vijuese dhe/apo në publikimet e tyre përkatëse, komunat dhe gjykata në Kosovë, Këshilli Norvegjez për Refugjatë, Këshilli Danez i Refugjatëve, UNHCR dhe Telegrafi i KFOR-it.

<sup>150</sup> Shih nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>151</sup> Shih nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

## 2. Rishikimi i pavarur

Përpunimi i kërkesave nga HPD-ja përfshinte kërkesa të hetuara në tërësi dhe hartimin e parashtrësve ligjore dhe rekomandimeve për referimin e kërkesës tek HPCC-ja për vendim. Dëshmia që përkrahte kërkesën duhej të rishikohej, të verifikohet dhe të bëhej rekomandimi nëse kriteret për një kërkesë të vlefshme ishte plotësuar.

Hetimi i kërkesave dhe përpunimi ishte inkuizitive në natyrë meqenëse dëshmia gojore zakonisht nuk mund të jepet para HPCC-së dhe procesi i vendimmarrjes ishte kundërtë. Siç ishte theksuar më parë, kjo filloi me mbledhjen e kujdesshme të kërkesave dhe intervistën gjithëpërfshirëse me paraqitësit e kërkesës gjatë kohës në të cilën ata kishin parashtruar kërkesat e tyre që ndihmoi në përpunimin e kërkesave të tyre. Megjithatë, zyrtarët ligjor nuk ishin të kufizuar në informatat apo dokumentacionet që ishin parashtruar nga paraqitësit e kërkesës kur ishte parashtruar kërkesa. Ata mund të kontaktonin palët në kërkesë nëse kishte nevojë për informata plotësuese dhe të bënin çfarëdo hetimi tjetër, *ex officio* ku është e nevojshme, në mënyrë të caktimit të të gjitha fakteve të rëndësishme për kërkesën.

## 3. Qasja në të dhënat e pronës dhe Verifikimi i Dokumenteve

Meqenëse çështjet pronësore kishin qenë kryesore gjatë periudhës së konfliktit, kishte një numër pengesash në qasjen e të dhënave dëshmuuese pronësore. Së pari të dhënat ekzistuese të pronës ishin jo të plota dhe jo të besueshme.<sup>152</sup> Përveç kësaj, të dhënat e pronës ishin shkatërruar, dhe një numër i madh i të dhënave para vitit 1999 ishin larguar dhe ishin zhvendosur në Serbi.<sup>153</sup>

Për aq sa i përket qasjes së dokumenteve brenda territorit të Kosovës, dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 dhe 2000/60 parshihnin që HPD dhe HPCC të kishin qasje të hapur në të gjitha të dhënat. Neni 10.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 përcaktonte që “*Drejtorati mund të hetoj një kërkesë dhe të siguroj dëshmitë e rëndësishme për kërkesën nga çdo e dhënë që mbahej nga organi publik, personi i korporatës apo personi fizik.*” dhe kjo ishte lejuar si “*qasje e lire pa ndonjë pagesë ndaj ndonjë të dhëne... të rëndësishme për zgjidhjen e kërkesës apo për çfarëdo qëllimi tjetër verifikues.*” Sa i përket HPCC-së, neni 2.4 i Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 përcaktonte që HPCC-ja të kishte të drejtë në “*qasje të lire në çdo dhe në të gjitha të dhënat në Kosovë, të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit që iu është parashtruar.*”

Qasja në të dhënat pronësore në Serbi ishte gjithashtu thelbësore për verifikimin e kërkesave meqenëse një numër i konsiderueshëm i të dhënave në Kosovë ishin zhvendosur atje. Më 2 dhjetor 2002 u arrit një marrëveshje me Ministrinë e Drejtësisë me të cilën HPD-së iu lejua qasja në të dhënat pronësore që ndodheshin në Ministrinë e

<sup>152</sup> E shqyrtuar në detale në kapitullin 1 të këtij raporti.

<sup>153</sup> *Ibid.*

saj, arkivat e zhvendosura të gjykatave, Komesariatit republikan për refugjatë, Drejtoratet Federale dhe Republikane për Asete dhe në zyret kadastrale.

Një hulumtim i thellë i të gjitha burimeve efikase të dëshmive dokumentuese të të drejtave pronësore ishte thelbësore në përcaktimin e të drejtës së pronës. Prandaj njëra ndër shkallët themelore të përfshira në përpunimin e kërkesave përfshinte zyrtarët e HPD-së që përpiqeshin të verifikonin dokumentet e parashtruara në mbështetje të kërkesave, apo të bënin hulumtime *ex officio* në të dhënat publike pronësore në rastet kur ofroheshin dëshmitë e pamjaftueshme dokumentare në mbështetje të kërkesës, apo në rastet kur dokumentet nuk dukeshin të vërteta. Neni 10.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 autorizoi HPD-në që të bënte hulumtime *ex officio* dhe të “ mirrte çfarëdo dëshmie të rëndësishme për kërkesën nga ndonjë e dhënë që mbahej nga organi publik, personi i korporatës apo personi fizik.”<sup>154</sup>

Me udhëzimet nga HPCC-ja, HPD-ja mori një rol aktiv në mbledhjen e dëshmive verifikuese që arrihej me shpërndarjen e zyrtarëve verifikues në gjykata, zyra kadastrale dhe kompani banesore për të mbledhur dhe verifikuar dokumentet zyrtare dhe për të kontrolluar informacionet dhe dokumentacionin e ofruar nga paraqitësit e kërkesës.

HPCC-ja ofroi HPD-së ndihmë mbi procedurën që duhej përcjellur në verifikimin e dokumenteve përmes lëshimit të udhëzimeve ligjore. Një dokument mund të verifikohet si *prima facie* e vlefshme (e vlefshme në shikim), apo duke krahasuar me të dhënat publike. Verifikimi *prima facie* konsiderohej i përshtatshëm në kërkesat e kategorisë C ku kërkesa ishte e pakontestueshme. Në të gjitha rastet tjera verifikimi duhej të bëhej duke krahasuar dokumentin me kopjet origjinale në të dhënat pronësore publike, dhe në rastet të tilla vendimet asnjëherë nuk bëheshin në bazë të dokumentacionit apo informacionit të parashtruar vetëm nga paraqitësi i kërkesës.

Një dokument klasifikohet si i verifikuar kur gjindej në të dhënat pronësore publike me origjinalin përkatës, kopjen apo referencën e besueshme. Në rastet kur dokumenti nuk gjindej në të dhënat publike, por *prima facie* dukej i vlefshëm, zyrtari i verifikimit ishte i obliguar që të kërkonte mendimin e zyrtarëve që punonin në këto institucione mbi vlefshmërinë e dokumentit (nëse numrat në dokument përputheshin me sistemin numëruar të përdorur në lëshimin e dokumenteve të tilla, nëse ishte i nënshkruar nga personi i autorizuar i cili punonte apo kishte punuar në atë institucion apo kur krahasohej me dokumentet që buronin nga institucioni që dukej të ishte i vërtetë.)<sup>155</sup> Në raportin e

---

<sup>154</sup> Shih nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>155</sup> Në rastet e verifikimit në komunën e Prishtinës, ku dokumenti original nuk mund të gjindej, kryetari i gjykatës dërgoi letër HPD-së duke konfirmuar se zyrtari gjyqësor punonte aty dhe ishte përgjegjës për verifikimin e dokumenteve prej 1989-1999. HPCC-ja mbështetej në këtë dhe lejoi aplikimin e procedurës së ngjashme në verifikimin e dokumenteve ku institucioni në fjalë siguroi konfirmimin me shkrim se personi nënshkrimi i të cilit paraqitej në dokument ishte i punësuar aty dhe ishte përgjegjës për verifikimin e dokumenteve në kohën përkatëse. Në rastet kur një zyrtar njihte nënshkrimin e kolegut në dokument, emir I zyrtarit dhe kolegut duhet të përshkruheshin në raportin e verifikimit së bashku me arsyetimet se si ai apo ajo njohu nënshkrimin e kolegut.

verifikimit duhej të përshkruheshin edhe këndvështrimi i zyrtarëve edhe të zyrtarëve të verifikimit.<sup>156</sup>

Në Kosovë hetimet kryesore bëheshin në zyrat e Bartësve të së Drejtës së Ndarjes, Ndërmarrjet Publike Banesore (NPB), ndërmarrjet komunale Banesore, gjykata dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës. Burimet dytësore të dëshmive siç janë kompanitë e komunalieve (ryma, uji dhe të dhënat e telefonit) ishin gjithashtu burim i dobishëm i posedimit të pronës. Në kërkesat e kategorisë C ku dokumenti ishte marrë para vitit 1989 dhe nuk kishte dëshmi tjetër mbi posedimin e vazhdueshëm para marsit 1999, HPCC-ja kërkoi që HPD-ja të shfrytëzonte burimet dytësore të dëshmive në mënyrë që të vërtetonte nëse pala ishte në posedim të pronës më 24 mars të vitit 1999.

Pas përfundimit të procesit të verifikimit, zyrtarët e verifikimit duhej të plotësonin një raport të Verifikimit dhe udhëzimet e HPCC-së përcaktuan llojin e informacionit që duhej përfshirë në raportin e verifikimit. Raporti i vënte në listë dokumentet që duheshin verifikuar, të dhënat e pronës të hetoheshin dhe nëse origjinali përkatës apo kopja e dokumentit mund të gjindeshin.<sup>157</sup> Në rastet kur dokumenti ishte verifikuar duke bërë krahasimin me të dhënat publike, një kopje e dokumentit si të asaj në të dhënat publike duhej të mirrej dhe të bashkangjitej në dosjen e kërkesës. Në raportin e verifikimit zyrtarët për verifikim duhej gjithashtu të përmendnin, çfarë informacioni, nëse kishte ndonjë, a ishte në dipozicion në të dhënat publike dhe kompanitë e komunalieve në lidhje me të drejtat pronësore të pronës së kërkuar.

#### **4. Hartimi i parashtrësave ligjore mbi kërkesat për HPCC-në**

Pas shqyrtimit të kërkesës konstatimet dhe rekomandimet e zyrtarit ligjor që shqyrtonte kërkesën elaboroheshin në raportin që hartohej për prezentimin e kërkesës para HPCC-së. Kjo ishte në pajtim me kërkesat e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 e cila përcaktoi një rol për HPD-në në përgaditjen e “*përmbledhjeve të parashtrësave dhe dëshmisë, përthimeve të dëshmive, dhe rekomandimeve*” për HPCC-në.

Parashtrësat ligjore përgaditeshin në formatin standard në dokumentin e njohur si “raporti përpunues i kërkesës”. Mostrat e raportit përpunues të kërkesave përgaditeshin në konsultim me HPCC-në në lidhje me çdo kategori të kërkesës dhe u standardizuan gjatë viteve të veprimit nën udhëzimet e HPCC-së. Këto raporte duhej të përmbanin gjithë informacionin bazë që i duhej HPCC-së për shqyrtimin e kërkesës së bashku me rekomandimin e kërkesës. HPCC-ja gjithashtu lëshoi udhëzimet ligjore mbi faktet kryesore që duheshin përshkruar në raportin në mënyrë që të sigurohej se përmbanin të gjitha veçoritë e nevojshme për shqyrtimin e kërkesës.<sup>158</sup> Raporti duhej të përmbante një pasqyrë të përgjithshme të fakteve dhe një bazë ligjore për kërkesë, të drejtën pronësore

<sup>156</sup> Udhëzimet e HPCC-së, seanca e 27-të, dhjetor 2004.

<sup>157</sup> Y-1 tregonte se dokumneti ishte verifikuar pozitivisht nga HPD-ja *prima facie*; Y-2 tregonte se dokumenti ishte verifikuar duke bërë krahasimin me të dhënat të një zyrtari/institucion jashtë HPD-së; Y-3 tregonte që dokumenti ishte verifikuar duke bërë krahasimin me të dhënat të një zyrtari/institucion jashtë HPD-së; N shenonte verifikimin negative, derisa U-ja shenonte se verifikimi ishte i panevojshëm apo nuk ishte bërë.

<sup>158</sup> Udhëzimet e HPCC-së, seanca e 23-të, 16 prill 2004.

të kërkuar dhe çdo dëshmi dokumentuese që mbështeste kërkesën (d.m.th. vendimi mbi ndarjen, kontratën mbi shfrytëzim, kontrata mbi shitblerjen, vendimin mbi trashëgiminë etj.) Kjo përfshinte detajet mbi çështjet kryesore ligjore dhe faktike të ngritura nga paraqitësi i kërkesës. Gjithashtu ëshët kërkuar të paraqesë detajleve rreth njoftimit të palëve të ndikuar nga kërkesa, natyra e verifikimit të bërë, nëse më shumë se një kërkesë ishin parashtruar për pronën e kërkuar dhe kështu me radhë. Në rastet kur kontestohet kërkesa raporti duhej të përshkruante faktet mbi të cilat pala përgjegjëse kontestoi kërkesën dhe ndonjë dëshmi mbështetëse të parashtruar nga ai apo ajo. Në rastet kur kërkesa refuzohej nga HPD-ja nga mungesa e jurisdiksionit<sup>159</sup> dhe refuzimi kundërshtohej nga paraqitësi i kërkesës, ky fakt duhej të përshkruhej në raport.<sup>160</sup> Raportet përpunuese në rastet e pronave të shkatërruara duhej të tregonin se kërkesa ishte bërë për pronën e shkatërruar dhe të përmbanin një përshkrim të shkurtër të gjendjes së vërtetë të pronës, dhe nëse ishte e uzurpuar apo shfrytëzohej për ndonjë qëllim.<sup>161</sup>

Raporti konkludoi me analiza ligjore mbi bazat për kërkesë së bashku me rekomandimin për HPCC-në, nëse kërkesa duhej aprovuar apo refuzuar.<sup>162</sup>

Faqja e fundit e çdo raporti përpunues të kërkesës përmbante një tabelë që i vendoste në listë dokumentet e parashtruara si dëshmi nga palët në kërkesë dhe tregonin nëse dokumentet ishin verifikuar pozitivisht. Dokumentet e konstatuara ga HPD-ja gjithashtu ishin të vëna në listë në këtë pjesë të raportit.<sup>163</sup> Në rastet kur dokumenti nuk mund të verifikohet, raporti përpunues duhej të përshkruante arsyet pse nuk mund të verifikohet ky dokument.<sup>164</sup>

Është e rëndësishme të vihet re se HPCC-ja në asnjë mënyrë nuk detyrohej me rekomandimet e raportit përpunues të kërkesës. Komisioni përmes njerit apo më shumë anëtarëve të vet, kreu rishikimin e pavarur të dëshmive dokumentuese. Ai mori vendimin e tij përfundimtar mbi secilën kërkesë, pas shqyrtimit të rekomandimeve në raport, në bazë të vlerësimit të vet të pavarur të çështjeve.

---

<sup>159</sup> Shih nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>160</sup> Udhëzimet e HPCC-së, séance e 23-të, 16 prill 2004.

<sup>161</sup> Udhëzimet e HPCC-së, séance e 24-të, 18 qershor 2004.

<sup>162</sup> Raporti përpunues i kërkesës përmbante informacionin në vijim:

1. Përmbledhjen e fakteve
2. Ndihmën e kërkuar nga paraqitësi i kërkesës;
3. Përpunimin e lëndës (d.m.th. datën kur është parashtruar dhe publikuar kërkesa dhe nëse ka pasur ndonjë kërkesë të lidhur).
4. Analizat ligjore;
5. Përfundimet;
6. Rekomandimet e HPD-së për HPCC-në;
7. Tabela e dokumenteve të parashtruara nga paraqitësi i kërkesës, pala përgjegjëse dhe çdo pale tjetër e interesuar.

<sup>163</sup>Të vihet re gjithashtu se neni 10.4 lejoi HPD-në që të ketë dëshmi në dosjen e përkthyer. Verzioni në anglisht, shqip dhe serbisht i raporteve përpunuese të kërkesës vendosej në të gjitha dosjet e kërkesave derisa t'i dërgohej HPCC-së për shqyrtim. Gjithashtu bëhej një hulumtim në bazën e të dhënave të HPD-së në mënyrë që të vërtetohej nëse ishte parashtruar ndonjë kërkesë tjetër në HPD mbi pronën e njejtë dhe rezultati i këtij hulumtimi shenohej në raportin përpunues të kërkesës. Zyrtari ligjor që përgaditi raportin përpunues të kërkesës në lëndë duhej të nënshkruante dhe të japë datën në raport pas përfundimit.

<sup>164</sup> Udhëzimet e HPCC-së, seanca e 30-të, qershor 2005.



Në rrethana të jashtëzakonshme HPD-ja mund të kërkonte mendimin e HPCC-së mbi interpretimin e dispozitave të Rregulloreve apo ndonjë çështjeje të posaçme ligjore apo dëshmuese të rëndësishme për përpunimin e kërkesës, apo për përgaditjen e parashtrësve ligjore. HPCC në Rregullat e saj plotësuese përcaktoi procedurën që duhej përcjellur për të kërkuar një mendim. Procedura kërkonte që HPD-ja të referoj kërkesën që posaçërisht ngriste çështjet ligjore dhe dëshmuese në fjalë HPCC-së, me rekomandim të mbështetur me arsyetimin ligjor mbi mënyrën me të cilën është propozuar se si duhej të zgjidhej çështja.<sup>165</sup>

Në mënyrë që të përmirësohet përmbushja e procedurave për përpunimin e kërkesave HPCC-ja kërkoj që të organizohet një takim pas çdo seance me juristat dhe zyrtarët e verifikimit të përfshirë në përpunimin e kërkesës, në mënyrë që të siguroj që tërë personelin të jetë i informuar mbi udhëzimet e përpunimit të kërkesave. Kjo qasje siguronte qëndrueshmëri në praktikë në shqyrtimet e kërkesave dhe përgaditjen e raporteve përpunuese.<sup>166</sup>

Në rastet kur parashtrheshin dy apo më shumë kërkesa mbi një prone të kërkuar, kërkesat shqyrtoheshin veçmas dhe prezentoheshin në një raport përpunimi të kërkesës. Në rastet kur paraqitësi i kërkesës parashtronte disa kërkesa mbi të njejtën pronë, kërkesat bashkoheshin në një dosje të vetme të kërkesës<sup>167</sup> dhe në lidhje me disa kërkesa përgaditej një raport përpunimi i kërkesës. Në rastet kur paraqitësi i kërkesës parashtronte një kërkesë që përfshinte disa prona, hapej një dosje e veçantë për secilën prone dhe kërkesat shqyrtoheshin ndaras. Për çdo kërkesë krijohej raporti përpunues i kërkesës.

Pas përfundimit të raportit përpunues të kërkesës, dosja e kërkesës i dorëzohej njësitit të zyrës së kryesekretarisë i cili ishte përgjegjës për përgaditjen përfundimtare të kërkesave për shqyrtim nga HPCC-ja. Përrjashtimi i vetëm bëhej vetëm në lidhje me kërkesat e pakontestuarra të kategorisë B në të cilat HPD-ja mund të lëshonte vendime për të regjistruar transaksionet jozyrtare me kusht që kërkesa të jetë në pajtueshmëri me kërkesat e shprehura si në vijim të nenit 11.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

- (i) paraqitësi i kërkesës pohoi se ai apo ajo ka hyrë vullnetarisht në transaksion jozyrtar të pronës banesore e cila bazohej në vullnetin e lire të palëve në transaksion, ndërmjet 23 marsit 1989 dhe 13 tetorit 1999 dhe kërkesa ishte e pakontestueshme; dhe
- (ii) HPD-ja ishte i kënaqur se kishte dëshmi të mjaftueshme të vërtetoj se paraqitësi i kërkesës kishte fituar të drejtën pronësore përmes transaksionit të pohuar jozyrtar; dhe

---

<sup>165</sup> Udhëzimet e HPCC-së, seanca e 20-të, 17 tetor 2003. Shih nenin 3 të HPCC-së. Rregullat plotësuese të bashkangjitura në Aneksin III.

<sup>166</sup> Udhëzimet e HPCC-së, seanca e 21-të, 12 dhjetor 2003.

<sup>167</sup> Paraqitësi i kërkesës i cili parashtronte më shumë se një kërkesë mbi të njejtën prone dhe kërkoj ndihmën e njejtë informohej se HPD-ja do të përpunoj vetëm një kërkesë dhe ai apo ajo duhej t'i tërhiqte kërkesën/at tjetër/ra.

(iii) nuk kishte ndonjë kërkesë tjetër të parashtruar mbi pronën e kërkuar.<sup>168</sup>

Në rastet që ishin në përputhje me dispozitat e nenit 11, HPD-ja lëshoi vendim, të njohur si ‘Vendimi-B’ që ishte i nënshkruar nga drejtori ekzekutiv i HPD-së, duke urdhëruar që e drejta pronësore e paraqitësit të kërkesës të regjistrohej në regjistrin përkatës publik. Për të ndihmuar regjistrimin, urdhri original i dërgohej paraqitësit të kërkesës dhe kopja e vërtetuar i dorëzohej Agjencionit Kadastral të Kosovës.

Vendimet-B nuk përfaqësonin vendime të detyrueshme mbi të drejtat pronësore, dhe nuk kishin ndikim në të drejtën e ndonjë personi për të bërë kërkesë të mëtejshme HPD-së sipas nenit 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23. Kërkesa të tilla të mëtutjeshme duhej të bëheshin brenda tridhjetë (30) ditësh nga njoftimi mbi urdhërin e HPD-së, por jo më vonë se një (1) vit nga data e urdhërit në fjalë.<sup>169</sup>

Vendimet e HPCC-së në lidhje me kërkesat e kategorisë B duhej të publikoheshin në mënyrë të ngjashme si vendimet tjera të HPCC-së.<sup>170</sup>

## **5. Tërheqja e kërkesave**

Paraqitësi i kërkesës kishte mundësinë të tërhiqte kërkesën në çdo fazë të procedurës para shqyrtimit. Duke ditur që tërheqja e kërkesës përfundonte në të duke mos qenë e paraqitur HPCC-së për vendim, paraqitësi i kërkesës duhej të bënte kërkesë të tillë me shkrim në pajtim me formularin e ofruar nga HPD-ja për tërheqjen e kërkesave.

## **6. Dorëzimi i kërkesave HPCC-së dhe roli i Kryesekretarisë**

Në kryerjen e funksioneve të saj gjyqësore HPCC-ja u ndihmua nga Kryesekretaria e cila i siguronte mbështetje administrative, teknike dhe ligjore.<sup>171</sup> Kryesekretaria përbëhej prej disa Sekretarëve dhe personelit shtesë. Kryesekretari ishte përgjegjës për asistimin e HPCC-së në periudhën që çonte në vendimmarrje, përfshirë edhe kategorizimin dhe përcjelljen e kërkesave HPCC-së për shqyrtim dhe hartimin e vendimeve. Një funksion i rëndësishëm i Kryesekretarit ishte sigurimi i koordinimit dhe përputhshmërisë së analizave ligjore dhe rekomandimeve të ofruara në raportet përpunuese të kërkesave për HPCC-në. Kjo sigurohej përmes kryesekretarit i cili bënte rishikimin përfundimtar në mënyrë që të sigurohej që kërkesa ishte shqyrtuar në tërësi dhe të ishte përgaditur

<sup>168</sup> Në rastet kur edhe kërkesa e kategorisë B edhe ajo e kategorisë C ishin parashtruar mbi pronën e njejtë, kërkesat duhej t’i referoheshin HPCC-së për shqyrtim si përjashtim i jurisdiksionit të HPD-së sipas nenit 11. Shih gjithashtu Rregullat plotësuese të HPCC-së në Rregullën 2.2, të bashkangjitur në Aneksin III.

<sup>169</sup> Shih nenin 11.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>170</sup> Publikimi i vendimeve të HPCC-së u shqyrtuar në kapitullin 8 të këtij raporti.

<sup>171</sup> Shih nenin 17.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 dhe u shqyrtua në kapitullin 3 të këtij raporti.

në pajtim me udhëzimet ligjore të HPCC-së, ashtu që informacioni dhe dëshmitë e nevojshme për të vlerësuar kërkesën ishin qartë dhe në mënyrë gjithëpërmbledhëse të përcaktuara aty. Një qasje e tillë gjithashtu siguroi përputhshmëri në praktikën e përpunimit të kërkesave dhe pajtueshmëri me ligjin në fuqi. Të gjitha dosjet e kërkesave ishin qartësuar para se të grumbulloheshin në pako dhe t'i referoheshin HPCC-së për shqyrtim. Në rastet kur kërkesa nuk ishte shqyrtuar në tërësi apo përpunimi ishte jo i plotë, ajo i kthehej HPD-së për shqyrtim të metejshëm apo plotësimi. Në këtë mënyrë Kryesekretaria kryente kontrollin e kualitetit të të gjitha kërkesave para se t'i referoheshin HPCC-së.

Kryesekretari në konsultim me kryetarin e HPCC-së përcaktonte rendin sipas të cilit kërkesat iu ishin dorëzuar HPCC-së për shqyrtim<sup>172</sup> dhe kërkesat që ngrisin çështje të përbashkëta ligjore dhe dëshmuese grumbulloheshin së bashku në pako në kategori për përpunim.<sup>173</sup> HPCC-ja udhëzoi zyrën e Kryesekretarisë që t'i grupoj kërkesat në kategoritë vijuese – në ato të refuzuara, në ato me procedure të rregullt dhe të shpejtuara, prona të shkatërruara, kërkesat e kategorisë A, kërkesat e kategorisë B, kërkesat e kontestueshme të kategorisë C, dhe kërkesat për rishqyrtim<sup>174</sup>.

Kërkesat duhej t'i dërgoheshin HPCC-së një kohë para seancës, e cila në praktikë zakonisht ishte tre (3) javë para seancës në mënyrë që Komisionerëve t'u jepej mundësia e rishikimit të kërkesave. HPCC-ja shqyrtonte çështjet ligjore, analizat dhe rekomandimet dhe vendimet merreshin mbi atë nëse duheshin dëshmi tjera apo parashtresa me shkrim dhe qëllimet e parashtresave të tilla të mëtejme. Kjo i dha HPCC-së mundësinë që të kërkoj që HPD-ja të bënte hetime të metejshme kur kjo ishte e nevojshme për përcaktimin e kërkesës.<sup>175</sup>

---

<sup>172</sup> Shih nenin tjetër 17.7 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 që lejoi HPCC-në të shqyrtoj kërkesat që ngrisin çështje të zakonshme ligjore dhe evidentuese së bashku.

<sup>173</sup> Shih nenin 19.5(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 e cila i lejoi HPCC-së që të shqyrtoj kërkesat që ngrisin çështjet e zakonshme ligjore dhe evidentuese së bashku.

<sup>174</sup> Udhëzimet e HPCC-së, séance e 25-të, 27 gusht 2004.-

<sup>175</sup> Shih nenin 21.2 të Rregullores së UNMIK-ut

## KAPITULLI 7

### VENDIMET E HPCC-së

#### Hyrje

Qëllimi i përgjithshëm në krijimin e një mekanizmi për zgjidhjen e kërkesave ishte që të vihej në vend një process që do të ofronte ndihmë efikase për paraqitësit e kërkesës brenda një periudhe të arsyeshme kohore, derisa në të njëjtën kohë të siguronte procedure të drejtë dhe përpunim të lëndës në pajtim me standardet e të drejtave të njeriut.

#### *Përpunimi i një numri të madh të kërkesave*

Një numër i dispozitave procedurale të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 lejoi shfrytëzimin e teknikave për numër të madh kërkesash në mënyrë që të përshpejtohet procesi i vendimmarrjes si vijon:

- Neni 19.1 dhe 19.2 lejoi vendimmarrjen në bazë të parashtresave me shkrim dhe asnjera nga palët nuk mund të jepnin dëshmi gojore nëse ato nuk ishin ftuar për këtë;<sup>176</sup>
- Neni 19.5 (a) lejoi kërkesat që ngritnin çështjet e zakonshme ligjore që të shqyrtoheshin së bashku;
- Neni 19.5 (b) lejoi delegimin e rishikimit të kërkesave të caktuara dhe funksionet e rishikimit evidentues kryesekretarit, dhe anëtarët e personelit të HPD-së u emëruan në shërbim të HPCC-së, nën mbikqytjen e HPCC-së;
- Neni 19.5 (c) autorizoi përdorimin e bazës së të dhënave kompjuterike, programeve dhe mjeteve tjera elektronike ashtu siç dukej e nevojshme për përshpejtimin e vendimmarrjes;

---

<sup>176</sup> Shih nenin 19.1 dhe 19.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60

- Neni 19.5 (d) lejoi HPCC-në të merr masa tjera të cilat i konsideroi të përshtatshme në përsheptimin e vendimmarrjes;
- Neni 22.9 autorizoi HPCC-në që të nënshkruante vetëm një vendim grupor për shumë vendime individuale në rast se numri i lëndëve të ngjashme para saj ishte i lartë;
- Neni 23 lejoi përpunimin e kërkesave të pakontestueshme të kategorisë C në procedurë të rregullt dhe të shpejtuar.

### ***Procedurat evidentuese***

Në hartimin e Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 HPCC-ja miratoi dispozitat evidentuese të cilat në mënyrë efikase bartin përgjegjësinë tradicionale të dëshmitës nga paraqitësi i kërkesës në mënyrë që të merren parasysh pasojat e konfliktit që ndikuan në rrethanat e paraqitësve të kërkesës, dhe në të dhënat publike mbi pronën. Konflikti solli një situatë ku qasja në të dhënat dhe informacionet ishte shumë të vështirësuar. Të dhënat kadastrale dhe të pronës në shumë raste u treguan si jo të besueshme, apo ishin të shkatërruara, të falsifikuara apo të larguara nga autoritet vendore në vitin 1999.<sup>177</sup> Më tutje, vet paraqitësit e kërkesës në shumicën e rasteve kishin ikur pa dokumentacionin e tyre, apo ndonjë dokumenti mbështetës që mund të kenë poseduar, ose ishte humbur ose shkatërruar me paraqitjen e luftës.<sup>178</sup> Përveç kësaj, shqetësimet e përgjithshme të sigurisë dhe lëvizja e kufizuar pengoi apo dekurajoi paraqitësit e kërkesës për të u kthyer në shtëpitë e tyre apo komunat për të gjetur dokumentet e tyre. Në këto rrethana ku shumica e të dhënave dëshmuese që mund të përdorëshin në mbështetje të kërkesës, ishin shkatërruar apo ishin humbur, zbatimi i standardeve dëshmuese që mbi paraqitësin e kërkesës impononte detyrën e vetme që të sjell dëshmi, do të ishte jo i drejtë. Si përgjigje ndaj këtyre rrethanave të posaçme, Rregullorja e UNMIK-ut 2000/60 parashihte që HPCC-ja nuk ishte e detyrueshme, por mund të udhëhiqej nga rregullat e dëshmimeve që

### ***Përgjegjësia e dëshmitës të vërtetës***

Në procedurat tradicionale kundërthënëse gjyqësore rregullat e dëshmisë kërkojnë që pala e cila bën kërkesën ta mbajë mbi vete përgjegjësinë për sjelljen e provave që dëshmojnë kërkesën. Neni 8 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 miratoi një qasje më pak të vështirë ndaj kërkesës në dëshmimin e fakteve duke kërkuar nga paraqitësit e kërkesës që thjeshtë të jepnin të gjitha hollësitë e kërkesës së tyre në formularin e kërkesës dhe ta parashtronte me origjinalet apo me kopjet e çfarëdo dokumenti të rëndësishëm për kërkesën, që ai apo ajo i kishte në posedim apo një fuqi të arsyeshme të përfaqësimit.

Në rastet kur dëshmitë, në të dhënat e posaçme të pronës, nuk ishin në dispozicion të arsyeshëm të paraqitësit të kërkesës, apo në rastet kur dëshmitë e parashtruara nuk ishin të plota, paraqitësi i kërkesës ende mund të parashtronte kërkesë dhe thjeshtë prej tij kërkohej që thjeshtë të parashtronte të gjitha dëshmitë e rëndësishme për kërkesën e tij apo saj. Në raste të tilla procesi në mënyrë të sukseshme imponoi mbi HPD-në një obligim statutar në angazhimin e mbledhjes së dëshmimeve dhe verifikimit të dokumenteve.<sup>179</sup> Prandaj roli i HPD-së në mbledhjen e dëshmimeve dhe gjetjen e fakteve në mënyrë të sukseshme mori ngarkesën tradicionale që binte mbi paraqitësit e kërkesës në sajimin e fakteve dhe dëshmimin e kërkesës së tyre.<sup>180</sup>

<sup>177</sup> Tashmë e shqyrtuar në kapitullin 1 të këtij raporti.

<sup>178</sup> Gjykata e përhershme e publikimit arbitrar, *op. cit.*, shenimi 107, në fq 61.

<sup>179</sup> Shih nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>180</sup> Shqyrtuar në kapitullin 5 të këtij raporti.

### Standardet e dëshmimeve

Në rastet kur e drejta pronësore nuk kontestohet nga asnjëra nga palët që kundërshtojnë kërkesën, standardi për dëshmim në procedurën e HPCC-së kërkonte që paraqitësit e kërkesës të shfaqnin dëshmi *prima facie* për të drejtën pronësore. Kjo mund të plotësohet duke gjetur dëshmi direkte në formë të të dhënave pronësore që tregonin të drejtat statutare dhe poseduese apo duke sjellur dëshmi sekondare siç ishte dokumentacioni që regjistroi faktin se ishin marrë hapa të nevojshëm që paraqitësi i kërkesës të fitonte të drejtën pronësore të pohuar.

Procesi mori në konsideratë vështirësitë në verifikimin e të dhënave pronësore të parashtruara nga paraqitësit e kërkesës në mbështetje të kërkesës së tyre. Në rastet kur dokumentet koresponduese nuk mund të gjindeshin në të dhënat publike, por dokumentet apo të dhënat që u gjetën përbënin dëshmi indirekte të pronës së pohuar, HPCC-ja pranoi këtë si dëshmi *prima facie* të së drejtës pronësore të pohuar. Në vlerësimin e dëshmimeve ka marrë qëndrimin se dështimi në gjetjen e dokumenteve nuk rezultoi domosdoshmërisht në përfundimin se dokumentet e prezentuara nga paraqitësi i kërkesës nuk ishin autentike.

Në lidhje me kërkesat e kategorisë C, neni 23 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 lejoi HPCC-në që të përpunojë kërkesat e tilla në procedurë përmbledhëse të përshpejtuar<sup>181</sup> dhe në rastet e tilla paraqitësve të kërkesës u imponohej një kërkesë themelore dëshmuuese. HPCC-ja ishte e lejueshme të aprovoj një kërkesë dhe të jep urdhër për riposidim të pronës së kërkuar ku paraqitësi i kërkesës bëri rast *prima facie* se ai apo ajo ishin në posedim të pakontestueshëm të pronës para 24 marsit të vitit 1999.<sup>182</sup> Kërkesa e kategorisë C duhej të ishte e pakontestueshme në rastet ku “*pjesëmarrësi kishte zgjedhur të mos merrte pjesë në procedure apo nuk kishte kontestuar vlefshmërinë e kërkesës*” si p.sh ku ai apo ajo iu referuan vetëm nevojave të tij apo saj si bazë për banimin e pronës apo dhanë pohime që ishin aq të zbehta dhe të dykuptimtë, saqë nuk përbënin ndonjë sfidë ligjore për kërkesën.

Në rastet e kategorive C ku kërkesa ishte e pakontestueshme por dokumentet mbështetëse nuk mund të verifikoheshin por dukeshin të vlefshme në shikim, HPCC-ja urdhroi që

---

<sup>181</sup> Shin neni 23.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>182</sup> Me zbatimin e Rregullores 2000/60 HPCC-ja konsideroi se paraqitësi i kërkesës duhet të demonstroj si në vijim:

- (a) *prima facie* në bazë të dëshmimeve të prezentuara të së drejtës pronësore në lidhje me pronën e kërkuar;
- (b) kërkesa është e pakontestueshme në atë se pala përgjegjëse ose zgjodhi të mos merr pjesë në procedurë ose nuk kontestoi vlefshmërinë e kërkesës.
- (c) Ekzistojnë dëshmi se paraqitësi i kërkesës ... ishte në posedim të pakontestueshëm të pronës para 24 marsit 1999; dhe
- (d) të gjitha kriteret tjera të neni 1.2 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 dhe neneve 2.5 dhe 2.6 të Rregullores së 2000/60, *prima facie* ishin plotësuar në çdo rast.

HPD-ja duhej të hetonte nëse kishte apo nuk kishte posedim të pronës duke hetuar komunaliet, përfshirë numrat e telefonit, pavarësisht nëse paraqitësi i kërkesës prezantoi komunaliet apo jo.<sup>183</sup>

Në rastet kur prona e paraqitësit të kërkesës është shkatërruar plotësisht dhe nuk është ngritur ndonjë objekt i ri apo parcela nuk ishte e banuar HPCC-ja urdhroi që kërkesat e tilla në të vërtetë ishin të pakontestueshme dhe prandaj duhej të përpunoheshin në pajtim me procedurën e përsheptuar për përpunimin e kërkesave të kategorisë C, pra në pajtim me procedurën përmbledhëse.<sup>184</sup> Më tutje, në rastet e pakontestueshme të pronës së shkatërruar ku nuk kishte dëshmi dokumentuese që lidhte paraqitësin e kërkesës me pronën, HPCC-ja pranoi deklaratën e shkruar nga fqinjët që konfirmonin se paraqitësi i kërkesës kishte jetuar në pronë e cila më parë gjindej në parcelën e pohuar nga paraqitësi i kërkesës.<sup>185</sup>

Siç u theksua pak më lartë, në vlerësimin e dëshmive rregullat e HPCC-së parashihte se *“mund të ushëhiqej por [nuk] detyrohej nga rregullat e dëshmive të zbatuara në gjykatat lokale të Kosovës”*.<sup>186</sup> Duke miratuar këtë qasje, procedura e përcaktuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/60 ishte prioritar. Kriteri i vetëm dëshmues ishte që dëshmitë të ishin të besueshme dhe neni 21.1 lejoi që HPCC-ja të *“merrte në shqyrtim çdo dëshmi të besueshme, që e konsideronte si të rëndësishme për kërkesën”*,<sup>187</sup> përfshirë dëshmitë e prezentuara nga HPD-ja që kishin të bënin me besueshmërinë e ndonjë të dhëne publike.

HPCC-ja pranoi si kopje të vërtetuar të origjinalit çdo dokument të vërtetuar nga HPD-ja si kopje të vërtetë dhe origjinale në pajtim me nenin 8.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 dhe çdo kopje që ishte vërtetuar në pajtim me ligjin mbi vërtetimin e nënshkrimeve, dorëshkrimeve dhe kopjeve.<sup>188</sup>

Përveç shqyrtimit të parashtrësive me shkrim dhe dëshmive të parashtruara nga palët në procedurë, neni 2.4 i Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 parashihte një proces të obligueshëm për sigurimin e dëshmive duke përcaktuar që HPCC-ja kishte *“të drejtë për qasje të lire në çdo dhe të gjitha të dhënat e rëndësishme për zgjidhjen e kontestit që i është parashtruar.”* HPCC-ja gjithashtu mund të shqyrtonte parashtrësit me shkrim apo gojore nga çdo subjekt ndërqeveritar, qeveritar apo joqeveritar apo dëshmitar ekspert mbi çfarëdo çështje të rëndësishme për kërkesën.<sup>189</sup>

Kjo dispozitë parashihte bazën ligjore për kompetencën e HPCC-së që të kërkoj këshillë të ekspertit në lidhje me verifikimin e dëshmive mbështetëse dokumentuese. HPCC-ja në shumë raste shfrytëzoi kompetencën e saj dhe shfrytëzimi sistematik i mendimeve të ekspertit është kërkuar në të gjitha rastet ku ishte e nevojshme të verifikoheshin vërtetësia e

<sup>183</sup> Udhëzimet e HPCC-së, seanca e 23-të, 16 prilli 2004.

<sup>184</sup> Udhëzimet e HPCC-së, seanca e 24-të, 18 qershor

<sup>185</sup> Udhëzimet e HPCC-së, seanca e 25-të, 27 gusht.

<sup>186</sup> Shih nenin 21.1 të Rregullores së UNMIK-ut.

<sup>187</sup> *Ibid.*

<sup>188</sup> Gazeta zyrtare KSAK, nr.37/71.

<sup>189</sup> Shih nenin 19.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.



nënshkrimeve të ndonjë dokumenti ose *suo motu* ose kur ngriteshin pohimet mbi falsifikimin nga pala në procedurë.<sup>190</sup>

### ***Delegimi i kompetencës për rishikimin e kërkesave***

Në pajtim me nenin 19 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 HPCC-ja mund të emëroj njërin nga anëtarët e saj që të kryej secilën nga detyrat e saj dhe ta delegoj rishikimin e kërkesave të caktuara dhe funksionet dëshmuese kryesekretarit, dhe anëtarëve të personelit të HPD-së të caktuar në shërbim të HPCC-së, nën mbikëqyrjen e HPCC-së. Me qëllim të përshpejtimit të zgjidhjes së kërkesave HPCC-ja i dha kompetencën Komisionerit vendor që të bëjë rishikimin e dëshmive të caktuara dhe kryerjen e shumicës së dëgjimeve gojore të palëve dhe dëshmitarëve.

Miratimi i kriteriumit të rrept dhe objektiv në përcaktimin nëse kërkesa hynte në kategorinë e caktuar nuk la shumë vend për liri të veprimit. Kjo ndihmoi delegimin e funksioneve për rishikim të dëshmive sa i përkiste kategorive të caktuara të kërkesave që ishin ushtruar në konsultim me Komisionerin vendor. Udhëzimet ligjore që rregullonin procedurën e rishikimit të dëshmive u miratuan nga HPCC-ja dhe u zhvilluan gjatë seancave të saj në mënyrë që të përshpejtonin vendimmarrjen.

Nën mbikëqyrjen e HPCC-së, kryesekretari u ngarkua me përgjegjësinë që të kryej rishikimin e dëshmive në kategoritë vijuese të kërkesave pas zhvillimit të përparësive të nevojshme nga HPCC-ja:

- (i) Kërkesat e pakontestueshme të katetgrsë C;
- (ii) Pronat e shkatërruara ku kishte dëshmi mbi posedimin para 24 marsit 1999;
- (iii) Rastet në të cilat paraqitësi I kategorisë C pohoi se kishte hequr dorë nga e drejta e tij apo saj pronësore, por kërkonte rishikimin e vlerës së shitblerjes apo anulimin e kontratës, ndihmë kjo që ishte jashtë jurisdiksionit të HPCC-së, dhe kërkesa duhej t'i referohej gjykatës lokale në pajtim me nenin 22.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60;
- (iv) Kërkesat e kategorisë A ku paraqitësi i kërkesës, i cili gëzoi të drejtën banesore dhe të cilët asnjëherë nuk kishin hequr dorë nga e drejta e tyre pronësore, kërkuan ndihmë sepse ai apo ajo ishin të parandaluar që të privatizonin të drejtën banesore të tij apo saj, ndihmë kjo e cila ishte jashtë jurisdiksionit të HPCC-së;<sup>191</sup>
- (v) Kërkesat që duheshin refuzuar sepse paraqitësi i kërkesës nuk parashtrroi autorizimin e vlefshëm; dhe
- (vi) Kërkesat rishqyrtuese që ishin dukshëm jo meritore.

---

<sup>190</sup> Ekspertët hetuan nënshkrimin , duke e krahasuar të njëjtën me mostrat e nënshkrimeve në dokumentin në të cilat mbështetet pala. Nëse nuk është arritur një përfundim i qartë mbi ate nëse nënshkrimi ishte i vërtetë, HPCC-ja, në mënyrë që të fitohet një qartësi e mëtejshme mbi këtë çështje, emëroi një anëtarë për të dëgjuar dëshminë gojore nga palët në pajtim me Rregulloren 19.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>191</sup> Nga viti 1992 e më pastaj 1992, Ligji mbi Banimin lejoi bartësin e të drejtës së banimit të blejë pronën në baza financiare, e shqyrtoi më tutje në Kapitullin 1 të këtij Raporti.

## 2. Procedura para HPCC-së

Si rregullë e përgjithshme, HPCC-ja vendosi mbi kërkesat në bazë të parashtresave me shkrim dhe dëshmime dokumentuese. Prandaj palët parashtuan dëshmitë dhe argumentet e tyre HPCC-së përmes HPD-së, dhe kishin të drejtë të dinin mbi parashtresat e pales tjetër dhe të përgjigjeshin me dorëzimin e dëshmime dhe parashtresave si përgjigje. Palët nuk kishin të drejtë të jepnin dëshmi gojore përveç nëse ishin të ftuar për këtë,<sup>192</sup> meqenëse organizimi për pjesëmarrjen e disa mija paraqitësve të kërkesës do të nënkuptonte shterimin e burimeve dhe kohës, dhe kështu të jetë në kundërshtim me të drejtën e paraqitësit të kërkesës për ndihmë ligjore Brenda një periudhe të arsyeshme kohore.<sup>193</sup> Më tutje, fakti që paraqitësit e kërkesave ishin zhvendosur nëpër RFJ dhe më larg ka rezultuar që vetëm disa nga paraqitësit e kërkesave të mund të ushtrojnë të drejtën për pjesëmarrje në seancë dëgjimi.

Kështu që, HPCC-ja ka vendosur për kërkesat duke u bazuar në dosjen e kërkesave që i janë referuar nga HPD-ja, të cilat përmbanin dëshmitë dhe provat e palëve në kërkesë si dhe dëshmitë e mbledhura nga HPD-ja. Rregullat e procedurës gjithashtu parashikonin që HPCC-ja të caktonte njërin nga anëtarët e vet për të kryer çfarëdo detyre, përfshirë marrjen e dëshmime gojore.<sup>194</sup> Në disa raste Komisionerit vendor i është kërkuar nga Kryesuesi që të mbajë seancë dëgjimore me palët.<sup>195</sup> Këto seanca dëgjimi kishin qëllim mbledhjen e fakteve dhe në përgjithësi nuk ishin kundërshtuese për nga natyra.

Rregullorja e UNMIK-ut 2000/60 parashikonte që vendimet zakonisht të merren njëzëri, por në raste kur konsensusi nuk do të mund të arrihej do të vendosej përmes votës së shumicës.<sup>196</sup> Kur HPCC-ja ka konstatuar se nevojiteshin informata shtesë për të arritur përcaktimin mbi çështjet e ngritura në kërkesë, mund t'ia kthente HPD-së me urdhër për të ndërmarrë hetime shtesë në lidhje me kërkesën.<sup>197</sup> Kjo natyrisht përfshinte verifikimin shtesë, kërkimin e dokumenteve apo intervistimin e palëve në kërkesë. Në rast të kthimit të kërkesës është kërkuar shënimi i i këtij fakti në faqen e parë të raportit të përpunimit të kërkesës, bashkë me pyetjet e caktuara apo veprimet e kërkuara nga HPCC-ja. Pas shqyrtimit të pyetjeve apo veprimeve, në raportin e përpunimit ishte futur shënimi mbi

---

<sup>192</sup> Shih nenin 19.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60. Në ato raste të veqanta ku HPCC mbajti një dëgjim gojor, rregullat e procedurës kërkonin që të mbahej në vend publik dhe të kryhet sipas udhëzimit të Kryesuesit të HPCC në afat të duhur që iu është dhënë palëve, shih nenin 19.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60. Tri dëgjime gojore janë mbajtur para seancës së plotë të HPCC-së derisa 67 dëgjime janë mbajtur para Komisionerit vendor.

<sup>193</sup> Si udhëzim i përafërt, nëse supozohet se HPCC-ja kalon gjysmën e ditës duke punuar në seancë dëgjimi për secilën kërkesë si dhe secilën kërkesë për rishqyrtim dhe se Komisionerët punojnë me orar të plotë në vend të seancave vjetore që zgjasin gjashtë muaj, procesit do t'i ishin dashur 67 vite për tu përfunduar.

<sup>194</sup> Shiko nenin 19.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>195</sup> Komisioneri vendor ka mbajtur seanca dëgjimi në lidhje me 67 kërkesa, derisa HPCC-ja ka mbajtur seanca dëgjimi në tri (3) raste gjatë seancave.

<sup>196</sup> Shiko nenin 20.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 i cili gjithashtu parashihte që nëse dy nga anëtarët e kolegjit ishin të pranishëm kurse nuk mund të arrihej konsensusi, Kryesuesi i kolegjit do ta shtynte shqyrtimin e kërkesës për seancën e ardhshme të kolegjit. Vetëm në një rast kërkesa ishte vendosur përmes votës së shumicës, që ka të bëjë me HPCC/REC/91/2007 në paragrafin 8 (b).

<sup>197</sup> Shiko nenin 21.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

rezultatit e veprimit të ndërmarrë si dhe përgjigjia, kurse kërkesa ishte paraqitur përsëri për rishqyrtim në seancën vijuese të HPCC-së.<sup>198</sup>

Para se të vendosej për një kërkesë, HPCC-ja mund të lëshonte urdhër të përkohshëm në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/60, të cilin e konsideronte si të nevojshëm për zgjidhjen e drejtë dhe të shpejtë të kërkesave<sup>199</sup> dhe mund të merrte masa të përkohëshme mbrojtëse në rastet kur është parë e nevojshme mbrojtja e interesave të palëve nga dëmet e pariparueshme.<sup>200</sup> Ajo gjithashtu mund t'i bartëte çështjet e caktuara që shtroheshin në lidhje me kërkesën, që nuk ishin nën juridiksionin e saj, te gjykata vendore kompetente, organi administrativ apo tribunali.<sup>201</sup>

### 3. Vendimet e HPCC-së

HPCC-ja mund t'i aprovonte apo refuzonte ose të merrte vendim apo urdhër të nevojshëm për të vënë në funksion Rregulloren e UNMIK-ut 2000/60 përfshirë urdhrat për rikthim të së drejtave pronësore, riposedimin e pronës, regjistrimin e të drejtave pronësore në regjistrat publike pronësore si dhe kompenzimin. Ajo nuk mund të caktonte mjete tjera ligjore përpos atyre të caktuara përmes Rregullores së UNMIK-ut 2000/60<sup>202</sup> dhe mund ta kufizonte vendimin në të drejtat e posedimit mbi pronë në rast se kjo ofronte mjete ligjore efektive.<sup>203</sup>

Neni 22.7 ia lejonte HPCC-së të merrte urdhrat vijuese:

- (a) të vendos të drejta të tilla në pronë që nevojiten për zgjidhjen e kërkesës;
- (b) ta jep urdhërin për posedimin e pronës në dobi të cilësdo palë;
- (c) ta urdhërojë regjistrimin e çdo të drejte në pronë në regjistrin përkatës publik;

---

<sup>198</sup> Udhëzimet e HPCC-së, Seanca e 21-të dhjetor 2003 dhe Seanca e 30-të qershor 2005. HPD-ja është përpjekur të trajtojë me shpejtësi të gjitha kërkesat që i ishin kthyer nga HPCC-ja për t'i paraqitur përsëri në seancën vijuese të HPCC-së.

<sup>199</sup> Shiko nenin 19.7 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/60.

<sup>200</sup> Shiko nenin 24 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60. Pas rekomandimit të HPD-së, për shkak të kërkesës së paraqitësit të kërkesës apo arsye tjetër, HPCC-ja në pajtim me nenin 24.1 të Rregullores së UNMIK-ut mund të caktonte masa të përkohëshme mbrojtëse kur është konstatuar nevoja për një gjë të tillë, moscaktimi i masave të tilla palës mund t'i shkaktonte dëme të pariparueshme. Në bazë të nenit 24.2 të kësaj Rregulloreje, në përjashtim të rasteve, mbi rekomandimin e agjencive përgjegjëse për zbatimin e ligjit dhe kur është konsideruar e nevojshme të kontrollohet kërcënimi i vazhdueshëm i sigurisë publike, masat e përkohëshme mund të përfshinin dëbimin e banuesit aktual nga prona e kërkuar. HPCC-së i lejohej të merrte urdhër të tillë vetëm në rast se ishte e kënaqur me ekzistimin e dëshmimeve se paraqitësi i kërkesës paraprakisht ka banuar në mënyrë të pakontestueshme në pronë. Urdhri për dëbim i lëshuar sipas nenit 24.2 të Rregullores mund të ekzekutohej nga organet përgjegjëse për zbatimin e ligjit pa paralajmërim. Udhëzimet procedurale të mëtuajtshme për kërkimin e masave të përkohëshme ishin përcaktuar në nenin 4 të Rregullave Shtesë të HPCC-së të bashkangjitura në Shtojcën III. Keni parasysh se masat e përkohëshme asnjëherë nuk janë kërkuar nga HPD-ja apo agjencitë për zbatimin e ligjit apo nuk ishin urdhruar nga HPCC-ja.

<sup>201</sup> Shiko nenin 22.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>202</sup> Neni 22.3 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>203</sup> Neni 22.5 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

(d) kur është e domosdoshme për ta zgjidhur lëndën, t'i ndryshojë kushtet e çfarëdo kontrate të bërë me qëllim për t'iu shmangur ligjit diskriminues në mënyrë që ta pasqyrojë qëllimin e vërtetë të palëve në kontratë;

(e) ta anulojë çdo marrëveshje për dhënie më qira sa i përket pronës e cila është objekt i një urdhërese nga Rregullorja e UNMIK-ut 2000/60 dhe të bëjë urdhëresa plotësuese që do ta mundësojnë anulimin e saj;

(f) ta refuzojë apo aprovojë kërkesën dhe t'i bartë çështjet e ngritura aty në gjykatën vendore; dhe

(g) të kthejë kërkesën HPD-së për hetime të mëtutjeshme.

Kur kërkesa është paraqitur nga anëtari i familjes së bartësit të së drejtës pronësore<sup>204</sup> HPCC-ja mund të vendoste për çfarëdo të drejte pronësore në emër të bartësit të së drejtës pronësore duke lëshuar urdhër për riposim në dobi të paraqitësit të kërkesës.<sup>205</sup> Pas vendimit të HPCC-së gjykatat vendore në Kosovë kishin juridiksionin për të përcaktuar çështjet juridike për të cilat nuk kishte vendosur HPCC-ja.<sup>206</sup>

#### 4. Forma e vendimeve

Neni 22 i Rregullores së UNMIK-ut përcakton rregulla dhe procedura të hollësishme lidhur me vendimet e HPCC-së. HPCC-ja i detyrohej parimeve të përcaktuara në vendimet e veta, përveç në rast të ekzistimit të arsyeve detyruese për të devijuar nga këto parime.<sup>207</sup> Kjo dispozitë ia impononte HPCC-së kriterin që të veprojë në përputhje me ligjin në kërkesat që ngrisin çështje të ngjashme juridike dhe dëshmuese. Ishin themeluar disa mekanizma për të siguruar përpunueshmëri të vendimeve të HPCC-së me ato paraprak. Ishte krijuar indeksi i vendimit që mund të kërkohej përmes fjalës kyçe. Mekanizmi i rishikimit, i caktuar për pranimin e raporteve të përpunimit të kërkesës, përmes së cilit shqyrtoheshin thellë nga udhëheqësi i CCPU-së, Kryesekretaria si dhe vet HPCC-ja, gjithashtu ka siguruar që vendimet të lëshohen në përputhshmëri me vendimet e mëparshme.

Vendimet e HPCC-së ishin të detyrueshme dhe të zbatueshme dhe nuk i nënshtroheshin rishikimit nga ndonjë organ tjetër gjyqësor apo administrativ në Kosovë.<sup>208</sup>

---

<sup>204</sup> Bazuar në nenin 7.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>205</sup> Shiko nenin 22.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60. Vendimi i tillë nuk ka përcaktuar apo nuk ka ndikuar në çështjet juridike ndërmjet paraqitësit të kërkesës dhe bartësit të së drejtës pronësore apo ndonjë personi tjetër që nuk ishte palë në kërkesë.

<sup>206</sup> Shiko nenin 22.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60. Keni parasysh gjithashtu Urdhërin Sqarues të PSSP-së që është shqyrtuar në Kapitullin 2 të Raportit.

<sup>207</sup> Shiko nenin 22.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60. Në udhëzimet e tij HPCC ka nënvizuar rëndësinë e përcjelljes së precedentëve kur jepet arsyetimi në raportet e përpunimit të kërkesave si dhe në përpilimin e vendimeve për shkak se i detyrohej vendimeve të veta paraprake, përpos kur ekzistojnë rrethana të caktuara për të bërë ndryshe, Udhëzimet e HPCC-së, dhjetor 2001.

<sup>208</sup> Shiko nenin 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23.

Vendimet duhej të ishin të arsyeshëm dhe me shkrim, duke përcaktuar faktet materiale si dhe të drejtat pronësore të konstatuara nga HPCC-ja. Ato duhej të nënshkruheshin nga Kryesuesi i HPCC-së.<sup>209</sup> Neni 22.8 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 kërkonte që vendimet të përmbanin hollësitë themelore vijuese:

- (i) datën e miratimit;
- (ii) emrat e palëve dhe përfaqësuesve të tyre;
- (iii) arsyet e vendimit (duke përfshirë faktet materiale dhe të drejtat pronësore të gjetura nga Komisioni);
- (iv) urdhërat e Komisionit.

Fillimisht HPCC-ja ka aprovuar vendimet lidhur me kërkesat individuale. Pastaj me qëllim të mundësimin të zgjidhjes së shpejtë të kërkesave ajo shfrytëzoi teknikën e përcaktuar sipas nenit 22.9 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60, që ia lejonte lëshimin e vendimit lidhur me pakon e kërkesave që kishin të bënin me çështje të ngjashme juridike, i njohur si “Vendim Grupor”. Vendimet grupore gradualisht ishin zhvilluar përmes sistemit të ligjeve për të përfshirë të gjitha çështjet juridike. Disa janë aplikuar në një numër të madh kërkesash siç janë refuzimet e kërkesave të kategorisë C apo rastet e pronave të shkatërruara derisa të tjerat vlenin për disa apo një numër më të vogël kërkesash siç janë refuzimet e kërkesave të kategorisë A ku paraqitësit e kërkesave kanë dështuar që të dëshmojnë të drejtat e banimit. HPCC-ja ia ka lëshuar Kryesekretarisë udhëzimet për përpilimin e vendimeve grupore.<sup>210</sup> Në udhëzimet e tij Komisioni ka nënvizuar rëndësinë e përcjelljes së precedenteve kur jepet arsyetimi në raportet e përpunimit të kërkesave si dhe në përpilimin e vendimeve për shkak se i detyrohej vendimeve të veta paraprake, përpos kur ekzistojnë rrethana të caktuara për të bërë ndryshe. Vendimet paraprake ishin përpiluar nga Kryesekretaria në konsultim me HPCC-në lidhur me secilën pako të kërkesave. Ishin përpiluar gjithësejt 17 lloje të ndryshme të vendimeve grupore.

Kryesuesi përmes nënshkrimit të Vendimit Grupor aprovonte të gjitha vendimet individuale të identifikuar dhe të regjistruara me numrin e kërkesës (numri DS) në Vendimin Grupor.<sup>211</sup> Vendimet lëshoheshin me numrin e vendimit, që vazhdonte me radhë, duke mos u kthyer nga “0” në fillim të secilit vit. HPCC-ja ka lëshuar diku 209 vendime të shkallës së parë, ku janë përfshirë edhe vendimet individuale e edhe vendimet grupore.

Nëse për kërkesën është vendosur përmes Vendimit Grupor, me qëllim që palëve t’u bëhet e qartë, Kryesekretaria përpilonte vendimin individual lidhur me secilën kërkesë që i përcaktonte hollësitë e pronave individuale të paraqitësit të kërkesës si dhe pranimin e ndihmës nga HPCC-ja. Ajo i referohej Vendimit Grupor të HPCC-së dhe paragrafit të caktuar që përcaktonte arsyet e vendimit të HPCC-së lidhur me kërkesën.

---

<sup>209</sup> Shiko nenin 22.9 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>210</sup> Udhëzimet e HPCC-së, Seanca 21, 12 dhjetor 2003.

<sup>211</sup> Shiko nenin 22.9 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

Me qëllim të zvogëlimit të rrezikut nga falsifikimet, të gjitha Vendimet e HPCC-së duhej të ishin të vulosura dhe të nënshkruara nga Kryesuesi i HPCC-së.<sup>212</sup> Kryesekretaria i vërtetonte vendimet individuale<sup>213</sup> që në secilin rast i dërgoheshin palëve në kërkesë bashkë me Vendimin Grupor.<sup>214</sup>

Kryesekretaria gjithashtu ishte e autorizuar për të ndryshuar çfarëdo gabimi tekstual në vendimin e HPCC-së, që nuk do të ndikonte thelbësisht në të drejtat e cilësdo palë në procedurë, ndërsa Kryesuesi i HPCC-së duhej të pajtohej me përmirësimet.<sup>215</sup>

## **5. Urdhërat dhe mjetet ligjore të HPCC-së**

HPCC-ja mund ta aprovonte ose ta refuzonte një kërkesë.

Kur HPCC-ja aprovonte kërkesën në dobi të paraqitësit të kërkesës, ndihma apo mjete ligjor pasues që mund të aprovohej ndryshonte në bazë të kategorisë së kërkesës dhe rrethanave të shpronësimit fillestar. Ajo nuk ka mund të jepte mjete ligjore përveç atyre të përcaktuara në Rregulloren e UNMIK-ut 2000/60.<sup>216</sup>

Mjetet ligjore që mund të aprovohehin në lidhje me kërkesat janë trajtuar më mirë në nëntitujt vijues:

### ***Kërkesat e kategorisë A***

Në rastet kur është konstatuar se paraqitësi i kërkesës kishte të drejtën valide të banimit apo të pronësisë, HPCC-ja urdhëronte kthimin në formë të rikthimit të së drejtës pronësore në rast se rikthimi në lloj nuk ishte i mundshëm, si në rastet kur prona është privatizuar dhe pastaj i është shitur pronarit të ri, ku kompenzimi ishte mjete i duhur ligjor.<sup>217</sup>

Në rastet kur është urdhëruar kthimi në lloj, kurse prona ishte e uzurpuar në mënyrë të paligjshme, ishte aprovuar urdhëri që kërkonte nga banuesi i paligjshëm ta lironte pronën brenda tridhjetë (30) ditësh, duke e paralajmëruar se dështimi për të vepruar në pajtim me urdhërin do të shkaktonte dëbimin e banuesit nga prona.

Rregullorja e UNMIK-ut 1999/23, interpretuar bashkë me dispozitat e neneve 1 dhe 4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60, ia kufizonte të drejtën për kthim, kur humbja e së drejtës pronësore ishte si pasojë e diskriminimit, atyre që kishin të drejta të banimit apo të

---

<sup>212</sup> Udhëzimet e HPCC-së, Seanca 5, janar 2001. Për shkaqe sigurie emrat e Komisionerëve nuk paraqitëshin në vendimet e HPCC-së apo urdhrat për dëbim që lëshoheshin pastaj për të zbatuar vendimet.

<sup>213</sup> Shiko nenin 22.9 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60. Kopja e dokumentit origjinal, nënshkruar nga Kryesuesi, që i ishte dërguar Kryesekretarisë përmes dërgimit me faks të origjinalit, ishte kompetencë e mjaftueshme për të ndërmarrë çdo lloj veprimi në pajtim me dokumentin.

<sup>214</sup> Sa i përket dërgimit të vendimeve paraqitësve të kërkesave, shiko Kapitullin 8 të këtij Raporti.

<sup>215</sup> Shiko nenin 22.11 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>216</sup> Neni 22.3 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>217</sup> Shiko nenin 2.2 dhe 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

pronësisë.<sup>218</sup> Paraqitësve të kërkesave A që kishin më pak të drejta banimi të përfunduara nuk u takonte kthimi, kurse atyre që kishin dështuar që të plotësonin të gjitha hapat e nevojshëm për të fituar dhe përfunduar të drejtën e banimit u ishin refuzuar kërkesat dhe u është dashur të kërkojnë mjete ligjore përmes gjykatave vendore. Kjo donte të thoshte se paraqitësit e kërkesave të kategorisë A që i ishin nënshtruar diskriminimit, por nuk i kishin përfunduar të drejtat e banimit, ishin lënë pa ndonjë mjet ligjor pranë HPCC-së. HPCC-ja e ka nxjerr në pah këtë çështje duke propozuar kompenzimin si mjet ligjor dhe ka kërkuar nga UNMIK-u të ndërmarrë hapat e nevojshëm përmes përmirësimeve legislative për shqyrtimin e kësaj çështjeje. Deri më tani nuk është ndërmarrë asnjë hap për të shqyrtuar këtë çështje.

Megjithatë, HPCC-ja së voni ka mësuar se në disa kërkesa të kategorisë A të refuzuara nga HPCC-ja për shkak se paraqitësi i kërkesës ka dështuar të dëshmojë të drejtën banesore mbi pronën e kërkuar, paraqitësit të kërkesës i ishte mundësuar paraqitja e kërkesës për kompenzim pranë Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM). Kjo ka ndodhur në rastet kur paraqitësi i kërkesës ka pohuar se dështimi për të kryer hapat e nevojshëm që të fitojë të drejtën banesore ishte shkak i praktikave diskriminuese të Bartësve të së Drejtës së Ndarjes, kryesisht Ndërmarrjet Shoqërore (NSH) apo Ndërmarrjet Publike (NP) që ishin nën juridiksionin e AKM-së (që ishte përgjegjëse për menaxhimin, privatizimin apo likuidimin e tyre), gjë që e ka penguar atë të marrë hapat e nevojshëm për të përmbushur kriteret për fitimin e së drejtës banesore.<sup>219</sup> AKM-ja i ka njohur këta paraqitës të kërkesave si kreditorë të NSH-ve apo NP-ve dhe ka pranuar se, në rastet kur pohimet e tyre ishin të bazuara, u takonte kompenzimi në të holla për shkak të praktikave diskriminuese të cilat i kishin penguar të fitojnë të drejtën banesore. Megjithatë, duhet të vihet në pah se fokusimi i kërkesës dhe ndihma që mund të arrihej nga AKM-ja në raste të tilla ishte kufizuar në kompenzim me të holla për shkak të diskriminimit, ndryshe nga ndihma për pronën e kërkuar.<sup>220</sup>

Në gusht të vitit 2005, HPCC-ja në raste të tilla ka përmirësuar sistemin e vet të ligjeve duke e gjetur si pikëmbështetje atë se marrë parasysh diskriminimin dhe mënyrën e parregullt të pohuar sipas së cilave pastaj pronat ishin ndarë (paraqitësve të kërkesave të kategorisë C), ajo e ka parë të arsyeshme bartjen e çështjeve që kanë të bëjnë me përcaktimin e ndihmës ligjore, nëse ka, që është e mundshme për paraqitësin e kërkesës së kategorisë A sipas ligjit në fuqi, të gjykatat vendore kompetente. Me qëllim të parandalimit të dështimit të kësaj procedure HPCC-ja ka marrë një sërë urdhrash të rëndësishëm. Ajo urdhëronte që deri në kohën kur gjykata të kishte marrë vendimin për rastin e tillë, paraqitësit të kërkesës së kategorisë C t'i ndalohej bartja e së drejtës pronësore ndonjë personi tjetër, përveç në rastet kur bartja e tillë të jetë bërë në mënyrë

---

<sup>218</sup> HPCC-ja është angazhuar në shqyrtimin e hollësishëm të kësaj çështjeje në vendimet e mëparshme që kanë trajtuar kërkesat e kategorisë A, siç janë HPCC/D/14/2001/A; HPCC/D/18/2001/A dhe HPCC/D/19/2001/A.

<sup>219</sup> Lidhja e kontratës mbi shfrytëzimin dhe/apo marrja e posedimit të pronës së kërkuar ishin parakushte themelore për fitimin e së drejtës banesore sipas Ligjit mbi Marrëdhëniet Banesore.

<sup>220</sup> Për t'i ndihmuar paraqitësit e kërkesave, nëse ata pajtoheshin dhe me kërkesë të AKM-së, HPD-ja ia ka kaluar dosjen e kërkesës AKM-së.

miqësore me paraqitësin e kërkesës së kategorisë A.<sup>221</sup> Për më tepër, me njohjen e faktit se mbetja në fuqi e ndalesës së tillë ishte e padëshirueshme, nëse paraqitësi i kërkesës së kategorisë A nuk i ndiqte aktivisht procedurat gjyqësore të parashikuara, HPCC-ja urdhëronte që ngrirja e bartjes së pronës mund të përfundonte nëse nuk inicoheshin procedurat në gjykatën vendore brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh.

### ***Kërkesat e kategorisë B***

Në kërkesat e kategorisë B ku HPCC-ja ka konstatuar se paraqitësi i kërkesës kishte fituar të drejtën e pronësisë mbi pronën e kërkuar përmes kryerjes së transakcionit jozyrtar, ajo urdhëronte që pronësia e paraqitësit të kërkesës të regjistrohej në regjistrat e caktuara publike.<sup>222</sup>

Aprovimi i urdhrin lidhur me kërkesën e kategorisë B nuk e parandalonte gjykatën vendore që të përmirësonte regjistrin publik përkritazi me regjistrimin e të drejtave pronësore mbi pronë, e që pastaj ka vendosur për anulimin e transakcionit në fjalë. HPCC-ja urdhëronte vetëm regjistrimin e së drejtës pronësore në bazë të transakcionit jozyrtar të paregjistruar.

### ***Kërkesat e kategorisë C***

Në kërkesat e kategorisë C, ku ishte konstatuar se paraqitësi i kërkesës kishte të drejtën e posedimit të ligjshëm të pronës së kërkuar apo ndonjë formë tjetër të së drejtës pronësore e cila ia jepte të drejtën për marrjen e posedimit të pronës, (siç është kërkesa konkurruese e kategorisë A<sup>223</sup>), HPCC-ja urdhëronte riposedimin e pronës së kërkuar në dobi të paraqitësit të kërkesës.

Neni 22.5 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 në mënyrë të qartë parashikon se HPCC-ja mund të “kufizojë vendimin për të drejtë të posedimit mbi pronën e kërkuar në rastet kur kjo do të ofronte mjete juridike efektive për kërkesën”. HPCC-ja ka miratuar këtë qasje në marrjen e vendimeve për kërkesat e kategorisë C, ku mjete juridik që do t’i jepej paraqitësit të suksesshëm të kërkesës ishte e drejta për riposedim të pronës duke mos përfshirë përcaktimin e së drejtës aktuale pronësore mbi të drejtën e posedimit. Një rast përjashtimi nga kjo kishte të bënte me rastet e ekzistimit të kërkesave konkurruese valide të kategorisë A dhe C të paraqitura për të njëjtën pronë. Këto situata janë shqyrtuar më poshtë.

Në rastet kur HPCC-ja urdhëronte riposedimin e pronës së kërkuar në dobi të paraqitësit të kërkesës, kurse prona ishte e uzurpuar në mënyrë të paligjshme, aprovohej urdhri që udhëzonte banuesin e paligjshëm të lironte pronën brenda tridhjetë (30) ditësh, me njoftimin që dështimi për të përmbushur urdhrin e tillë do të rezultonte me dëbimin e asaj pale nga prona.

---

<sup>221</sup> HPCC-ja kishte juridiksion të merrte urdhra të tilla në bazë të nenit 27(g) të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>222</sup> Shiko nenin 2.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>223</sup> Shqyrtuar më poshtë.



### *Urdhri për rikthim në rastet e kërkesave konkurruese valide të kategorisë A dhe C*

Rregulloret e UNMIK-ut 1999/23 dhe 2000/60 miratuan parimet e përgjithshme vijuese në lidhje me rikthimin në rast paraqitjeje të kërkesave konkurruese për të drejta banesore të kategorisë A dhe të drejta pronësore të kategorisë C për të njëjtën pronë.

Në lidhje me të drejtën për kthim, cilitdo paraqitës të kërkesës e drejta banesore e të cilit ishte ndërprerë ndërmjet 23 marsit 1989 dhe 24 marsit 1999 si rezultat i diskriminimit i takonte kthimi në pajtim me Rregulloren.<sup>224</sup> Neni 3.3 i Rregullores përcaktonte se kthimi në lloj do të duhej dhënë, përveç nëse personi fizik e kishte fituar pronësinë e pronës përmes transaksionit vullnetar valid të vlerës para datës së hyrjes në fuqi të Rregullores (që ishte 30 tetori 2000), në rastin e tillë kompenzimi ishte mjeti juridik i duhur.<sup>225</sup>

Neni 4.2 i Rregullores ofron sqarim për përjashtim nga neni 3.3 ku përshkruhet se në rast se apartamenti shoqëror, varësisht nga ndërprerja e së drejtës banesore, ishte blerë nga bartësi i së drejtës së ndarjes prej ndonjë pale në pajtim me Ligjin mbi Banimin (i cili ofronte kornizën për privatizimin e pronave shoqërore), i cili akoma ishte pronari aktual i pronës, paraqitësi i kërkesës i cili kishte të drejtën banesore e kishte të drejtën e pronësisë së apartamentit pasi t'ia paguante HPD-së shumën e përcaktuar nga ajo. Pronarit aktual (që është paraqitësi i kërkesës së kategorisë C apo pala që përgjigjet në procedurë) i cili e ka blerë apartamentin sipas Ligjit mbi Banimin i takonte kompenzimi për shkak të humbjes së drejtës së pronësisë.

Vështirësia e miratimit të kësaj formule për të rregulluar të drejtën e rikthimit për shkak të humbjes të së drejtave pronësore ishte kufizimi i madh i saj. Ajo vlente vetëm në rastet kur ishin paraqitur të drejta konkurruese valide banesore dhe pronësore lidhur me apartamente shoqërore. Ajo nuk ofronte ndonjë formë kompenzimi për paraqitësit e kërkesave C me ndonjë formë tjetër të të drejtave pronësore, të cilët ishin dëmtuar nga dhënia e kthimit në lloj në dobi të paraqitësit të kërkesës së kategorisë A me të drejtë banesore valide. Në rastet kur paraqitësi i kërkesës së kategorisë C nuk e ka privatizuar të drejtën banesore apo vetëm e ka gëzuar të drejtën e ligjshme të posedimit mbi pronë, e drejta e tyre pronësore ishte mbizotëruar nga e drejta banesore e paraqitësit të kërkesës së kategorisë A, pasi që dispozitat e nenit 4.3 të Rregullores parashihnin që me përjashtim të paraqitësve të kërkesave të kategorisë C që kanë të drejta *“asnjë person, të drejtat e të cilit janë shkelur nga vendimi i Komisionit që përcakton kthimin në lloj nuk ka të drejtë në kurrfarë kompensimi”*. Kështu që, të drejtat pronësore të paraqitësve të kërkesave të kategorisë C në raste të tilla në të vërtetë i nënshtroheshin të drejtave për kthim të bartësve të së drejtës banesore që kanë ekzistuar para vitit 1989. Në raste të tilla refugjatëve apo personave të zhvendosur të cilët e kishin të drejtën e pronës më 24 mars 1999, kurse e kishin humbur posedimin e asaj prone për shkak të ngjarjeve të shkaktuara

<sup>224</sup> Shiko nenet 1.2(a) të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 dhe 2.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>225</sup> Neni 5 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 i ndalonte shitjet pas ardhjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 deri në zgjidhjen e kërkesave të paraqitura në HPD, apo pas afatit kohor për pranimin e kërkesës, cilado që të jetë më e fundit. Çfarëdo kontrate lidhur me shitjen, shkëmbimin apo dhuratën e bërë në kundërshtim me nenin 5 ishte e pavlefshme dhe nule.

nga fushata ajrore e NATO-s nuk e kishin të drejtën për urdhër nga HPCC-ja për riposedit të pronës apo për kompensim për shkak të humbjes së të drejtës pronësore. Nëse ndonjëherë sajohet ndonjë skemë apo bazë për kompensim shtesë siç është nxitur nga HPCC-ja në lidhje me paraqitësit e pasuksesshëm të kërkesave të kategorisë A, vëmendje do t'i kushtohet zgjerimit të saj te kjo klasë e paraqitësve të pasuksesshëm të kërkesave të kategorisë C.

### ***Kompensimi***

Juridiksioni i HPCC-së për të dhënë kompensim në të holla ishte i kufizuar për kërkesat të cilat ishin brenda dispozitave të shprehura të nenit 4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60, siç është nënvizuar më lart në lidhje me kërkesat e caktuara të suksesshme të kategorisë A dhe C. Ajo nuk e kishte juridiksionin për të dhënë kompensim për dëmet apo shkatërrimin e pronës së banimit ashtu siç parashihet qartë në nenin 2.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 ku thuhet se “Komisioni nuk do të pranojë kërkesa për kompensimin e dëmeve apo të shkatërtimeve të pronës.”

### ***Kërkesat për pronat e shkatërruara***

Kur paraqitësi i kërkesës ka dëshmuar se e ka pasur të drejtën pronësore dhe i ka përmbushur kriteret për urdhër për riposedit në kohën e shkatërrimit të pronës, HPCC-ja ka lëshuar urdhrin e njohur si “urdhër deklarativ” duke konfirmuar të drejtën e paraqitësit të kërkesës për posedim të ligjshëm mbi pronën në kohën e shkatërrimit. Siç është cekur më lart, HPCC-ja nuk e kishte juridiksionin për t’ia dhënë kompensimin paraqitësve të kërkesave në raste të tilla.

Në rastet e pronave të shkatërruara, aprovimi i urdhrin për riposedit nga ana e HPCC-së varej nga fakti nëse vendi ishte i uzurpuar, nga natyra dhe forma e uzurpimit si dhe nga ajo nëse paraqitësit e kërkesave kishin ndonjë të drejtë të tanishme në lidhje me tokën vijuese.

Në rastet kur prona ishte shkatërruar krejtësisht dhe ku në ngastrën e tokës ishte ngritur objekt kryesisht i ndryshëm (p. sh. ndërtim për qëllime komerciale), HPCC-ja ka bërë të ditur se nga ana ligjore ishte e pamundur që posedimi i pronës së shkatërruar t’i kthehej paraqitësit të kërkesës. Ajo ka konsideruar se në të tilla raste paraqitësi i kërkesës e kishte të drejtën në format e ndihmës që ofroheshin nga sistemi ligjor vendor. Pasi që përcaktimi i këtyre çështjeve dilte jashtë juridiksionit të saj, çështja bartej në gjykatat vendore.

Situata ishte paksa më ndryshe në rastet kur prona ishte shkatërruar pjesërisht kurse pala që përgjigjet e kishte uzurpuar atë në mënyrë të paligjshme duke ndërtuar vendbanim të ri pranë vendbanimit të paraqitësit të kërkesës. Në raste të tilla, HPCC-ja ka konsideruar se pasi që objekti i ri në ngastrën e tokës ishte objekt banimi që nuk ishte e pakrahasueshme në pajtim me qëllimin e tij apo ndryshe me objektin që ka ekzistuar më parë në ngastrën e

tokës, nuk ekzistonte ndonjë arsye për njohjen e së drejtave të paraqitësit të kërkesës sipas neneve 2.5 dhe 2.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60. Në rrethana të tilla, ka aprovuar urdhrin për rikthimin e posedimit të ngastrës tokësore si dhe objektit që gjendej në të. Pala që përgjigjet urdhërohej që të lironte pronën brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të urdhrin, kurse në rast dështimi për të bërë këtë, ai apo ajo do të dëbohej nga prona. HPCC-ja ia bartëte kërkesën gjykatës komunale për të përcaktuar ndihmën e duhur në lidhje me koston e ndërtimit të objektit në ngastrën e tokës.

Në rastet kur prona është shkatërruar kurse ngastra e tokës ishte uzurpuar në mënyrë të paligjshme, duke u shfrytëzuar si kopsht apo vend parkim, HPCC-ja përpos aprovimit të urdhrin deklarativ gjithashtu aprovonte urdhrin për riposedim të ngastrës së tokës duke e urdhëruar banuesin e paligjshëm të lirojë pronën atëherë kur paraqitësi i kërkesës kishte të drejtën mbi ngastrën vijuese të tokës.

### ***Bartja e kërkesave në gjykatë***

Në rastet kur HPCC-ja refuzonte kërkesën, mirëpo konstatonte se ajo ngriste çështje të cilat ishin jashtë juridiksionit të saj, kjo çështje e kërkesës bartej në gjykatën vendore kompetente bazuar në autoritetin e saj sipas neneve 2.5 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 dhe 22.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.<sup>226</sup>

Për më tepër, në raste kur ekzistonte falsifikim i qartë i dokumenteve, HPCC-ja gjatë vendosjes mbi kërkesën gjithashtu udhëzonte që çështja të bartej në Zyren e Prokurorit Publik për hetime të mëtutjeshme.

## **6. Përmirësimi i gabimeve administrative gjatë përpunimit të vendimmarrjes**

Në rrethana kur për një kohë shumë të shkurtër përpunohen shumë kërkesa, paraqitja e gabimeve është e pashmangshme. HPCC-ja lëshonte rezoluta me qëllim të përmirësimit të gabimeve administrative apo lëshimeve si dhe defekteve procedurale që shfaqeshin, kryesisht pas shqyrtimit të kërkesave.

Këto janë skenaret kryesore në të cilën janë lëshuar Rezolutat për të përmirësuar gabimet:

---

<sup>226</sup> Çështjet të ngritura zakonisht në kërkesa që ishin jashtë juridiksionit të HPCC-së përfshinin edhe raste kur paraqitësi i kërkesës kërkonte prishjen e kushteve të kontratës duke kërkuar anulimin e kontratës apo rishikimin e marrëveshjes mbi shitjen. Në raste kur HPCC-ja urdhëronte bartjen e kërkesës në gjykatat vendore kompetente, HPD-ja bënte përgatitjet për pranim-dorëzimin e dosjes së kërkesës në gjykatë për ta ndihmuar paraqitësin e kërkesës që gjykata e duhur të përcaktonte çështjen që dilte jashtë juridiksionit të HPCC-së. HPCC-ja udhëzonte se nuk duhet të kërkohej ndonjë veprim apo ndihmë juridike nga HPD-ja apo vet ajo, përveç nëse ekzistonte kërkesë për ndihmë të posaçme nga gjykatat vendore dhe nëse HPD-ja dhe HPCC-ja kishin mundësitë dhe juridiksionin për shqyrtimin e asaj çështjeje.

- kur kërkesat konkurruese për pronën e vetme dhe të njëjtë ishin shqyrtuar ndaras nga njëra tjetra,<sup>227</sup>
- kur zbulohet se pala e dëmtuar nga kërkesa e cila ishte vendosur nga HPCC-ja nuk ishte njoftuar para se të merrej vendimi;
- kur kërkesa ishte kategorizuar drejt gjatë pranimit të kërkesave, por pastaj ishte përgatitur dhe përpunuar gabimisht si kërkesë e kategorisë tjetër;
- kur kërkesa ishte përpunuar gabimisht si procedurë përmbledhëse, kërkesë e pakontestuar duke e rekomanduar HPCC-në që ta aprovojë atë në rastet kur dëshmitë e dosjes jepnin të kundërtën, kurse kërkesa do të ishte dashur përpunuar si e refuzuar;
- kur ndihma e kërkuar nga paraqitësi i kërkesës në kërkesë nuk është shqyrtuar në procesin e marrjes së vendimit;
- kur kërkesa, pas vendimit fillestar, i ishte paraqitur gabimisht HPCC-së për t'u vendosur përsëri në rastet kur HPCC-ja ishte *functus officio* kurse çështjet e ngritura aty ishin *res judicata*.

Në raste të tilla, pas njoftimit të palëve të dëmtuara dhe dhënies së mundësisë për të kundërshtuar, HPCC-ja lëshonte Rezolutë për shfuqizimin e vendimit duke ia kthyer kërkesën HPD-së për hetime shtesë duke e përpunuar dhe riparaqitur atë në pajtim me procedurën adekuate të HPCC-së për shqyrtim. Në rastet e kërkesave konkurruese, kur një kërkesë është vendosur ndaras nga tjetra, Rezoluta udhëzonte që të dy kërkesat të përpunoheshin dhe paraqiteshin së bashku për t'u shqyrtuar nga HPCC-ja.

---

<sup>227</sup> Pasi që HPCC-ja kishte filluar shqyrtimin e kërkesave para datës përfundimtare të pranimit të kërkesave kjo ka shkaktuar që disa kërkesa të vendosen ndaras nga të tjerat të paraqitura për të njëjtën pronë.

## **KAPITULLI 8**

### **NJOFTIMI DHE ZBATIMI I VENDIMEVE TË HPCC-së**

#### **1. Njoftimi për vendimet**

Kopja e vërtetuar e vendimit grupor të HPCC-së dhe vendimi individual i Kryesekretarisë i dërgohej paraqitësit të kërkesës, palës që përgjigjet si dhe palëve tjera të interesuara dhe atë në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe. Me qëllim të kryerjes së njoftimit, Njësi i Informimit i HPD-së kontaktonte palët duke i informuar me rezultatin e vendimit të HPCC-së dhe bënte përgatitjet për dërgimin e vendimit në njërin nga zyrat rajonale të HPD-së. Për shkak të shkaqeve logjistike vendimet nuk dërgoheshin me postë.

Në rastet kur pala që përgjigjet apo uzurpuesi i pronës së kërkuar nuk merrnin pjesë në procedurë, dërgohej kopja e vërtetuar e vendimit grupor të HPCC-së dhe vendimit individual për pronën e kërkuar për të siguruar që të gjitha palët e interesuara të jenë të njoftuara me vendimin.<sup>228</sup>

Rreth 23,146 vendime u ishin dërguar paraqitësve të kërkesave nga ana e HPD-së. Në 1.545 raste dërgimi i vendimeve nuk ka qenë i mundur pasi që paraqitësit e kërkesave nuk kanë mund të kontaktohen apo gjenden.<sup>229</sup> Në 2,546 raste tjera, HPD-ja me sukses i ka njoftuar paraqitësit e kërkesave lidhur me vendimin por ata kanë dështuar që ta pranojnë vendimin, me gjasë për shkak të faktit se kishin hequr dorë nga prona apo nuk ishin më të interesuar për procedurën, apo pasi që prona ishte shkatërruar.

#### **2. Publikimi i vendimeve**

Kryesekretaria e kishte detyrë statutores që të publikojë vendimet e HPCC-së.<sup>230</sup> Lista e kërkesave (përmes numrave DS), ku vendimet ishin aprovuar, publikohej në web faqen e HPD-së dhe kjo listë përditësohej pas seancave të HPCC-së. Vendimet mund të gjendeshin në të gjitha zyrat e HPD-së kurse prej korrikut të vitit 2005 ato mund të gjendeshin edhe në webfaqen e HPD-së, në të trija gjuhët.<sup>231</sup>

---

<sup>228</sup> Ishte përpiluar formulari i njohur si “formulari i pranimit” i cili përmbante numrin e DS të dosjes si dhe të dhënat e palës që përgjigjet apo të banuesit. Formulari, bashkë me kopjen e hartës së pronës, kapeshin me kapëse teli në pliko e cila i dërgohej banuesit aktual apo palës që përgjigjet nga personi i procesimit i HPD-së. Në rast se pala që përgjigjet apo banuesi tentonin t’i shmangeshin pranimit, ky fakt shënohej në formular i cili nënshkruhej nga personi i procesimit dhe vendosej në dosjen e kërkesës.

<sup>229</sup> Në shumicën e këtyre rasteve paraqitësit e kërkesave kishin ndërruar vendbanimin dhe nuk e kishin njoftuar HPD-në për ndërrimin e adresës apo të dhënave kontaktuese. Njoftimet për paraqitësit e kërkesave që nuk kanë mund të gjenden ishin publikuar me të madhe nga HPD-ja përmes fushatave mediale dhe lajmërimeve publike gjatë tërë viteve të veprimtarisë.

<sup>230</sup> Shiko nenin 22.11 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>231</sup> Vendimet mund të gjendeshin në [www.hpdkosovo.org](http://www.hpdkosovo.org). Prej gushtit 2004 mjeti kërkues interaktiv në webfaqen e HPD-së ia mundësonte paraqitësit të kërkesës të përcaktonte statusin e kërkesës, dmth nëse është vendosur për të apo jo.

### 3. Procedura për zbatimin e vendimeve

Duke e ditur faktin se vetëm vendimi për njohjen e së drejtës pronësore nuk ishte i mjaftueshëm në një shoqëri post konfliktuoze për t'ia rikthyer paraqitësve të kërkesave posedimin e pronave, programit për rikthim në mënyrë të qartë i ishte dhënë autoriteti për ekzekutimin dhe sigurimin e plotë të tyre konform vendimeve ligjore të detyrueshme. Procesi gjithashtu u jepte paraqitësve të kërkesave një numër mundësishë për zbatimin e vendimeve. Lidhur me shqyrtimin e problemit të pronave të uzurpuara në mënyrë të paligjshme, HPD-ja ishte autorizuar që të ekzekutojë vendimet përmes lëshimit dhe ekzekutimit të urdhrave për dëbim.<sup>232</sup>

Paraqitësit e suksesshëm të kërkesave të cilët kishin pranuar vendimet për lëndët e kategorisë B si dhe vendimin nga HPD/HPCC-ja ku urdhrohej për regjistrimin e pronësive në regjistrat e caktuara publike ishin ndihmuar nga HPD-ja rreth regjistrimit të së drejtës pronësore.<sup>233</sup> Lidhur me këtë HPD-ja kishte arritur mirëkuptim të përbashkët me Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK) që ishte përgjegjëse për regjistrimin e pronësive në regjistrat pronësor publik. Në bazë të mirëkuptimit të përbashkët AKK-ja ka bërë regjistrimin e të gjitha vendimeve të HPCC-së posa ka pranuar kopjen e vërtetuar të Urdhrit të HPD/HPCC-së, bashkë me kërkesën me shkrim për regjistrim nga ana e HPD-së e edhe nga paraqitësi i kërkesës. Të gjithë paraqitësit e kërkesave që kishin pranuar Urdhra-B ishin njoftuar lidhur me kriteret e kërkuara për t'i paraqitur AKK-së kërkesë me shkrim në kohën e dërgimit të Urdhrit. HPD-ja ia ka përcjellur AKK-së kopjet e vërtetuara të të gjitha Urdhrave-B.

Paraqitësve të kërkesave që kishin pranuar vendime pozitive për lëndët e kategorisë A dhe C, ku urdhrohej rikthimi i së drejtës së tyre pronësore, u takonte e drejta për të zgjedhur njërën nga tri mundësitë për zbatimin e vendimit. Ata mund të kërkonin riposedimin e pronës së kërkuar dhe posa HPD-ja ka pranuar kërkesën e tillë i ka bërë përgatitjet për t'ia dorëzuar pronën paraqitësit të kërkesës. Në anën tjetër, duke e ditur faktin se jo të gjithë paraqitësit e suksesshëm të kërkesave dëshironin të ktheheshin në prona pasi pranonin vendimin, paraqitësit të kërkesës i ishte dhënë mundësia për të kërkuar nga HPD-ja që ta vendosë pronën nën administrim të përkohshëm.

Mundësia e tretë ishte mbyllja e dosjes së kërkesës, që kryesisht zgjedhej nga paraqitësit e kërkesave, të cilët vet kishin gjetur zgjidhje dhe nuk kërkonin më ndihmë nga HPD-ja

---

<sup>232</sup> Neni 13 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 e autorizonte HPD-në që të dëbonte banuesit e paligjshëm kurse procedura e ekzekutimit të urdhërave të dëbimit është shqyrtuar më tutje në këtë kapitull.

<sup>233</sup> Kjo çështje binte nën autoritetin e Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK) në bazë të nenit 3.7 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/22. AKK-ja dhe HPD-ja kishin arritur mirëkuptimin e përbashkët maj të vitit 2005.

lidhur me pronat e tyre, dmth në rastet kur paraqitësit e kërkesave i kishin shitur apo ndryshe kishin hequr dorë vullnetarisht nga prona.<sup>234</sup>

Administrimi dhe riposedimi janë shqyrtuar hollësisht më poshtë. Si metodë e ekzekutimit në rastet kur HPCC-ja urdhëronte kthimin apo riposedimin e të drejtave pronësore varësisht nga zgjedhja e paraqitësit të kërkesës për zbatimin e vendimit, HPD-ja nuk ndërmirte veprime zbatimi derisa paraqitësi i kërkesës e kërkonte një gjë të tillë.<sup>235</sup>

### ***Administrimi***

Pas pranimit të kërkesës me shkrim për vendosjen e pronës nën administrim<sup>236</sup> HPD-ja ishte autorizuar që të marrë posedimin e pronës derisa paraqitësi i kërkesës të kërkonte riposedimin<sup>237</sup> dhe të shfrytëzojë pronën përkohësisht për qëllime strehimi humanitar.<sup>238</sup> Korniza ligjore që udhëhiqte menaxhimin e pronës së vendosur nën administrimin e HPD-së ishte përcaktuar me nenin 12 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 si dhe procedurave të brendshme që ishin pranuar nga HPD-ja për zbatimin e këtij aspekti të mandatit.<sup>239</sup> Në bazë të nenin 12 HPD-ja mund të aprovonte leje të përkohëshme për tu lejuar personave që kishin nevojë për strehim humanitar të drejtën për të banuar në pronë varësisht nga kriteret dhe kushtet të cilësuar si të përshtatshme.<sup>240</sup> Lejet e përkohëshme aprovohehin për periudhë të kufizuar kohore dhe mund të ripërtiheshin pas aplikimit.<sup>241</sup> Gjatë kohës që prona ishte nën administrim, e drejta e paraqitësit të kërkesës për të marrë posedimin e pronës suspendohej<sup>242</sup> me mundësinë për të kërkuar riposedimin kurdoqoftë.<sup>243</sup> Pas pranimit të kërkesës për riposedim HPD-ja dërgonte urdhër për dëbim ku kërkoheshin nga bartësi i përkohëshëm i lejes që të lironte pronën brenda nëntëdhjetë (90)

---

<sup>234</sup> Me pranimin e kërkesës për mbyllje Kryesekretaria përpilonte Memorandumin që theksonte se paraqitësi i kërkesës kishte kërkuar mbylljen, kurse kërkesa bashkë me Memorandumin dhe dosjen e kërkesave dërgohehin në arkivë.

<sup>235</sup> Gjatë periudhës deri në vitin 2003, nuk ishte e domosdoshme që paraqitësi i kërkesës të kërkonte zbatimin e vendimit; HPD-ja me pranimin e vendimit nga HPCC-ja e zbatonte vendimin. Kjo shpiente në vështirësi praktike ku HPD-ja siguronte riposedimin e pronës së kërkuar për paraqitësin e kërkesës kurse paraqitësi i kërkesës nuk dëshironte të kthehej në Kosovë për të marrë posedimin e pronës në atë kohë. Pronat e tilla në shumë raste menjëherë ishin riuzurpuar, plaçkitur apo edhe shkatërruar. Në vitin 2003 kjo shpiti në futjen e procedurës përmes së cilës paraqitësi i kërkesës, pas pranimit të vendimit nga HPCC-ja, duhej të kërkonte zbatimin e vendimit. Për më tepër, paraqitësi i kërkesës mund të zgjidhte prej tri mundësive për zbatimin e vendimit, kryesisht riposedimin e pronës, vendosjen e pronës nën administrimin e HPD-së apo mbylljen e dosjes së kërkesës.

<sup>236</sup> HPD-ja ia ofronte paraqitësit të kërkesës formularin e kërkesës në kohën kur paraqitësit të kërkesës i dërgohej vendimi i HPCC-së.

<sup>237</sup> Shiko nenin 12.2(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>238</sup> Shiko nenin 1.1 (b) të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 dhe nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>239</sup> Neni 12.5 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 parasheh që HPD-ja do të "vendos kriteret për ndarjen e pronave nën administrim mbi baza të përkohshme humanitare".

<sup>240</sup> Shiko nenin 12.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>241</sup> Shiko nenin 12.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>242</sup> Shiko nenin 12.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>243</sup> Shiko nenin 12.7 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

ditësh, ndërsa dështimi për të vepruar në pajtim me këtë kërkesë do të përfundonte me dëbim.<sup>244</sup> Në rast kur ky i fundit dështonte që të vepronte në pajtim me njoftimin, HPD-ja lëshonte urdhër që autorizonte ekzekutimin e urdhërit për dëbim.<sup>245</sup> Posa paraqitësi i kërkesës të merrte riposëdimin e pronës, administrimi i pronës ndërpritej.<sup>246</sup>

### ***Skema mbi qiranë për pronat nën administrim***

Neni 1.1(b) i Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 parashihte vendosjen e skemës mbi qiranë për pronat nën administrim. Të hollat e qirasë për pronën nën administrim duhej të paguheshin në konto të ndarë mirëbesimi për pronarin e ligjshëm, varësisht nga zbritja e shpenzimeve gjegjëse. Skema e tillë mbi qiranë ishte propozuar gjatë gjithë viteve të veprimtarisë së HPD-së kurse ishin paraqitur edhe propozimet për konstuktimin e skemës së tillë. Megjithatë, për shkak të natyrës politikisht të ndjeshme të kësaj çështjeje skema ka gjetur aprovimin nga PSSP-ja tek në prillin e vitit 2006, pas përfshirjes së HPD-së në Agjencinë Kosovare të Pronës. Zbatimi i skemës gjithashtu ishte i kushtëzuar nga marrja e pëlqimit nga IPVQ-ja, i cili ishte aprovuar në gusht të vitit 2006.

Skema u fut në funksion në tetor të vitit 2006. Sipas skemës KPA-ja hynte në marrëveshje mbi qiranë me banuesin si qiraxhi dhe mbledhte qiranë çdo muaj. Në rast të mospagesës së qirasë, pas veprimtimit në përpuethshmëri me procedurat e njoftimit, KPA-ja dëbonte qiraxhiun. KPA-ja ia caktonte qiraxhiut kaparin fillestar pas nënshkrimit të marrëveshjes mbi qiranë që mbulonte qiranë e papaguar apo dëmet e mundshme në pronë. Pjesa e mbetur e kaparit i kthehej qiraxhiut me përfundimin e marrëveshjes së qirasë dhe pas inspektimit të pronës. Çmimi i qirasë ishte caktuar nga KPA-ja në bazë të vlerës tatimore të aplikuar të pronës (siç është përcaktuar nga organet publike dhe kështu që nuk ishte e negociueshme) si dhe ishin marrë parasysh gjendja fizike dhe amortizimi i pronës.

Deri në kohën e shkrimit, skema ishte e mundshme për të gjitha pronat nën administrim ndërsa IPVQ-ja kishte ndërmarrë fushatën reklamuese për shtytje të informimit të publikut me skemën si dhe për të ndihmuar në identifikimin e qiraxhinjëve për pronat e caktuara. Deri në qershor të vitit 2007, diku 2,435 bartës së të drejtës pronësore janë përcaktuar që të fusin pronën në skemë. Gjithashtu janë kryer diku 111 dëbime kundër qiraxhinjëve që kanë dështuar të paguajnë qiranë.

Skema ofron mbrojtje juridike dhe fizike për pronat e braktisura banesore dhe siguron burime minimale të ardhurash nga prona për bartësit e zhvendosur të së drejtës pronësore, të cilët përndryshe do të ndiheshin se nuk kanë zgjidhje tjetër përpos që të shesin shtëpitë e tyre.<sup>247</sup>

---

<sup>244</sup> Shiko nenin 12.7 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>245</sup> Shiko nenin 12.7 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>246</sup> Shiko nenin 12.7 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>247</sup> Statistikat e skemës mbi qiranë mund të gjenden në [www.kpaonline.org](http://www.kpaonline.org)



## ***Riposedimi***

Riposedimi ishte një mundësi për paraqitësit e kërkesave që dëshironin të merrnin posedimin e shtëpive pas pranimit të vendimit nga HPCC-ja. Pas pranimit të kërkesës me shkrim për riposedim HPD-ja siguronte që prona gjatë posedimit të ishte e boshatisur duke ia dorëzuar atë paraqitësit të kërkesës.

## ***Procesimi i kërkesave për administrim dhe riposedim***

Gjatë procesimit të kërkesave për riposedim dhe administrim, zyrtarët e zyrës rajonale të HPD-së fillimisht vizitonin pronën me qëllim të përcaktimit të kushteve të pronës dhe nëse ajo ishte e uzurpuar. Në rast se prona ishte dëmtuar dhe nuk ishte më e banueshme ajo nuk mund të vendosej nën administrim. Në rastet kur prona ishte shkatërruar riposedimi nuk ishte më njëra prej mundësive dhe HPD-ja mund të siguronte vetëm riposedimin e asaj që kishte mbetur në objektin e pronës si dhe ngastrës tokësore mbi të cilën gjendej.

Kur është konstatuar se prona është e banueshme dhe e pazurpuar, në rastet kur paraqitësi i kërkesës ka kërkuar administrimin, prona ishte plumbuar dhe vendosur nën administrim. Kur është kërkuar riposedimi, HPD-ja ia ka dhënë riposedimin e pronës paraqitësit të kërkesës duke bërë përgatitje me të për dorëzimin e çelësave.

Në rast se është konstatuar se prona është e uzurpuar në mënyrë të paligjshme, kopja e vendimit të HPCC-së i është dërguar banuesit duke e urdhëruar ta lirojë pronën brenda tridhjetë (30) ditësh, kurse në rast të dështimit për të bërë këtë do të dëbohej.<sup>248</sup>

Me qëllim të sigurimit që procedurat të jenë të drejta, në këso raste banuesit i jepej mundësia për të paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të vendimit apo për të paraqitur kërkesë për strehim humanitar. Paraqitja e kërkesës për rishqyrtim automatikisht e pezullonte ekzekutimin e urdhërit për dëbim derisa HPCC-ja të vendoste për kërkesën, përveç nëse urdhëronte të kundërtën.<sup>249</sup>

Kërkesat për strehim humanitar duhej të paraqiteshin brenda katërmëdhjetë (14) ditësh pas pranimit të vendimit.<sup>250</sup> Në rastet kur paraqitësi i kërkesës kërkonte administrimin kurse HPD-ja konstatonte se kërkesa e banuesit për ndihmë për strehim ishte bazuar sa

---

<sup>248</sup> Shiko nenin 13.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>249</sup> Shiko nenin 14.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60. Kërkesat për rishqyrtim janë trajtuar në Kapitullin 8 të këtij raporti. HPCC-ja asnjëherë nuk ka urdhëruar ekzekutimin e urdhërit për dëbim nëse kërkesa për rishqyrtim isht në pritje.

<sup>250</sup> Periudha prej katëmbdhjetë (14) ditësh lejonte procesimin e kërkesës para skadimit të afatit prej tridhjetë (30) ditësh. Në rast se HPD-ja konstatonte se kërkesa e banuesit për ndihmë për strehim ishte mirë e bazuar dhe në përputhje me kriterin e saj të brendshëm për aprovimin e ndihmës për strehim pas marrjes së pronës nën administrim ajo mund t'ia aprovonte banuesit lejen e përkohshme për të banuar në pronë sipas dispozitave të nenit 12 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60. Në rastet kur kërkohej riposedimi banuesit që kishte aplikuar dhe që i përmbushte kriteret për strehim humanitar i rindahej një pronë alternative e mundshme që veç ishte nën administrimin e HPD-së.

duhet, ku ai apo ajo demonstronte nevojën e vërtetë,<sup>251</sup> pas marrjes së pronës nën administrim ajo mund t'ia aprovonte banuesit lejen e përkohshme për të jetuar aty.<sup>252</sup> Në rast kur paraqitësi i kërkesës kërkonte riposedim, kushti i banuesit për strehim humanitar varej jo vetëm nga kriteri i së drejtës juridike por edhe nga mundësia e shfrytëzimit të pronave të përshtatshme alternative, pasi që ofrimi i diçkaje ndryshe nga kjo në këto raste në të vërtetë *de facto* do të paraqiste pengesë për kthimin.

Derisa HPD-së i është dhënë liria e veprimit në bazë të Rregullores 2000/60 për të shtyrë ekzekutimin e urdhërit për dëbim deri në 6 muaj, varësisht nga zgjidhja e nevojave për strehim të banuesit, apo sipas rrethanave të caktuara e ka parë të udhës të bëjë një gjë të tillë, kjo ishte një liri veprimi që shfrytëzohej shumë rrallë, pasi që ishte në kundërshtim me të drejtat e bartësit të ligjshëm të së drejtës pronësore për riposedim dhe gëzim të së drejtave pronësore të tij/saj.<sup>253</sup>

### ***Ekzekutimi i urdhërave për dëbim***

Në raste kur banuesi dështonte që të lironte pronën dhe nuk kërkonte strehim humanitar apo rishqyrtim të vendimit të HPCC-së, apo nëse këto kërkesa pastaj ishin refuzuar, urdhëri për dëbim ishte zbatuar kurse lëshohej urdhëri nga Kryesekretaria që autorizonte ekzekutimin i cili përcaktonte hollësitë vijuese:

- (i) numrin dhe datën e vendimit të HPCC-së që urdhëron dëbimin;
- (ii) numrin e kërkesës;
- (iii) numrin e urdhërit;
- (iv) emrat e palëve në kërkesë;
- (v) adresën e pronës;
- (vi) data e dërgimit të vendimit palës që do të dëbohet;
- (vii) data e lëshimit;
- (viii) nënshkrimin e Kryesekretarisë;
- (ix) vulën e HPCC-së; dhe
- (x) pjesën për nënshkrim dhe shënim të hapave të ndërmarra sipas urdhërit nga zyrtari për ekzekutim.<sup>254</sup>

HPD-së i kërkohej që të njoftonte paraqitësit e kërkesave me datën e saktë të dëbimit dhe të bënte përgatitje për dorëzimin e çelësave të pronës.<sup>255</sup> Vendimet zbatoheshin kurse zyrtarët e HPD-së kryenin dëbimet me ndihmën e organeve për zbatimin e ligjit.<sup>256</sup>

<sup>251</sup> Kjo ishte në pajtim me kriterin e saj të brendshëm për aprovimin e ndihmës për strehim.

<sup>252</sup> Shiko nenin 12 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>253</sup> Shiko nenin 13.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60. Në praktikë shtyerja ishte e lejueshme vetëm në rastet kur prona vet banuesit ishte e uzurpuar në mënyrë të paligjshme kurse ai apo ajo kishte paraqitur kërkesë pranë HPD-së e cila ende ishte në pritje. Në raste të tilla dëbimi lihej në pritje të gjetjes së mundësisë së strehimit të përshtatshëm alternativ dhe pa prejudikim të rezultatit të kërkesës.

<sup>254</sup> Urdhëri lëshohej në bazë të nenit 13.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 po ashtu shiko nenin 6 të Rregullave shtesë të HPCC-së të bashkangjitura në Shtojcën III që elaboron mbi procedurat për zbatimin e urdhërave për dëbim.

<sup>255</sup> Shiko nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

Gjatë ekzekutimit të urdhërit për dëbim, zyrtarët e HPD-së duhej të posedonin urdhërin e nënshkruar për dëbim që autorizon ekzekutimin e urdhërit.<sup>257</sup> Urdhëri për dëbim ishte i ekzekutueshëm për çdo palë që banonte në pronë në kohën e ekzekutimit<sup>258</sup> dhe gjatë ekzekutimit, çdo palë që dështonte në përmbushjen e udhëzimit të lëshuar nga zyrtarët e HPD-së, ku kërkohet nga ai apo ajo që të lëshojë objektin, mund të largohet nga organet për zbatimin e ligjit.<sup>259</sup> Pas dëbimit, prona plumbohej<sup>260</sup> dhe kryheshin përgatitjet për vendosjen e pronës nën administrim apo për të siguruar riposedimin në pajtim me kërkesën e paraqitësit të kërkesës për implementimin e vendimit. Procedurë e ngjashme ishte zhvilluar për dëbimet e ndërmarra në dobi të paraqitësve të cilët fillimisht kishin zgjedhur për vendosjen e pronës nën administrimin e HPD-së dhe pastaj kishin kërkuar riposedimin e pronës, në rastet kur bartësi që kishte lejen e përkohshme dështonte të lironte pronën si dhe të vepronte në pajtim me periudhën statutores të njoftimit.<sup>261</sup>

### Statistikat mbi implementimin

Rreth 28,716 kërkesa për prona banimi janë zbatuar me sukses (98.5%), kurse 5,080 paraqitës të kërkesave kanë zgjedhur për riposedimin e pronës derisa 3,419 kanë kërkuar që pronën ta vendosin nën administrim të HPD-së. Rreth 2,207 kanë kërkuar mbylljen e kërkesës pas pranimit të vendimit të HPCC-së.

Shqetësimet lidhur me sigurinë dhe mjedisin politik e po ashtu edhe me negociatat që janë në vazhdim për statusin, duket se kanë ndikuar me të madhe në pozitën e bashkësive minoritare duke ndikuar në zgjedhjen e formës së zbatimit të vendimit. Duket se kjo i ka sjellur në pozicionin “të presim dhe të shohim” disa prej personave të zhvendosur<sup>262</sup> pasi që numri i përgjithshëm i paraqitësve të kërkesave që kërkojnë administrim ishte i lartë,

---

<sup>256</sup> Shiko nenin 13.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60. Fillimisht mbështetja ishte ofruar nga oficerët ndërkombëtarë të policisë (policisë së UNMIK-ut) si dhe pranisë ushtarake të NATO-së (KFOR), por kjo përgjegjësi gradualisht dhe me sukses i ishte bartur Shërbimit vendor të Policisë së Kosovës (“SHPK”) sipas udhëzimeve të policisë së UNMIK-ut. Kjo e fundit siguronte që SHPK-ja me besueshmëri të ndihmonte në kryerjen e dëbimeve, duke ndërmarrë veprime të duhura ligjore ndaj atyre që tentonin të pengonin dëbimet e ligjshme, pa marrë parasyshë përkatësinë etnike apo pikëpamjet politike.

<sup>257</sup> Shiko nenin 13.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>258</sup> Shiko nenin 13.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>259</sup> Shiko nenin 13.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>260</sup> Njësi për zbatim ka fotografuar pronën e kërkuar, ka regjistruar numrin e koordinatave me ndihmën e teknologjisë GPS dhe ka përpiluar raportin ku paraqitet gjendja e pronës.

<sup>261</sup> Megjithatë, keni parasysh se neni 12.7 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 udhëzon që procedura të aplikohet nëse paraqitësi i kërkesës të ketë kërkuar riposedimin e pronës që ishte nën administrim të HPD-së.

<sup>262</sup> Shiko gjendjen e përditësuar të UNHCR-së mbi nevojat për mbrojtjen e vazhdueshme ndërkombëtare të individëve nga Kosova, qershor 2006. Shiko gjithashtu Komisionin Evropian, Kosovë (sipas RKSKB 1244) 2005 Raporti i Progresit, Bruksel, 9 nëntor 2005, SEC (2005) 1423, neni 1.2 Të Drejtat e Pakicave; Raporti i Agjencisë Evropiane për Rindërtim (AER) të titulluar ‘Vlerësimet e gjendjes së komuniteteve dhe të të kthyerëve në Kosovë’, shkurt 2006. Keni parasysh po ashtu raportin e Sekretarit të Përgjithshëm në Këshillin e Sigurimit në janar 2006, nëntor 2006 dhe mars 2007, S/2007/134 që po ashtu e konfirmon një gjë të tillë.

nëse krahasohet me ata që janë kthyer për të marrë riposedimin fizik të shtëpive në Kosovë.

Derisa del jashtë veprimtarisë së saj, HPCC-ja është e shqetësuar se në disa zona paraqitësit e kërkesave ndihen se ende nuk mund të kthehen dhe të rifillojnë të banojnë në pronat që ua ka kthyer HPCC-ja.

Në lidhje me zbatimin të kompensimit, dispozitat e parashikuara sipas Nenit 4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60<sup>263</sup>, vëmendje e posaqme iu është dhënë vendosja e legjislacionit dhe procedurave në implementimin e nenit 4. Në gusht 2005 HPD/HPCC ka përpiluar legjislacionin e nevojshëm në implementimin e skemës së kompenzimit. Aprovimi për implementimin e saj erdhi me shpalljen e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale në tetor 2006, e cila është dashur të kryhet nën mbrojtjen e Agjencisë Kosovare të Pronës. Neni 19 i Rregullores parasheh që skema implementohet *“në pajtueshmëri me kriterët dhe procedurat të miratuara nga Agjencia Kosovare e Pronës për qarkullim të shumavetë paraqitura në nenin 4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.”* Në bazë të Rregullores së UNMIK-ut ka 258 kërkesa të cilat janë në pritje për implementim dhe momentalisht HPD është duke i finalizuar procedurat për implementim të skemës.

---

<sup>263</sup> E shqyrtuar në detaje në Kapitullin 6 të këtij Raporti

## KAPITULLI 9

### KERKESAT RISHQYRTYESE

#### 1. Procedurat dhe Arsyet për paraqitjen e Kërkesave për Rishqyrtim

Neni 2.6 i Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 kërkonin kërkojnë që rregulat e dëshmisë dhe të procedurës së HPCC-së të lejuar për rishikim apo rishqyrtim të vendimeve të saja. Në pajtueshmëri me vijën e parashikuar me statut, neni 14 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 të lejuar për rishqyrtim të vendimeve pas prezantimit të dëshmive relevante ligjore që nuk është shqyrtuar nga HPCC fillimisht në vendosjen e kërkesës, apo nëse ka pasur gabim material në aplikim të dispozitave të Rregullores.<sup>264</sup> Rregulla 5 e Rregullave Shtesë të HPCC-së gjithashtu përcaktoi procedurën për kërkesa të tilla të përpunimit.

Kërkesa rishqyrtuese mund të paraqitet nga pala në procedurë, apo ndonjë palë tjetër e interesuar e cila ka deklaruar interes ligjor në pronën e kërkuar dhe mund të tregonte arsye të mirë sa i përket arsyes se pse ai apo ajo nuk ka marrë pjesë në procedurë të shkallës së parë.<sup>265</sup> Derisa vetëm personat fizik mund të paraqisnin kërkesa në HPD, ishte e hapur gjithashtu edhe për persona juridik të paraqesin kërkesë për rishqyrtim; HPCC bazuar në referencën në nenin 14.2 të Rregullores “çdo palë e interesuar” përfshirë të dy personat fizik dhe juridik.<sup>266</sup>

Nga pala në kërkesë kërkohej të paraqiste kërkesë për rishqyrtim të vendimit të HPCC-së brenda (30) tridhjetë ditëve nga data e njoftimit të vendimit.<sup>267</sup> Personi i interesuar, i cili nuk ka qenë palë në kërkesë, kërkohej të paraqiste një kërkesë brenda tridhjetë (30) ditëve të njoftimit mbi vendimin, por jo më vonë se një vit nga data e vendimit.<sup>268</sup> Sidoqoftë, kërkesat për rishqyrtim të paraqitura jashtë periudhës kohore të parashikuar me statut, mund të pranohej nëse HPCC konstatonte që ka pasur arsye të mirë për të bërë kështu dhe ajo nuk ka prejudikuar në aspektin material të drejtat e

---

<sup>264</sup> Kërkesat për rishqyrtim është e nevojshme të paraqitet me shkrim dhe të përcaktojë:

- (i) detajet e personit i cili kërkon rishqyrtimin e vendimit të HPCC-së dhe palëve të tjera të interesuara;
- (ii) detajet e pronës me fjalë;
- (iii) arsyet e kërkesës;
- (iv) dëshmia me të cilën nuk është shqyrtuar nga HPCC;
- (v) arsyet se pse dëshmia nuk është paraqitur HPCC-së, në rast të kërkesës të përcaktuar në nenin 14(1)(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60; apo
- (vi) arsyet me të cilat ajo ishte pohuar që HPCC kishte gabuar, në rastin e kërkesës të përcaktuar në nenin 14(1)(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60;

<sup>265</sup> Shih nenin 14 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>266</sup> Në bazë të vendimeve të HPCC-së, HPCC/REC/43/2005 të paragrafit 5 (j) dhe HPCC/REC/53/2005 në paragrafin 3.

<sup>267</sup> Shih nenin 14.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60

<sup>268</sup> Shih nenin 14.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

ndonjë pale. Autorizimi për miratimin e një qasje të tillë duhet të gjindej në nenin 19.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 e cila parashihte që:

*“Komisioni mundet, në rastet specifike, të vazhdojë përkundër mos përmbushjes me ndonjë rregull të procedurës nga ndonjë palë apo nga Drejtorati në interes të administrimit efikas të drejtësisë, nëse ka arsye të mirë për të bërë kështu dhe kjo nuk do të prejudikonte në aspektin material të drejtat e ndonjë pale.”*

HPCC pranoi kërkesat e vona të cilat ngritnin çështjet ligjore substanciale, jep që procedura rishqyrtuese ka paraqitur rastin përfundimtar për palën për të marrë pjesë në proces dhe kundërshtim të vendimit. Sidoqoftë, kërkesa për Rishqyrtim ishte paraqitur nga pala e cila është njoftuar me procedurë të shkallës së parë, dhe ka zgjedhur që të mos marrë pjesë në procedurë dhe ka dështuar të përcaktoj arsyet për mospjesmarrje të tij apo saj, kërkesa ishte refuzuar ku HPCC ka konsideruar që nuk ka pasur arsye të mirë në kuptim të nenit 19.6 të Rregullores për të shqyrtuar atë.

Paraqitja e kërkesës për rishqyrtim ka ndalur ekzekutimin e ndonjë urdhër dëbimi në pritje nga koha e paraqitjes të kërkesës deri në vendosje të saj, apo përndryshe deri në vendosje të HPCC-së.<sup>269</sup>

## 2. Përpunimi i Kërkesa për Rishqyrtim

Në momentin që HPD merrte kërkesën për rishqyrtim të vendimit, ajo regjistron dhe dërgohej në përpunim. Kërkesat përpunoheshin në të gjitha rastet nga juristë të ndryshëm, nga ata të cilët kanë përpunuar kërkesat në shkallë të parë. HPCC theksoi rëndësinë e kësaj qasje kështu që të garantoj paanësinë dhe drejtësinë e procedurës, kështu që nuk ka pasur rast për të pasur një vendim të kërkesës për rishqyrtim e shqyrtuar apo e kërkuar.

Kërkesat për rishqyrtim janë paketuara në këto kategori vijuese për përpunim:

- (i) Kërkesa për Rishqyrtim me meritë, d.m.th. ato në të cilën pala kërkuuese ka paraqitur dëshmi e cila kishte potencial për të ndryshuar rezultatin e vendimit fillestar të HPCC-së;
- (ii) Kërkesat për rishqyrtim pa meritë, d.m.th. në të cilat dokumentet shtesë apo faktet juridike të paraqitura nga pala kërkuuese ishin irelevante në kërkesë dhe nuk do të ndryshonin rezultatin e vendimit të HPCC-së;
- (iii) Kërkesat për rishqyrtim të cilat janë qartazi pa meritë, që d.m.th. ato në të cilën kërkesa nuk ishte e bazuar në faktet apo dëshminë juridike shtesë;
- (iv) Kërkesat e dyta apo tjera paraqiten në konflikt me dispozitën që vendimi i HPCC-së në kërkesën e parë për rishqyrtim është përfundimtare dhe detyruese;<sup>270</sup>

<sup>269</sup> Shih nenin 14.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60. HPCC kurrë nuk ka vendosur në rastin e kundërt.

<sup>270</sup> Udhëzimet në detaje mbi përpunimin e kërkesave janë ofruar nga HPCC në udhëzimet e saja të HPD-së, në veqanti udhëzimet e HPCC-së, seanca e 28, shkurt 2005. Shih gjithashtu nenin 5 të Rregullave Shtesë të HPCC-së të bashkangjitura në aneksin III.

Kërkesat për rishqyrtim që binin në kategoritë (i) dhe (ii) janë përpunuar dhe drejtuar HPCC-së për vendim.

Kërkesa për Rishqyrtim nuk ishte paraqitur pa meritë ku pala kërkuese ka paraqitur dokumente të reja lidhur me kërkesën apo pronën e kërkuar dhe ka dhënë një arsyetim ligjor lidhur me kërkesën; në raste të tilla kërkesa bie ose në kategoritë (i) apo (ii). Në rastet e dyshimit, HPCC udhëzoi që HPD të konsultohet me Komisionerin vendor i cili ishte i deleguar me autorizim të këshillojë në gjëra të tilla.<sup>264</sup>

Lidhur me kërkesat të cilat bien brenda kategorisë (iv), kërkesa ishte refuzuar me një letër të lëshuar dhe të nënshkruar nga Drejtori Ekzekutiv i HPD-së.<sup>265</sup> Përfundimet e vetme ishin ku ishte konstatuar që atje ka pasur një gabim nga HPD në procesim të kërkesës, në të cilin rast, vendimi i parë për rishqyrtim ishte vënë mënjanë nga rezoluta.

Aty ku paraqitësi i kërkesës ka kërkuar rishqyrtim të vendimit të HPCC, duke refuzuar kërkesën mbi baza që dokumentet janë mbështetur pasi që nuk ishin të vërteta, dokumentet duhej të paraqiteshin për verifikim shtesë.<sup>266</sup>

Me qëllim të arritjes së pëlqimit me përpunim të lëndës dhe drejtësisë së procedurës në procesimin e kërkesave për rishqyrtim, ku pala kërkuese ka paraqitur dëshmi e cila nuk është shqyrtuar nga HPCC, kur fillimisht ka vendosur rastin, pala tjetër në kërkesë ishte njoftuar rreth këtij fakti. Udhëzimet ligjore të HPCC-së për procesim të kërkesave për rishqyrtim kërkuar që ai apo ajo të paiset me një kopje të kërkesës dhe çdo dokument i paraqitur për të mbështetur atë, dhe iu dha rasti të përgjigjet me anë të parashtrësës me shkrim dhe paraqitjes së dëshmisë të mëtutjeshme dokumentuese.

Pasi që të kryhet hetimi i kërkesës, parashtrësat ligjore së bashku me konkludimet dhe rekomandimet në cilësitë e kërkesës janë përgaditur në një dokument, i njohur si “Raport i Procesimit të Kërkesave në Kërkesën Rishqyrtuese”. Ky raport së bashku me një kopje të raportit original duke paraqitur kërkesën HPCC-së, vendimi i shkallës së parë në kërkesë dhe parashtrësat e palëve dhe dëshmia u janë paraqitur HPCC-së për vendim.

### **3. Numri dhe Natyra e Kërkesave për Rishqyrtim të paraqitura në HPD**

HPD ka pranuar një numër të përgjithshëm të kërkesave prej 4,474 për rishqyrtim të vendimeve të HPCC-së. Pasi që në kohën e të shkruarit HPCC kishte vendosur të gjitha kërkesat, prej të cilave 1,069 (23,90%) janë aprovuar dhe 3,405 (76.10%) janë refuzuar. Numri i kërkesave të aprovuara arriti në 0.42% të të gjitha vendimeve të lëshuara nga HPCC.

---

<sup>264</sup> Udhëzimet e HPCC-së, Seanca e 27, dhjetor 2004.

<sup>265</sup> 439 kërkesa janë refuzuar nga Drejtori Ekzekutiv i HPD-së.

<sup>266</sup> Udhëzimet e HPCC-së, Seanca e 36, Korrik 2006 dhe 37, shtator 2006.

Në shumicën dërmuese të rasteve pala kërkuese nuk ka paraqitur dëshmi relevante ligjore e cila nuk ishte shqyrtuar nga HPCC, kur ajo fillimisht ka vendosur kërkesën, e as nuk ka pasur ndonjë paraqitje të gabimit material në kërkesë të Rregullores. Shumica e kërkesave janë bazuar në rrethanat personale të palëve kërkuese, apo në bazë të arsyeve të tjera që janë mbajtur nga HPCC të jenë irelevante në përcaktimin e kontestit të pronës. Një numër i kërkesave janë refuzuar ku dëshmia e re është paraqitur nga pala që nuk është shqyrtuar nga HPCC në shkallë të parë, por ishte konstatuar mos të ndryshojë korrektësinë e konstatimeve të mëhershme të saj lidhur me kërkesën. Kërkesat për Rishqyrtim gjithashtu janë refuzuar ku dëshmia në të cilën kërkesa është bazuar është konstatuar të mos jetë *prima facie* e vërtetë dhe kështu mungonte vlera dëshmuese.

Lidhur me parashtresën e dëshmisë relevante ligjore, e cila nuk ishte shqyrtuar nga HPCC në vendosjen e kërkesës, HPCC duke interpretuar nenin 14.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 përcaktoi që dëshmia e paraqitur duhet të ketë ekzistuar apo duhet të ketë lidhur ngjarjet që kanë ndodhur në kohën e vendimit fillestar të HPCC-së. Sa i përket ngjarjeve që kanë ndodhur pastaj, HPCC mbajti që derisa një dëshmi e tillë mund të ndikonte në ekzekutimin e vendimit, ajo nuk paraqiste dëshmi të re që nuk është shqyrtuar nga ajo në vendosjen e kërkesës, dhe për këtë qëllim nuk mund të formonte bazë për ndryshimin e vendimit të mëhershëm.

Ishte e hapur për HPCC-në ose të aprovojë kërkesën ose të refuzojë atë dhe të konfirmojë vendimin e saj të mëhershëm.<sup>267</sup> Ajo do të mund të paraqiste gjithashtu qështje të cilat dalin apo që janë të lidhura me kërkesën, i cili nuk ka qenë brenda jurisdiksionit të gjykatës në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2006/60, nenit 22.1.

Lëshimi dhe dorëzimi i vendimit mbi kërkesat mbi shqyrtim kanë përcjellur procedurë të ngjashme sikurse ajo që është aplikuar në vendimet e shkallës së parë. HPCC ishte i autorizuar të lëshojë Vendime Grupore sa i përket numrit të lartë të kërkesave dhe Kryesekretarit pas kësaj përgaditi një vendim të veçuar në lidhje me çdo kërkesë për rishqyrtim. Vendimi Grupor dhe vendimi i veçuar më pastaj iu janë dorëzuar palëve.<sup>268</sup>

---

<sup>267</sup> Shih nenin 25.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

<sup>268</sup> Procedurat të cilat janë aplikuar në dorëzimin e vendimeve të HPD-së mbi kërkesat rishqyrtuese janë të ngjashme me ato të cilat janë aplikuar në dorëzimin e vendimeve të shkallës së parë, të shqyrtuara më herët në Kapitullin 8 të këtij Raporti.



## KAPITULLI 10

### VËREJTJET PËRFUNDIMTARE

Procesi i HPCC-së me efikasitet e ka implementuar mandatin e vet duke i zgjidhur diku rreth 29.000 kërkesa për prona banimi. Kjo e arritur u ka ndihmuar bartësve të shpronësuar të së drejtës pronësore të fitojnë riposëdimitin e shtëpive të tyre dhe, shpresohet, ka ndihmuar në ndërtimin e paqes si dhe në rehabilitim pas konfliktit në Kosovë.

Themelimi i HPCC-së dëshmon njohjen në rritje të faktit se zgjidhja e çështjeve lidhur me të drejtat pronësore është pjesë kryesore e përpjekjeve për ndërtimin e paqes dhe e domosdoshme për ringjalljen ekonomike dhe stabilitetin e përpjekjeve për ndërtimin e paqes. Edhe me më rëndësi, është se kjo tregon vullnetin e bashkësisë ndërkombëtare për t'u angazhuar aktivisht në sigurimin e zbatimit të mjeteve ligjore për kthim si pjesë përbërëse e rindërtimit dhe rehabilitimit pas konfliktit.

Qasja ndaj zgjidhjes së çështjeve pronësore banesore në Kosovë ka qenë e suksesshme. Sidoqoftë, qasja më gjithëpërfshirëse në shqyrtimin e çështjeve pronësore qysh në fillim të misionit do të kishte mundësuar shqyrtimin efektiv të sfidave të tjera ligjore dhe të drejtave pronësore urgjente, janë adresuar gjithashtu me efikasitet.

Derisa vet sfida sa më e hershëm i çështjeve në sferën e pronave të banimit është pjesë kyçe në ndërtimin e paqes. Fatkeqësisht nuk janë ndërmarrë iniciativa të ngjashme për të shqyrtuar sfidat tjera për të drejtat pronësore urgjente, siç janë zgjidhja e kontesteve lidhur me pronat jo banesore. Fatmirësisht tani kjo po adresohet.

Duhet të ofrohen mjete ligjore adekuate të barabarta për të gjithë paraqitësit e kërkesave, të cilët mund të vërtetojnë të drejta pronësore valide. Në rastet e kërkesave valide konkurrese të kategorisë A (humbja diskriminuese e së drejtës së banimit para vitit 1989) dhe kërkesave të kategorisë C (të drejtat mbi pronësinë apo të drejtat e posedimit të fituara pas vitit 1989), ku paraqitësi i kërkesës të kategorisë C kishte më pak se të drejtë të pronësisë mbi pronën, të drejtat pronësore të paraqitësve të kategorisë C i ishin nënshtruar të drejtave të bartësve të së drejtës banesore para vitit 1989 në kthim. Vetëm ata paraqitës të kërkesave C të cilët i kanë privatizuar të drejtat pronësore të tyre, pra në këtë mënyrë duke fituar të drejtën e pronësisë mbi pronën, e kishin të drejtën për kompensim ku kthimi në lloj i ishte dhënë paraqitësit A, kështu që, bartësit e të drejtave pronësore me të drejta më të pakta kanë humbur pasi që të drejtat banesore të para luftës kanë triumfuar mbi të drejtat e tyre.

Regjimi i kthimit gjithashtu nuk ka ofruar mjet ligjor për paraqitësit e kërkesave të kategorisë A me më pak se të drejta të banimit të përfeksionuara, shumë kanë qenë në uzurpim për periudha të gjata kohore, kanë kontribuar në ndërtim të apartamenteve dhe duke humbur posedimin si rezultat i diskriminimit, shkarkimit nga vendet e tyre të punës.

Në raste të tilla paraqitësi i kërkesës së kategorisë A ka humbur kurse e drejta e riposedimit ishte njohur në dobi të paraqitësve të kërkesave të kategorisë C të cilët gëzonin të drejta juridike mbi prona para 24 marsit 1999. Paraqitësve të kërkesave të kategorisë A të cilët kanë dështuar që të përfundojnë të gjitha fazat e nevojshme për kryerjen e së drejtës banesore, ende u duhet të kërkojnë mjete ligjore përmes sistemit gjyqësor i cili veç është i mbingarkuar dhe i mbushur me punë të papërfunduara dhe kufizime burimesh.<sup>269</sup>

Kompenzimi me të holla do të kishte qenë zgjidhje në këto raste, por deri më tani, nuk është përcaktuar ndonjë skemë mbi kompenzimin. HPCC-ja ka theksuar këtë çështje dhe ka propozuar kompenzimin si zgjidhje. Ajo i është drejtuar UNMIK-ut që të marrë hapat e nevojshëm përmes përmirësimeve legjislative për shqyrtimin e kësaj çështjeje. Deri më tani nuk është ndërmarrë. Po të ishte sajuar skema, vemendje do të duhej të i jepej kompenzimit të paraqitësve të kërkesave të kategorisë C të cilët nuk kanë mundur të kryejnë të drejtën e tyre apo të drejtën mbi qiranë sepse apartamentet të cilët iu kanë ndarë atyre ishin ende në ndërtim e sipër kur filloi konflikti në vitin 1999.

Një e metë tjetër e procesit të HPD/HPCC-së është dështimi për të ofruar mjete ligjore adekuate për pothuajse 11.000 paraqitës të kërkesave, pronat e të cilëve janë konstatuar të jenë shkatërruar. HPCC-ja nuk e kishte juridiksionin që të japë kompenzim për dëmet e bëra apo shkatërrimin e pronës. Mjeti i vetëm ligjor të cilin ka mund të ofrojë Komisioni ishte vendimi i njohur si “urdhër deklarativ” i cili paraqitësve të kërkesave ua njihte të drejtat pronësore mbi pronën në kohën e shkatërrimit të saj. Paraqitësi i kërkesës ka mundur të shfrytëzojë urdhrin deklarativ në procedurat gjyqësore për të kontestuar uzurpim të ardhshëm të paligjshëm të ngastrës tokësore ku gjendej prona e banimit apo si dëshmi e së drejtës pronësore ku paraqitësi i kërkesës kërkonte që të përfitojë në të ardhmen përmes ndonjë projekti për rindërtim apo skemë mbi kompenzimin. Procesi në raste të tilla nuk u ka lënë paraqitësve të kërkesave zgjidhje tjetër veç se të paraqesin kërkesa për kompenzim në gjykatat vendore, mundësi e cila në të shumtën e rasteve ka qenë e pamundur për tu realizuar. Derisa ndihma për rindërtim ishte ofruar nga donatorë të ndryshëm pas vitit 1999, shumica e bartësve të së drejtës pronësore nuk kanë mundur të përfitojnë nga kjo ndihmë, kryesisht për tu kthyer në Kosovë gjatë procesit të rindërtimit.<sup>270</sup> Pastaj shuma e fondacioneve që do të nevojitej për rindërtimin e pothuajse 11,000 shtëpive e kalon tejmasë fondin që ekziston në kohën e shkrimit të destinuar për projekte rindërtimi në Kosovë. Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Sigurimit i nëntorit 2006 ka theksuar se ka mungesë për 20 milion euro në fonde që ka ndikim në projektet e kthimit.<sup>271</sup>

Regjimet e ardhme të kthimit të pronave në situata post konfliktuale duhet të kenë parasysh kompenzimin në rastet kur kthimi në lloj nuk është më i mundshëm, pa marrë

---

<sup>269</sup> Sa i përket kapacitetit të gjykatave në përgjithësi në Kosovë, shiko më tutje Raportet Periodike të Misionit të OSBE-së në Kosovë mbi Sistemin e Drejtësisë në [www.oscmissioninkosovo.org](http://www.oscmissioninkosovo.org).

<sup>270</sup> Sa i përket fondacioneve të projekteve të rindërtimit shikoni Raportin e AER-it, op. cit. Shënimin 142 në faqen 31. Shikoni edhe Doracakun për rindërtim të AER-it që mund të gjendet në <http://www.eur.europa.eu/kosovo/kosovo/htm>.

<sup>271</sup> S/2006/906, 20 nëntor 2006 në faqen 5.

parasysh faktin nëse të drejtat e caktuara pronësore mbizotërojnë apo zëvendësojnë të tjerat apo në rastet kur shtëpitë janë shkatërruar. Kjo është qenësore për të siguruar që procesi i kthimit njeh dhe mbron të drejtat pronësore të fituara në mënyrë ligjore të të gjithë paraqitësve të kërkesave duke ofruar drejtësi të kthimit në mënyrë të barabartë për ata që është konstatuar se kanë përjetuar shkelje të të drejtave pronësore.

Politikat mbi Kthimin e Pronave Banesore për Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur <sup>272</sup>njohin që banuesit e dytë të pronave të refugjatëve dhe personave të zhvendosur duhet gjithashtu të kenë të drejtat e tyre të përpunimit të lëndës dhe adresimin e nevojave të tyre banesore. Derisa proceset e HPCC dhe HPD kanë njohur të drejtat e tyre të përpunimit të lëndës dhe disa kanë pushuar, përmes implementimit të mandatit administrativ të pronës së HPD-së, në drejtim të ofrimit të banimit të përkohshëm për persona të tillë, pa dyshim ka më tepër që mbetet të kryhet në dispozitën e strehimit humanitar dhe social në Kosovë.

Në fund, Neni 11 (k) i Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244 (1999) parasheh si një nga përgjegjësitë e tija kryesore të prezencës civile ndërkombëtare që ajo siguron sigurinë dhe kthim të papengueshëm të të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre në Kosovë. Neni 10 parasheh caktimin e kushteve për një jetë të qetë dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës. Ende ka shumë punë për të u kryer lidhur me këtë çështje. Shpresohet që puna e HPCC dhe HPD ka shkuar në drejtim të krijimit të kushteve ku këto qëllime do të mund të arriheshin.

---

<sup>272</sup> Komisioni mbi të Drejtat e Njeriut: Nën-Komisioni mbi Mbështetjen dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut; Raporti final i Raportuesit Special, Paulo Sérgio Pinheiro paraqiti në pajtueshmëri me Nën-Komisionin Rezolutën 2004/2; Politikat Pronësore & Banesore e Kthimit të Refugjatëve dhe Personave të Zhvendosur E/CN4/Sub.2/2005\*\*.

# ANEKSI I

## ANËTARËT E KOMISIONIT PËR KËRKESA PRONËSORE TË KOSOVËS

**Z. Alan Dodson** (Afrika e Jugut) ishte si Kryesues i HPCC-së për një kohëzgjatje prej ekzistimit të tij. Ai kishte diplomuar në Tregti dhe LL.B nga Universiteti i Natalit dhe LL.M. nga Universiteti i Cambridge-it. Ai ka qenë avokat në Gjykatën e Lartë të Afrikës së Jugut nga viti 1985-1995 dhe gjykatës në Gjykatën për Kërkesa të Tokës të Afrikës së Jugut prej vitit 1995-2000. Ai është ish Kryesues i Bordit Këshilldhënës i Pyejeve në Afrikën e Jugut. Si Avokat në Gjykatën e Lartë të Afrikës së Jugut prej vitit 2000, ai specializon në ligjin mbi pronën, ligjin kushtetues dhe ligjin administrativ. Ai është ekspert ndërkombëtar në zgjidhjen e kontesteve pronësore në shoqëritë në tranzicion dhe ka kontribuar në publikimin e të drejtave pronësore, kthimin e pronës, ligjin kushtetues dhe temat e ngjashme.

**Z. Veijo Heiskanen** (Finlandë) ishte anëtar ndërkombëtar i kolegjit të HPCC-së. Ai ka diplomuar në Universitetin e Helsinkut dhe Fakultetin Juridik të Harvardit; Ai ka magjistruar në vitin 1988 dhe ka doktoruar në vitin 1992. Ai ka specializuar në ligjin ndërkombëtar, ligjin arbitrues ekonomik, ligjin mbi tregtinë dhe të internetit. Para pozitës së tij në LALIVE Avokatët në Gjenevë, ka shërbyer si Sekretar i Përgjithshëm dhe Gjykatës i Lartë i Tribunalit për Zgjidhjen e Kërkesave për Llogaritë e Papërdorura në Zvicërr (2001-2002); Drejtor i Institutit Ekonomik Ndërkombëtar Ligjor në Universitetin e Helsinkut (1998-2000); Zëvendës shefi i Shërbimeve Ligjore të Komisionit të KB-së për Kompenzim (1994-1998); dhe Këshilltar Ligjor për Tribunalin e Kërkesave Iran-SHBA në Hagë (1990-1994). Ai ka ligjeruar në institucione të ndryshme, përfshirë Universitetin e Helsinkut dhe në Akademinë e të Drejtës Ndërkombëtare në Hagë, ka qenë profesor vizitues në Universitetin e KB-së në Tokio (1999); ai ka punuar për Komisionin e Arbitrimit të Konferencës Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë (1993); dhe poashtu ishte anëtar i Komitetit Drejtues për Proceset Kolektive të Kërkesave Ndërkombëtare në Gjykatën e Përhershme të Arbitrimit. Ai është autor i disa botimeve mbi të drejtën ndërkombëtare; arbitrimin ndërkombëtar dhe në zgjidhjen e kontesteve.

**Z. Aqif Tuhina** (Kosovë) është anëtar vendor i kolegjit të HPCC-së. Ka diplomuar në vitin 1964 në Universitetin e Beogradit. Para se të filloj si avokat, ka shërbyer si Gjykatës në Kosovë në të dyjat: Gjykatën e Punës dhe në Gjykatën Supreme para se Kosova të humb autonominë në vitin 1989. Së voni ka punuar për Sekretariatit Krahinor të Kosovës për Legjislacion dhe Administratë dhe me Departmentin e UNMIK-ut për Çështje Gjyqësore. Ai është ekspert në patundshmëri dhe në të drejtën penale.

Aneksi II  
**RREGULLORE NR. 1999/23**  
15 nëntor 1999

**PËR THEMELIMIN E DREJTORISË PËR ÇËSHJTE PRONËSORE DHE  
BANESORE DHE KOMISIONIT PËR KËRKESA PRONËSORE DHE BANESORE**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,  
Në përputhje me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë të datës 25 Korrik 1999,

Me qëllim që të arrihen zgjidhje efektive dhe efektive të kërkesave që kanë të bëjnë me çështjet pronësore dhe banesore,

Shpall sa vijon:

**Neni I**  
**DREJTORIA PËR ÇËSHJTJE PRONËSORE DHE BANESORE**

1.1 Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore (“Drejtoria”) merret me drejtimin e të gjitha çështjeve për të drejtat e pronësisë në Kosovë derisa Perfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të vendos se organet e pushtetit vendor janë në gjendje ti kryejnë funksionet që i janë besuar kesaj Drejtorie. Në veçanti Drejtoria do të:

(a) Bëjë inventarin e shtëpive të braktisura në pronësi private, shtetërore dhe shoqërore;

(b) Mbikëqyrë përdorimin ose dhënien përkohësisht me qira të pronave të tilla të braktisura për qëllime humanitare; të ardhurat nga qiraja e pronës së braktisur private dhe shoqërore regjistrohen në një llogari të veçantë në ruajtje për pronarin e vërtetë nga e cila shumë hiqen shpenzimet përkatëse;

(c) Jep udhëzime për UNMIK-un, duke përfshirë CIVPOL-in, UNHCR-in dhe KFOR in për çështje specifike të të drejtave mbi pronën; dhe

(d) Bëjë hulumtime për përcaktimin e politikave dhe legjislacionit të rekomanduar lidhur me të drejtat mbi pronën.

1.2 Si përjashtim nga juridiksioni i gjykatave lokale, Drejtoria merr dhe regjistron kategoritë e mëposhtme të kërkesave që kanë të bëjnë me pronën banesore, duke përfshirë këtu edhe pronën e shoqëruar me të:

(a) Kërkesat e personave fizikë, pronësia, posedimi ose e drejta e banimit në pronën e patundshme banesore të të cilëve u është revokuar pas datës 23 Mars 1989 në bazë të

legjislacionit i cili është diskriminues si në zbatim ashtu edhe në qëllimet e tij;

(b) Kërkesat e personave fizikë që kanë bërë transaksione jozyrtare me prona të patundshme banesore në bazë të vullnetit të lirë të palëve pas datës 23 mars 1989;

(c) Kërkesat e personave fizikë të cilët kanë qenë pronarë, posedues ose që kanë pasur të drejtën e banimit në pronën banesore para datës 24 Mars 1999, e që tani nuk kanë atë pronë në posedim, dhe kur e drejta e pronësisë nuk është transferuar vullnetarisht.

Drejtorja ia paraqet këto kërkesa Komisionit për Kërkesa Pronesore dhe Banesore për zgjidhje ose, nëse e sheh të përshtatshme, kërkon të ndërmjetësojë në këto mosmarrëveshje dhe kur nuk ka sukses, ia drejton ato për zgjidhje Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore.

Neni 2

## **KOMISIONI PËR KËRKESA PRONËSORE DHE BANESORE**

2.1 Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (“Komisioni”) është organ i pavarur i Drejtorisë, i cili i zgjidh mosmarrëveshjet private jotregtare që kanë të bëjnë me pronën banesore të cilat ia parashtron Drejtorja, derisa Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të gjykojë se gjykatat lokale janë në gjendje të kryejnë funksionet që i janë besuar Komisionit.

2.2 Fillimisht Komisioni përbëhet nga një kolegji me dy anëtarë ndërkombëtarë dhe një anëtar vendës, ku të gjithë duhet të jenë ekspertë për legjislacionin banesor dhe pronësor dhe kompetentë për të gjykuar. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm emëron anëtarët e kolegjit dhe cakton një anëtar si kryetar. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të krijojë kolegje të tjera të Komisionit pas konsultimeve me Komisionin.

2.3 Para se të marrin detyrën, anëtarët e Komisionit bëjnë me shkrim këtë deklaratë solemne:

“Si anëtar i Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore deklaroj solemnisht se do ti kryej detyrat dhe do ti ushtroj kompetencat e mia me ndershmëri, besnikëri, paanësi dhe ndërgjegje.”

Deklaratat vendosen në arkivin e Komisionit.

2.4 Komisioni është i autorizuar të kontrollojë lirisht çdo dokument ose të gjitha dokumentet në Kosovë, që kanë të bëjnë me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të paraqitura.

2.5 Si përjashtim nga juridiksioni i gjykatave lokale, Komisioni ka kompetencë ekskluzive për të zgjidhur kategoritë e kërkesave të theksuara në paragrafin 1.2. të kësaj Rregulloreje. Megjithatë, Komisioni mund t’u drejtojë pjesë të veçanta të këtyre kërkesave gjykatave lokale apo ndonjë organi tjetër administrativ, nëse vlerësimi i pjesëve të veçanta të këtyre ankesave nuk kanë të bëjnë me çështjet e parapara në nenin 1.2. Gjatë hetimit ose zgjidhjes së një kërkesë, Komisioni mund të marrë masa të përkohshme mbrojtëse.

2.6 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm percakton me rregullore rregullat e

procedurës dhe të evidencës së Komisionit me rekomandim të Komisionit. Këto rregulla duhet të garantojnë procedura të drejta dhe të paanshme në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Këto rregulla, në veçanti, përfshijnë dispozita për rimarrjen në shqyrtim të vendimeve të Komisionit.

2.7 Vendimet përfundimtare të Komisionit janë të detyrueshme për tu zbatuar dhe nuk janë subjekt i rishqyrtimit nga asnjë organ tjetër gjyqësor apo administrativ në Kosovë.

Neni 3

#### **DREJTORI EKZEKUTIV DHE PERSONELI**

Përfaqesuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm emëron një drejtor ekzekutiv të Drejtorisë pas konsultimeve me drejtorin ekzekutiv të Qendrës së Kombeve të Bashkuara për Sistemimin e Popullsisë (UNCHS) (Habitat). Drejtori ekzekutiv emëron personelin e Drejtorisë ku përfshihen ekspertë lokal dhe cakton punonjës për Komision, të cilët janë nën kontrollin ekskluziv të Komisionit.

Neni 4

#### **LIGJI NË FUQI**

Dispozitat e legjislacionit në fuqi, që kanë të bëjnë me çështjet e të drejtave mbi pronën zbatohen në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 5

#### **HYRJA NË FUQI**

Kjo rregullore hyn në fuqi me 15 nëntor 1999.

***Bernard Kouchner,  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm***

**RREGULLORJA E UNMIK-UT NR. 2000/60**  
**31 tetor 2000**

**MBI KËRKESAT PRONËSORE DHE BANESORE DHE RREGULLAT E  
PROCEDURËS DHE TË PROVAVE TË DREJTORISË PËR ÇËSHTJE  
PRONËSORE DHE BANESORE SI DHE TË KOMISIONIT PËR KËRKESA  
PRONËSORE DHE BANESORE**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën nr. 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë mbi autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë të datës 25 korrik 1999,

Duke përkujtuar Rregulloren nr. 1999/23 të UNMIK-ut mbi themelimin e Drejtorisë për çështje banesore dhe pronësore dhe të Komisionit për kërkesat banesore dhe pronësore, Me qëllim të përpunimit të mëtejme të ligjit që ka të bëjë me pronën banesore në Kosovë dhe të themelimit të Rregullave të procedurës dhe provave të Drejtorisë për çështje banesore dhe pronësore dhe të Komisionit për kërkesat banesore e pronësore,

Shpall sa vijon:

Neni 1  
**PËRKUFIZIMET**

Sipas kësaj rregulloreje,

“Ndërtesë banesore e braktisur” nënkupton çdo pronë, të cilën pronari apo poseduesi ligjor dhe anëtarët e familjes së tij/saj kanë pushuar ta përdorin përkohësisht ose përgjithmonë përveç mungesës së rastësishme dhe e cila është ose e zbrazët ose e zënë në mënyrë joligjore.

“Dhënësi i banesës në shfrytëzim” nënkupton bartësin e së drejtës për ndarjen në shfrytëzim të banesave shoqërore në pajtim me ligjin i cili është aplikuar në atë kohë.

“Pronë e shoqëruar” d.m.th. toka dhe ndërtesat të cilat paraqitësi i kërkesës i zotëron ose shfrytëzon, të cilat formojnë një njësi me pronën banesore.

“Komisioni” d.m.th. Komisioni për kërkesat banesore dhe pronësore i themeluar sipas Rregullores 1999/23 të UNMIK-ut.

“Drejtoria” d.m.th. Drejtoria për çështje pronësore dhe banesore e themeluar sipas Rregullores 1999/23 të UNMIK-ut.

“Diskriminim” d.m.th. çfarëdo dallimi në baza të tilla siç është gjuha, feja, bindja politike ose bindje tjetërfare, prejardhja kombëtare ose etnike, apo shoqërimi me një bashkësi kombëtare,



që ka për qëllim të ndikojë në zhvleftësimin ose dëmtimin e njohjes, gëzimit a të ushtrimit të së drejtës pronësore në baza të barabarta.

“Transaksion jozyrtar” nënkupton çdo transaksion të një prone të paluajtshme, i cili ka qenë joligjor në bazë të dispozitave të Ligjit mbi kushtet e veçanta për qarkullimin e paluajtshmërive (Gazeta zyrtare e RSS 30/89, sipas ndryshimeve me ligjet e publikuara në Gazetën zyrtare të SRS 42/89 dhe 22/91) ose ndonjë ligji tjetër diskriminues, i cili përndryshe do të konsiderohej transaksion i ligjshëm.

“E drejtë e banimit” d.m.th. e drejta për shfrytëzimin e një banese shoqërore sipas kontratës për shfrytëzimin e banesës të përpiluar në bazë të Ligjit mbi marrëdhëniet banesore, ose të Ligjit mbi banesat. Kjo nuk përfshin të drejtën për shfrytëzimin e banesave për qëllime zyrtare (‘banesa shërbimi’) apo banesat e shfrytëzuara si strehim i përkohshëm dhe as dhënien me qira të banesave shoqërore.

“Pronë” d.m.th. çdo shtëpi banimi a banesë, çdo banesë në pronësi shoqërore, si dhe çdo pronë e shoqëruar.

“E drejta në pronë” d.m.th. çdo e drejtë pronësie në pronë, posedim i ligjshëm i saj, e drejtë e shfrytëzimit të saj ose e drejtë e banimit në të.

## **KAPITULLI I: DISPOZITAT THEMELORE**

Neni 2

### **PARIMET E PËRGJITHSHME**

2.1 Çdo e drejtë në pronë, që është fituar në mënyrë të drejtë në pajtim me ligjin në fuqi në kohën e fitimit të saj, mbetet e vlefshme përkundër ndërrimeve në ligjislacionin në fuqi të Kosovës, përveç në ato raste kur kjo Rregullore përcakton ndryshe.

2.2 Çdo person i cili e ka humbur të drejtën në pronë në periudhën ndërmjet datës 23 mars 1989 dhe datës 24 mars 1999 si pasojë e diskriminimit, ka të drejtë për rikthimin e saj në pajtim me këtë Rregullore. Rikthimi mund të jetë në formë të rivendosjes së të drejtës mbi pronën (më poshtë i quajtur: “kthim në lloj”) ose kompensim.

2.3 Çdo transaksion i pronës i bërë ndërmjet datës 23 mars 1989 dhe datës 13 tetor 1999, që ka qenë i paligjshëm në bazë të dispozitave të Ligjit mbi kushtet e veçanta për qarkullimin e paluajtshmërive (Gazeta zyrtare e RSS 30/89, sipas ndryshimeve me ligjet e publikuara në Gazetën zyrtare të RSS nr. 42/89 dhe 22/91) ose të ndonjë ligji tjetër diskriminues, që përndryshe do të ishte qarkullim i ligjshëm, është i vlefshëm.

2.4 Çdo person që ka fituar të drejtën e pronësisë në një pronë nëpërmjet ndonjë transaksioni jozyrtar ndërmjet datës 23 mars 1989 dhe 13 tetor 1999, bazuar në vullnetin e lirë të palëve, ka të drejtë në urdhëresën e Drejtorisë ose të Komisionit për regjistrimin e pronësisë së vet në regjistrat përkatës publikë. Një urdhër i këtillë nuk e liron kërkuesin nga asnjë detyrim për të paguar çfarëdo takse apo tatimi lidhur me pronën ose qarkullimin e pronës.

2.5 Çdo refugjat ose person i zhvendosur, me të drejtë mbi pronën, gëzon të drejtën e

kthimit të pronës ose të disponojë me të në pajtim me ligjin dhe në përputhje me këtë rregullore.

2.6 Çdo person me të drejtë në pronë më 24 mars 1999, i cili e ka humbur posedimin në atë pronë dhe nuk ka hequr dorë vullnetarisht nga e drejta në pronë, ka të drejtë të marrë vendim nga Komisioni për riposedim të pronës. Komisioni nuk do të pranojë kërkesa për kompensimin e dëmtimeve apo të shkatërrimeve të pronës.

Neni 3

### **RIKTHIMI I PRONËS SË HUMBUR SI PASOJË E DISKRIMINIMIT**

3.1 Asnjë kërkesë për rikthimin e pronës banesore të humbur ndërmjet datës 23 mars 1989 dhe datës 24 mars 1999 si pasojë e diskriminimit nuk mund t'i parashtrahet asnjë gjyqi apo tribunali në Kosovë, me përjashtim të atyre kërkesave që janë në pajtim me Rregulloren 1999/23 të UNMIK-ut dhe këtë Rregullore.

3.2 Kërkesa sipas paragrafit 1.2 (a) (b) ose (c) të Rregullores nr. 1999/23 të UNMIK-ut duhet t'i dorëzohet Drejtorisë para datës 1 dhjetor 2001. Afati për dorëzimin e kërkesave mund të zgjatet me dekret të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, i cili mund:

(a) Të refuzojë zgjatjen e afatit për një kategori të kërkesave konform nenit 5.2

(b) Të caktojë afate të ndryshme për kategori të ndryshme të kërkesave konform nenit 5.2.

3.3 Në rastet kur Komisioni vlerëson se kërkuesi ka të drejtë në rikthimin e pronës, ky Komision do ta caktojë kthimin në lloj, përveç rasteve kur posedimi i pronës është fituar nga ndonjë person fizik nëpërmjet të një transaksionit të vullnetshëm dhe të vlefshëm para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore.

Neni 4

### **RIKTHIMI I TË DREJTËS SË BANIMIT NË BANESA SHOQËRORE TË HUMBURA SI PASOJË E DISKRIMINIMIT**

4.1 Ky nen vlen për çfarëdo të drejte banimi në banesat shoqërore, të cilat janë anuluar si pasojë e diskriminimit.

4.2 Si përjashtim nga neni 3.3, përkitazi me një banesë shoqërore të cilën pastaj e ka blerë pronari aktual nga dhënësi i banesës në shfrytëzim, sipas Ligjit për banim (më tej: "pronari i parë"), do të vlejné rregullat e mëposhtme:

(a) Paraqitësi i kërkesës ka të drejtë pronësie mbi banesën mbasi t'ia ketë paguar Drejtorisë:

(i) Çmimin e blerjes së banesës, i cili figuron në kontratën e shitjes të bërë nga pronari i parë, ose

(ii) Çmimin me të cilin paraqitësi i kërkesës do të kishte pasur të drejtë ta blente banesën, sipas Ligjit mbi banesat, sikur të mos kishte diskriminim (çfarëdo çmimi të cilin Drejtorja e vlerëson si më të vogël), plus një përqindje të vlerës

aktuale të banesës në treg, të përcaktuar nga Drejtoria, si dhe koston e çdo përmirësimi që ka bërë në banesë pronari i parë.

(b) Për ta gëzuar të drejtën e kthimit në lloj, paraqitësi i kërkesës duhet t'ia paguajë Drejtorisë shumën nga paragrafi 4.2(a) në afat prej 120 ditësh pas vendimit të Komisionit për të drejtën e kthimit. Me kërkesë të paraqitësit të kërkesës, Drejtoria mund ta zgjasë afatin deri në 120 ditë të tjera, nëse paraqitësit të kërkesës kjo do t'i shkaktonte vështirësi financiare. Me të paguar të kësaj shume, Komisioni lëshon vendimin me anë të të cilit paraqitësi i kërkesës shpallet pronar i banesës.

(c) Paratë e paguara në pajtim me paragrafin 4.2(b) i mban Drejtoria në një fond të besuar. Pronarit të parë, i cili shpronësohet nga banesa, pas parashtrimit të kërkesës në bazë të këtij neni Drejtoria ia kompenson shumën nga fondi i besuar, të cilën ai/ajo e ka paguar për blerjen e banesës dhe një përqindje nga vlera aktuale e banesës në treg, të përcaktuar nga Drejtoria, si dhe shpenzimet e çfarëdo përmirësimi që ai/ajo e ka bërë në banesë. Çdo detyrim i mbetur i Pronarit të Parë sipas Ligjit mbi banesat anulohet.

4.3 Përjashtimisht nga dispozitat e nenit të mësipërm, asnjë person, të drejtat e të cilit janë shkelur nga vendimi i Komisionit që përcakton kthimin në lloj nuk ka të drejtë në kurrfarë kompensimi.

4.4 Çdo paraqitës i kërkesës për të cilin Komisioni vlerëson se ka të drejtë në rikthimin e banesës shoqërore, por të cilit nuk i është caktuar kthimi në lloj në pajtim me nenin 4.2, i lëshohet një certifikatë nga Drejtoria në të cilën shënohet vlera aktuale e banesës në treg dhe gjendja e saj aktuale, duke zbritur këtu shumën të cilën paraqitësi i kërkesës do të duhej ta paguante për blerjen e banesës sipas Ligjit mbi banesat. Drejtoria i cakton rregullat për përcaktimin e këtyre shumave dhe të shumave të theksuara në nenin 4.2 (a) dhe (c).

4.5 Çdo person me certifikatë të lëshuar sipas nenit 4.4 të mësipërm ka të drejtë në kompensim të arsyeshëm, të barabartë me shumën e shënuar në certifikatë, e cila paguhet nga fondet që mund të grumbullohen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës ose në çdo fond të krijuar për këtë qëllim prej kësaj rregulloreje. Mënyra e llogaritjes dhe e pagesës do të përcaktohen me akt të veçantë juridik.

Neni 5

#### **KUFIZIMET LIDHUR ME DISPONIMIN E BANESËS DERI NË ZGJIDHJEN E KËRKESËS PËR KTHIM**

5.1 Ky nen ka të bëjë me çdo person i cili e ka blerë një banesë nga dhënësi i banesës në shfrytëzim në pajtim me Ligjin mbi banesat, ku as ai person e as ndonjë anëtar i familjes së tij nuk ka qenë bartës i të drejtës së banimit në banesë para datës 23 mars 1989.

5.2 Deri në fund të afatit të caktuar në nenin 3.2 të kësaj Rregulloreje ose deri në zgjidhjen e ndonjë kërkesë për banesë të bërë sipas kësaj Rregulloreje, cilado që të jetë e fundit, personi me të cilin ka të bëjë ky nen konsiderohet posedues i ligjshëm i banesës. Gjatë kësaj periudhe, personi nuk mund t'ia bartë banesën një personi tjetër, përveç rastit kur bartja është pjesë e një zgjidhjeje miqësore të marrë me marrëveshjen e palëve në pajtim me nenin 10.1 të kësaj Rregulloreje. Çdo kontratë për shitje, këmbim ose dhurim, e bërë në

kundërshtim me këtë nen, është e pavlefshme dhe nuk ka forcë ligjore.

Neni 6

#### **NDARJA DHE SHFRYTËZIMI I BANESAVE SHOQËRORE**

Përderisa Drejtoria e ka të drejtën ekskluzive mbi çështjet e parashtruara në paragrafin 1.2 të Rregullores 1999/23 të UNMIK-ut, vlen dispozita e mëposhtme:

(a) Neni 3 i Ligjit mbi marrëdhëniet banesore pezullohet me anë të kësaj Rregulloreje;

(b) Pavarësisht nga dispozitat e çfarëdo ligji tjetër, asnjë e drejtë banimi në banesë shoqërore nuk mund të përfundojë:

(i) Pa pëlqimin e bartësit të së drejtës për banim ose të Drejtorisë për çështje banesore dhe pronësore; ose

(ii) Pa urdhëresën e Komisionit, siç parashtrohet me anë të kësaj Rregulloreje dhe

(c) Përkundër nenit 24 të Ligjit mbi marrëdhëniet banesore, dhënia me qira e banesave shoqërore është e lejuar.

### **KAPITULLI II: RREGULLAT E DREJTORISË PËR ÇËSHTJE BANESORE DHE PRONËSORË**

Neni 7

#### **REGJISTRIMI I KËRKESAVE**

7.1 Drejtoria i regjistron kërkesat sipas paragrafit 1.2 të Rregullores 1999/23 të UNMIKut në zyrat e hapura për këtë qëllim në Kosovë dhe në vende të tjera ku i duket e arsyeshme.

7.2 Kërkesa mund të bëhet nga personi i përcaktuar me paragrafin 1.2 të Rregullores 1999/23 të UNMIK-ut, ose, në rastet kur ky person nuk mund ta paraqesë kërkesën, këtë mund ta bëjë një anëtar i familjes së personit. Sipas kësaj Rregulloreje, anëtarët e familjes së personit caktohen në pajtim me nenin 9 të Ligjit mbi marrëdhëniet banesore.

7.3 Paraqitësi i kërkesës ose pala në kërkesë mund të përfaqësohet nga një person i autorizuar me një akt përfaqësimi të vlefshëm dhe të dhënë në mënyrën e duhur. Në raste të jashtëzakonshme, kur pajisja me akt përfaqësimi është problematike, drejtoria mund të vërtetojë një dokument tjetër që të autorizojë përfaqësimin e paraqitësit të kërkesës.

Neni 8

#### **PËRMBAJTJA E KËRKESAVE**

8.1 Kërkesa bëhet në formularin e përcaktuar nga Drejtoria, duke ofruar të gjitha të dhënat e nevojshme për kërkesë, të nënshkruar nga Paraqitësi i kërkesës ose personi i autorizuar në prani të nëpunësit përgjegjës të Drejtorisë (më poshtë i quajtur: formulari i kërkesës).

8.2 Paraqitësi i kërkesës duhet t'ia bashkangjesë formularit të kërkesës origjinalet ose kopjet e vërtetuara të çdo dokumenti, të cilat i posedon ai/ajo e që kanë të bëjnë me kërkesën,

dhe të cilat mund t'i marrë nga regjistrat publikë. Drejtoria është e autorizuar t'i vërtetojë kopjet.

8.3 Për kërkesat e përcaktuara në paragrafin 1.2 (c) të Rregullores 1999/23 të UNMIK-ut, kërkuesi mundet, përveç kërkesave të tjera, të bëjë kërkesë për:

(a) Kthimin e posedimit të pronës me qëllim të rikthimit në pronë ose posedimit të saj në pajtim me ligjin;

(b) Vënien e pronës nën administrimin e Drejtorisë deri atëherë kur kërkuesi vendos të kthehet në pronë ose të disponojë me të.

Neni 9

#### **TË DREJTAT E PALËVE PËR KËRKESË**

9.1 Pas pranimit të kërkesës, Drejtoria e njofton banuesin aktual të pronës së kërkuar, nëse ka të tillë, dhe do të bëjë përpjekje të arsyeshme për t'i njoftuar personat e tjerë që kanë interes juridik mbi atë pronë. Në rastet e volitshme, këto përpjekje të arsyeshme do të bëhen në formë të shpalljeve në shpalljet zyrtare të Drejtorisë.

9.2 Palët e kërkesës janë paraqitësi i kërkesës dhe

(a) Çdo shfrytëzues aktual i pronës së kërkuar; dhe

(b) Cilido person tjetër fizik me interes juridik, i cili e lajmëron Drejtorinë për qëllimin e vet për të marrë pjesë në procedurë në afat prej 30 ditësh nga dita e njoftimit për kërkesën nga ana e Drejtorisë në pajtim me paragrafin 9.1. Personi me interes juridik në kërkesë, i cili nuk është njoftuar lidhur me lëndën, mund të pranohet si palë në çdo kohë gjatë procedurës me kusht që lënda të mos ketë marrë vendim përfundimtar.

9.3 Dhënësi aktual ose i mëparshëm i banesës në shfrytëzim i banesës së pretenduar, mund të parashtrijë ose të paraqesë prova lidhur me lëndën. Kushdo që ka pretendime si përfaqësues i dhënësit aktual ose të mëparshëm të banesës në shfrytëzim duhet të dëshmojë para Drejtorisë për identitetin e vet dhe lidhjen me dhënësin e banesës në shfrytëzim. Megjithatë, as Drejtoria e as Komisioni nuk janë të detyruar në asnjë mënyrë të vendosin për çështjet ligjore që kanë të bëjnë me identitetin e dhënësit të banesës në shfrytëzim ose të drejtës për përfaqësimin e dhënësit të banesës në shfrytëzim.

9.4 Lidhur me njoftimin për qëllimin e pjesëmarrjes sipas nenit 9.2, banuesi aktual dhe çdo person tjetër fizik me interes juridik ia bën të ditur Drejtorisë adresën për dërgimin e dokumenteve. Drejtoria i dërgon çdo palë një kopje të formularit të kërkesës.

9.5 Në afat prej 30 ditësh nga pranimi i kopjes së formularit të kërkesës, pala pranuese mund t'i përgjigjet lëndës me formular të përcaktuar nga Drejtoria (tutje: 'Përgjigja në kërkesë'). Në varësi të nenin 21.1, çdo palë duhet t'i paraqesë origjinalet ose kopjet e vërtetuara të çdo dokumenti relevant për kërkesën që pala i posedon, ose që mund t'i marrë nga regjistrat publikë.

9.6 Në Përgjigjen e kërkesës, banuesi aktual mund të kërkojë që nevojat e veta banesore të merren parasysh nga Drejtoria dhe nëse kjo ndodh, ai/ajo duhet t'ia ofrojë Drejtorisë të gjitha informatat relevante për përcaktimin e nevojave banesore të veta.

9.7 Drejtoria u shpërndan kopjet e përgjigjes palëve të tjera në kërkesë. Në raste të volitshme, Drejtoria mund t'u ofrojë palëve ekstraktet në gjuhën që ata e parapëlqejnë për çdo dokument të paraqitur nga çdo palë tjetër. Secila palë mund t'i përgjigjet cilësdo çështje të parashtruar në përgjigje të kërkesës në afat prej 30 ditësh.

9.8 Drejtoria mund të refuzojë ta publikojë çdo informatë që i është paraqitur nga cilado palë qoftë, duke përfshirë identitetin e cilësdo palë a dëshmitari kur kjo është e domosdoshme për hir të sigurisë së cilitdo person.

9.9 Formulari i kërkesës dhe përgjigja në kërkesë mund të paraqiten në gjuhën shqipe, angleze ose serbe.

9.10 Për hir të marrjes së vendimeve të drejta dhe efektive të lëndëve, Drejtoria mundet në rastet specifike ta zgjasë çdo afat ose ta shfuqizojë çdo rregull procedurale në këtë Kapitull, kur ekziston arsye e fortë për këtë dhe kur kjo nuk i paragjykon materialisht të drejtat e asnjërës palë. Megjithatë, edhe nëse ndonjë palë nuk mund të marrë pjesë në procedura ose nuk u bindet rregullave pa pasur ndonjë justifikim të qëndrueshëm për këtë, shqyrtimi i lëndës nuk do të shtyhet.

Neni 10

#### **ZGJIDHJA E KËRKESËS**

10.1 Drejtoria bën përpjekje për t'i zgjidhur kërkesat në mënyrë miqësore nëpërmjet marrëveshjes së palëve. Drejtoria do t'i informojë palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre të përcaktuara me këtë Rregullore dhe mund të ndër marrë çdo lloj hapi që e vlerëson të drejtë për t'i lehtësuar zgjidhjet ose për t'u ndihmuar palëve për zgjidhjen e nevojave banesore. Drejtoria mund të krijojë marrëveshje standarde për zgjidhje të cilat do t'i përdorin palët dhe mund t'i vërtetojë marrëveshjet për zgjidhje.

10.2 Drejtoria mund të bëjë hetime mbi lëndën dhe të mbledhë prova relevante për lëndën nga çfarëdo regjistri të organeve publike, te personi fizik apo juridik. Drejtoria ka të drejtë për qasje të lirë dhe pa pagesë në çdo regjistër në Kosovë që është i rëndësishëm për zgjidhjen e një lënde a për çfarëdo qëllime të tjera verifikuese.

10.3 Drejtoria mund ta hedhë poshtë kërkesën me vendim të shkruar, nëse kërkesa dukshëm del jashtë juridiksionit të Komisionit. Kërkesa mund të hudhet poshtë në çdo fazë të procedurës para Drejtorisë.

10.4 Drejtoria ia paraqet Komisionit çdo lëndë që nuk mund të zgjidhet miqësisht ose përkitazi me të cilën kërkesi e konteston hudhjen poshtë nga ana e Drejtorisë sipas nenit 10.3. Drejtoria mund të përgatisë ekstrakte të parashtrimeve dhe prova, përkthime të provave, si dhe rekomandime për shqyrtim të Komisionit.

10.5 Drejtoria, në cilëndo kohë gjatë procedurës, me kërkesën e cilitdo kërkuar ose me vetiniciativë, mund të rekomandojë që Komisioni të lëshojë masa të përkohshme për mbrojtje

ose çfarëdo direktive a urdhër tjetër të nevojshëm për ta siguruar zgjidhjen e drejtë dhe të shpejtë të kërkesës.

Neni 11

#### **KËRKESAT E PAKONTESTUARA PËR REGJISTRIMIN E TRANSAKSIONEVE JOZYRTARE**

11.1 Për lëndët në paragrafin 1.2 (b) të Rregullores 1999/23 të UNMIK-ut, Drejtoria mund ta lëshojë një urdhër për regjistrimin e transaksionit jozyrtar të kërkuarit në regjistrin përkatës publik nëse:

(a) Kërkesa është e pakontestueshme dhe

(b) Drejtoria është e kënaqur se ka prova të mjaftueshme se kërkuari ka fituar të drejtën e posedimit nëpërmjet një transaksioni jozyrtar ndërmjet datës 23 mars 1989 dhe 13 tetor 1999.

11.2 Urdhëri i Drejtorisë në këtë nen nuk është vendim ekzekutiv mbi të drejtën e pronës dhe nuk ndikon në të drejtat e cilitdo personi për t'i paraqitur Drejtorisë kërkesa të mëtejme sipas nenit 1.2 të Rregullores 1999/23 të UNMIK-ut. Një kërkesë e tillë duhet bërë në afat prej 30 ditësh mbasi të jetë vënë në dijeni vendimi i Komisionit, por jo më vonë se një (1) vit nga data e vendimit të Komisionit. Drejtoria duhet t'i publikojë vendimet e bëra në kuptim të këtij neni.

Neni 12

#### **PRONAT NËN ADMINISTRIMIN E DREJTORISË**

12.1 Drejtoria autorizohet që t'i administrojë ndërtesat banesore të braktisura me qëllim që të mund t'u përgjigjet nevojave banesore të personave të zhvendosur dhe të refugjatëve.

12.2 Drejtoria mund ta lëshojë një urdhër duke vënë, kështu, pronën nën administrimin e vet në cilëndo prej rethanave të mëposhtme:

(a) Me marrëveshjen e palëve për zgjidhjen e kërkesës;

(b) Me kërkesën e paraqitësit të kërkesës, duke e ndjekur vendimin e Komisionit që vërteton të drejtën pronësore të kërkuarit;

(c) Mbas largimit të banuesit aktual, në rast se kërkuari nuk mund ta riposedojë pronën në afat prej 14 ditësh nga dita e njoftimit për përmbarimin e largimit nga banesa;

(d) Kur asnjë kërkesë nuk është paraqitur për pronën dhe prona është ose e zbrazët ose banuesi aktual i pronës nuk kërkon kurrfarë të drejte pronësie mbi atë pronë;ose

(e) Në rast se asnjë kërkesë nuk është paraqitur për pronën me kërkesën e pronarit ose të bartësit të së drejtës së shfrytëzimit të asaj prone.

12.3 Për sa kohë që prona të jetë nën administrimin e Drejtorisë (më tej “prona nën administrim”), të drejtat e posedimit të pronarit ose të bartësit të së drejtës së banimit pezullohen për hir të interesit të përgjithshëm.

12.4 Drejtoria mund të lëshojë leje të përkohshme për të qëndruar në pronën e cila është nën administrimin e saj, varësisht nga kriteret dhe kushtet që ajo i konsideron të arsyeshme. Lejet e përkohshme lëshohen për një afat të kufizuar kohor, mirëpo mund të përsëriten me kërkesë.

12.5 Drejtoria i vendos kriteret për ndarjen e pronave nën administrim mbi baza të përkohshme humanitare.

12.6 Drejtoria mund të lëshojë urdhër për largim nga prona nën administrim gjatë çdo kohe sipas rrethanave të mëposhtme:

(a) Kur banuesi aktual nuk i plotëson kushtet për leje të përkohshme;

(b) Kur leja e përkohshme ka skaduar;ose

(c) Kur bartësi i lejes së përkohshme nuk vazhdon të cilësohet si nevojtar për strehim humanitar ose nuk u përmbahet kriterëve dhe kushteve të lejes së përkohshme.

12.7 Pronari ose bartësi i të drejtës për banim i një banese nën administrim mund t'ia paraqesë kërkesën Drejtorisë me qëllimin e tij/saj për ta kthyer posedimin e pronës. Mbas pranimit të kërkesës së pronarit ose të bartësit të të drejtës për banim, Drejtoria ia lëshon banuesit aktual urdhërin për largim nga banesa duke kërkuar nga ai që ta lirojë pronën në afat prej 90 ditësh dhe nëse banuesi aktual nuk e liron pronën vullnetarisht, Drejtoria e lëshon urdhërin me të cilin e autorizon ekzekutimin e largimit nga banesa. Administrimi i një prone nga ana e Drejtorisë përfundon me riposedimin e pronës nga pronari ose bartësi i së drejtës së banimit.

12.8 Drejtoria bën përpjekje të arsyeshme për ta minimizuar rrezikun e dëmtimit të çdo prone nën administrimin e saj. Drejtoria nuk mban kurrfarë përgjegjësie për asnjë dëmtim të pronës nën administrimin e saj dhe as për humbjen a dëmtimin e përmbajtjeve të saj.

### Neni 13

#### **PËRMBARIMI I VENDIMEVE DHE URDHËRAT PËR LARGIM NGA BANESA**

13.1 Drejtoria ia dërgon një kopje të vërtetuar të vendimit dhe të çdo urdhëri të Komisionit secilës palë në adresën e dhënë sipas nenit 9.4. Vendimi dhe çdo urdhër janë fuqplotë nga data e dërgimit të tyre palës së fundit, përveç nëse vendimi ose urdhëri përcakton ndryshe.

13.2 Drejtoria ia dorëzon shfrytëzuesit aktual të pronës së pretenduar një urdhër të lëshuar nga Komisioni për largim nga ajo pronë. Drejtoria, nëse e sheh të arsyeshme, mund ta shtyjë përmbarimin e urdhërit për largim nga banesa deri në 6 muaj, derisa banuesi aktual ta zgjidhë çështjen e banimit, ose varësisht nga rrethanat tjera që Drejtoria i sheh të arsyeshme. Drejtoria e njofton banuesin aktual si dhe kërkuesin për arsyen e prolongimit.

13.3 Me përjashtim të largimit nga banesa sipas nenit 12.7 ose urdhërit të Komisionit që përcakton ndryshe, urdhëri për largim nga banesa i lëshuar nga Komisioni ose në rastin e pronës nën administrim nga Drejtoria, zbatohet brenda afatit prej 30 ditësh pas dërgimit. Urdhëri për largim nga banesa mund të ekzekutohet kundrejt çdo personi i cili ndodhet në pronë në kohën e ekzekutimit të urdhërit për largim nga banesa.



13.4 Largimi nga banesa ekzekutohet nga nëpunësi përgjegjës i Drejtorisë, me përkrahjen e organeve të rendit. Nëpunësi në fjalë dhe autoritetet duhet ta kenë me vete urdhërin të nënshkruar nga:

(a) Sekretari në rast të urdhërit të Komisioni;ose

(b) Nëpunësi i lartë i Drejtorisë në rast se është lëshuar nga ajo me të cilin e autorizon ekzekutimin për largim nga banesa.

13.5 Gjatë ekzekutimit të urdhërit për largim nga banesa, çdo person që nuk i bindet udhëzimeve të nëpunësit përgjegjës për ta lëshuar pronën, mund të largohet nga organet e rendit. Në rast se edhe pasuria e tundshme largohet, Drejtoria do të bëjë përpjekje të arsyeshme për ta minimizuar rrezikun e dëmtimit ose të humbjes së kësaj pasurie. Drejtoria nuk mban asnjë përgjegjësi për asnjë dëmtim a humbje të pasurisë së larguar.

13.6 Drejtoria e njofton kërkuesin lidhur me datën e caktuar të dëbimit. Pas ekzekutimit të largimit nga banesa, nëse kërkuesi ose banuesi i përkohshëm nuk është i pranishëm për ta marrë në dorë menjëherë posedimin e pronës, atëherë nëpunësi përgjegjës e mbyll me dry banesën dhe e njofton kërkuesin. Çdo person i cili, pa arsytim të ligjshëm futet në banesë duke e thyer atë, mund t'i nënshtrohet largimit nga prona prej organeve të rendit.

Neni 14

#### **KËRKESAT PËR RISHQYRTIM TË VENDIMEVE TË KOMISIONIT**

14.1 Çdo palë në kërkesë ka të drejtë t'ia paraqesë ankesën Komisionit të Drejtorisë për rishqyrtimin e vendimit të Komisionit në afat prej 30 ditësh nga dita e njoftimit për vendimin:

(a) Nëpërmjet paraqitjes së provave përkatëse ligjore, të cilën Komisioni nuk e ka shqyrtuar kur është marrë vendimi;ose

(b) Me arsye se është bërë gabim material në zbatimin e kësaj rregulloreje.

14.2 Çdo person i interesuar, i cili nuk është palë në kërkesë e që mund të ofrojë arsye të fortë pse nuk ka marrë pjesë si palë në kërkesë, mund të kërkojë rishqyrtimin e vendimit të Komisionit 30 ditë mbasi të ketë mësuar për vendimin e Komisionit, por jo më vonë se një (1) vit nga data e vendimit të Komisionit.

14.3 Ekzekutimi i urdhërit të formës së prerë për largim nga banesa ndërpritet nga momenti i dorëzimit të kërkesës për rishqyrtimin e vendimit dhe zgjatë derisa Komisioni të ketë marrë vendim lidhur me atë kërkesë, me përjashtim të rasteve kur Komisioni vendos ndryshe.

Neni 15

#### **BASHKËPUNIMI DHE DELEGIMI**

15.1 Sipas kësaj Rregulloreje me qëllim të kryerjes së funksioneve, Drejtoria mund të bashkëpunojë dhe të marrë informata nga çdo organ ndërqeveritar, qeveritar dhe joqeveritar.

15.2 Drejtoria mund t'ia delegojë cilindo nga funksionet e veta shërbimit përgjegjës

komunal në një ose disa komuna të Kosovës, në varësi të marrëveshjeve për mbikëqyrje, ashtu siç e konsideron ajo të arsyeshme.

Neni 16

#### **RREGULLAT PLOTËSUESE**

Drejtoria mund të miratojë rregulla plotësuese për kryerjen e funksioneve përderisa ato të jenë në pajtim me këtë Rregullore.

### **KAPITULLI III: RREGULLAT E KOMISIONIT PËR KËRKESAT PRONËSORE DHE BANESORE**

Neni 17

#### **RREGULLAT E PËRGJITHSHME TË KOMISIONIT**

17.1 Komisioni mbledhet në sesionet e veta plenare ose në kolegje të tilla siç përcaktohen me nenin 2.2 të Rregullores 1999/23 të UNMIK-ut. Sipas kësaj Rregulloreje, mbasi të jenë krijuar dy ose më shumë kolegje të tilla, nocionet “Komision” dhe “Kryetar” nënkuptojnë “Komisionin” dhe “Kryetarin e Komisionit” në raport me sesionet plenare, si dhe “Kolegji” e “Kryetar i Kolegjit” në raport me kërkesat e shqyrtuara në kolegji.

17.2 Kryetari i Komisionit caktohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm ndërmjet anëtarëve të Komisionit. Nëse Kryetari i Komisionit jep dorëheqje, largohet nga posti ose nuk riemërohet, Kryetari i Kolegjit me shërbimin më të gjatë do të veprojë si Kryetar i Komisionit derisa Kryetari të zgjidhet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm. Për Kolegjet e krijuara pas Kolegjit të parë, Kryetari caktohet nga Kryetari i Komisionit pas konsultimit me anëtarët e Kolegjit.

17.3 Periudha e parë e mandatit për anëtarët e Komisionit është një vit. Anëtarët e Komisionit mund të rizgjedhen nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

17.4 Anëtarin e Komisionit mund ta shkarkojë nga posti Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm përmes rekomandimit të shumicës së anëtarëve të Komisionit për mungesë aftësie profesionale për punë ose për refuzimet e vazhdueshme dhe të pajustificueshme për t'i ushtruar detyrat e punës.

17.5 Anëtari i Komisionit i cili dëshiron të jep dorëheqje duhet:

(a) Ta bëjë këtë duke e paralajmëruar me shkrim Sekretarin dhe kryesuesin e Komisionit plenar të paktën një muaj më parë;

(b) Të vazhdojë me kryerjen e të gjitha funksioneve të veta deri në fund të kësaj periudhe të paralajmërimit varësisht nga neni 17.5 (c);dhe

(c) Të vazhdojë të punojë pas kësaj periudhe të paralajmërimit për qëllimin e kufizuar të finalizimit të cilësdo kërkesë ose grup kërkesash të cilat ende nuk janë shqyrtuar nga anëtari i kolegjit.

17.6 Pa përjashtuar asnjë ligj apo rregullore që ka të bëjë me imunitetin, anëtarët e

Komisionit si dhe anëtarët e personelit të Komisionit dhe të Drejtorisë janë imunë ndaj procedurave penale ose civile për çfarëdo akti të kryer me qëllim të mirë në kuadër të fushëveprimit të detyrave të tyre.

17.7 Sekretari në konsultim me kryetarin e Komisionit cakton numrin dhe datat e sesioneve të tij.

17.8 Selia e Komisionit është Prishtina. Komisioni mund të vendosë të mbajë sesione gjetiu nëse këtë e sheh të arsyeshme. Në rastet përkatëse, këshillimet e Komisionit mund të bëhen përmes mjeteve elektronike.

17.9 Kryetari i Komisionit e drejton punën e Komisionit dhe i kryeson sesionet e tij.

17.10 Komisioni zgjedh zëvendës kryetarin për ta ushtruar detyrën e kryetarit në mungesë të kryetarit.

17.11 Anëtarët e Komisionit të cilët nuk mund të marrin pjesë në sesion ia dorëzojnë me shkrim paralajmërimin sekretarit dhe kryetarit të paktën dy javë para sesionit. Paralajmërimi duhet t'i theksojë arsyet për pamundësinë e pjesëmarrjes.

17.12 Anëtarët e Komisionit shërbejnë vetëm në cilësinë personale. Ata nuk marrin pjesë në asnjë procedurë të kërkesës për të cilën kanë interes personal, apo nëse kanë këshilluar ndonjë palë apo janë të lidhur me të, si dhe në rast se kanë qenë të përfshirë në çfarëdo procesi gjyqësor lidhur me kërkesën, që ndryshon nga ai i Drejtorisë dhe i Komisionit, apo nëse ka pasur rrethana të tjera që mund të ndikojnë në paanësinë e tyre. Në rast të ndonjë dyshimi lidhur me këtë paragraf ose në çfarëdo rrethana të tjera, të cilat mund të ndikojnë në paanshmërinë e anëtarëve për vendosjen e lëndës, atëherë vendos kryetari, ose në rast se paanshmëria e Kryetarit mund të jetë e ndikuar, do të vendosë Zëvendëskryetari.

17.13 Sekretari i Komisionit caktohet nga Drejtori Ekzekutiv i Drejtorisë në konsultim me kryetarin. Sekretari dhe anëtarët e personelit të Komisionit do t'i ofrojnë Komisionit përkrahje administrative, teknike dhe ligjore.

17.14 Në konsultim me kryetarin e Komisionit plenar, sekretari cakton rendin sipas të cilit do të shqyrtohen lëndët nga Komisioni dhe i shpërndan ato nëpër kolegje, duke e marrë parasysh nevojën për evitimin e dukurisë së shpërndarjes së pabarabartë.

17.15 Gjuhët zyrtare të Komisionit janë shqipja, anglishtja dhe serbishtja. Kryetari mund ta lejojë çdo anëtar ose person që paraqitet para Komisionit të flasë në cilëndo gjuhë tjetër.

17.16 Përkthyesit e punësuar nga Drejtoria ose nga Komisioni lidhur me procedurat e Komisionit e japin këtë deklaratë:

“Deklaroj solemnisht se do t'i kryej me besnikëri, paanësi dhe ndërgjegje detyrat e përkthyesit duke respektuar plotësisht fshehtësinë e detyrës”.

Neni 18

#### **SESIONET PLENARE TË KOMISIONIT**

18.1 Në sesionet plenare komisioni vendos mbi rregullat plotësuese të procedurës dhe të

provave në pajtim me nenin 26, dhe njëkohësisht vendos për çdo çështje tjetër që mund t'i përcillet në pajtim me nenin 20.4.

18.2 Kur Komisioni përbëhet nga një kolegji i vetëm, kuorumi për sesionet plenare përbëhet nga dy anëtarë. Vendimi merret në pajtim me nenin 20.3.

18.3 Me themelimin e dy ose më shumë kolegjeve, kuorumi për sesionet plenare do të përbëhet nga shumica e anëtarëve të kolegjit. Vendimi zakonisht merret me konsensus. Nëse nuk arrihet konsensusi, vendimi merret me shumicë votash. Në rast të votave të barabarta, kryetari i Komisionit e ka votën vendimtare, përveç votës që i takon çdo anëtar.

Neni 19

#### **PROCEDURAT E KOMISIONIT**

19.1 Komisioni, konform Nenit 19.2 dhe 19.3, do të vendosë për lëndët në bazë të dokumentacioneve të shkruara dhe të provave.

19.2 Asnjë palë nuk mund të japë prova ose argumente me gojë para Komisionit, përveç nëse Komisioni e fton palën ta bëjë këtë. Marrja në pyetje me gojë bëhet publikisht, me paralajmërim të të gjitha palëve, përveç rasteve kur kryetari cakton ndryshe për arsye sigurie të palëve ose ndonjë rrethane tjetër të veçantë. Procedurat e marrjes në pyetje me gojë mbahen nën udhëheqjen e kryetarit.

19.3 Komisioni mund ta konsiderojë paraqitjen me gojë ose me shkrim nga cilido subjekt ndërqeveritar, qeveritar dhe joqeveritar ose dëshmitar ekspert, për çdo çështje relevante që ka të bëjë me kërkesën.

19.4 Komisioni mund ta caktojë cilindo nga anëtarët e tij për të kryer çfarëdo funksioni të tij, duke përfshirë pjesëmarrjen gjatë provave të dhëna me gojë në çdo vend ku mandej mund t'i raportojë Komisionit.

19.5 Komisioni mund:

- (a) T'i shqyrtojë së bashku kërkesat të cilat nga aspekti juridik dhe i provave janë të njëjta;
- (b) T'ia besojë Sekretarit dhe të punësuarëve të tjerë të Drejtorisë të caktuar për t'i shërbyer Komisionit disa funksione të shqyrtimit të kërkesave dhe provave, të cilat do të mbikëqyren nga Komisioni;
- (c) Të përdorë një qendër kompjuterike për futjen e shënimeve dhe programe e mjete tjera elektronike me qëllim të marrjes më të shpejtë të vendimeve;
- (d) Të ndërmerret çdo mase tjetër për të cilën konsideron se është e përshtatshme për marrjen e shpejtë të vendimeve.

19.6 Në raste të veçanta komisioni mund ta falë mosrespektimin e cilësdo rregull procedurale nga cilado palë ose nga Drejtoria në të mirë të administrimit efektiv të drejtësisë kur ekziston arsye e mjaftueshme dhe në rastet kur kjo nuk e paragjykon materialisht të

drejtën e asnjë pale.

19.7 Para se të vendoset për lëndën, Komisioni mund të lëshojë një urdhëresë të përkohshme në pajtim me këtë Rregullore, të cilën e konsideron të domosdoshme për zgjidhjen e rregullt dhe të shpejtë të lëndës.

19.8 E gjithë procedura para Drejtorisë dhe Komisionit për kërkesat pronësore dhe banesore, duke përfshirë kompletimin dhe paraqitjen e kërkesës si dhe përgjigjen në kërkesë, konsiderohet si procedurë administrative. Dhënia e dëshmive të rrejshme në procedurën nga paragrafi paraprak do të konsiderohet si vepër penale konform nenit 176 të Ligjit Penal të Kosovës (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.20/77, 25/84 dhe 44/84).

Neni 20

#### **KOLEGJET**

20.1. Konform neneve 17.11, 17.12, 20.2 dhe 25.1 për lëndët vendoset në kolegje në përbërje të plotë.

20.2 Kuorumi për seancat e kolegjit është dy anëtarë.

20.3 Vendimet e kolegjit zakonisht merren përmes konsensusit. Në rast se të gjithë anëtarët e kolegjit janë të pranishëm dhe vendimi nuk mund të merret përmes konsensusit, atëherë vendimi do të merret me shumicë votash. Në rast se janë të pranishëm dy anëtarë të kolegjit dhe konsensusi nuk arrihet, kryetari i kolegjit do ta shtyjë marrjen e vendimit mbi lëndën për sesionin e ardhshëm të kolegjit.

20.4 Kolegji ose kryetari i kolegjit mund t'ia përcjellë sesionit plenar të Komisionit çështjet e caktuara lidhur me lëndën për të marrë qëndrim juridik. Vendimet e kolegjit për t'ia përcjellë çështjet e caktuara sesionit plenar të Komisionit do të bëhen në pajtim me paragrafët 20.2 dhe 20.3 të këtij neni.

20.5 Gjatë vendosjes lidhur me ndonjë lëndë apo të përcjelljes së çështjeve të caktuara që kanë të bëjnë me ndonjë lëndë ose jo në sesionin plenar të Komisionit, anëtarët e kolegjit nuk kanë të drejtë abstenimi.

20.6 Kryetari i Komisionit plenar mund ta caktojë përkohësisht një anëtar të kolegjit në një kolegji tjetër kur kjo konsiderohet e domosdoshme për funksionimin e drejtë të Komisionit.

Neni 21

#### **PROVAT**

21.1 Komisioni mund të drejtohet por nuk është i varur nga rregullat për prova të aplikuara në gjyqet vendore në Kosovë. Komisioni mund ta marrë parasysh çdo provë të besueshme, të cilën e konsideron të rëndësishme për lëndën, duke përfshirë këtu provat e paraqitura nga Drejtoria lidhur me besueshmërinë e çdo dokumenti apo protokollit publik.

21.2 Komisioni mund të kërkojë nga Drejtoria që të marrë më shumë informata nga pala ose të bëjë hetime plotësuese.

Neni 22

**VENDIMET E KOMISIONIT**

22.1 Komisioni mund t'ia përcjellë çështjet që kanë të bëjnë me lëndën, por që nuk janë brenda juridiksionit të vet, gjykatës kompetente vendore ose organit administrativ ose këshillit vendimmarrës.

22.2 Komisioni do të jetë i varur nga parimet e përcaktuara në:

(a) Vendimet e veta dhe vendimet e kolegjeve të tjera, përveç nëse ekzistojnë arsye të bindshme për devijim nga ato parime;

(b) Vendimet e sesioneve plenare të Komisionit.

22.3 Komisioni nuk ofron kurrfarë mjeteve juridike përveç atyre që janë përcaktuar me anë të kësaj Rregulloreje.

22.4 Asnjëra palë nuk mund t'i nxjerrë shpenzimet nga cilado palë tjetër lidhur me procedurat para Drejtorisë apo Komisionit.

22.5 Komisioni mund ta kufizojë vendimin për të drejtë të posedimit mbi pronën e kërkuar në rastet kur kjo do të ofronte mjete juridike efektive për lëndën.

22.6 Kur kërkesa është bërë nga anëtari i familjes, i bartësit të drejtës në pronë në pajtim me nenin 6.2 të kësaj Rregulloreje, Komisioni mund të vendos çfarëdo të drejte në pronë në emër të bartësit të drejtës në pronë dhe të lëshojë urdhërin për posedim në të mirë të kërkuar. Një vendim i tillë nuk e përcakton dhe nuk ndikon në asnjë çështje ligjore ndërmjet kërkuar dhe bartësit të drejtës në pronë ose të cilitdo personi tjetër që nuk është palë në pretendim. Mbas vendimit të Komisionit, gjyqet vendore në Kosovë mbajnë juridiksionin për të vendosur çfarëdo çështjeje ligjore që nuk është e vendosur nga Komisioni.

22.7 Në vendimin e vet Komisioni mund:

(a) Të vendosë të drejta të tilla në pronë që nevojiten për zgjidhjen e kërkesës;

(b) Ta jep urdhërin për posedimin e pronës në dobi të cilësdo palë;

(c) Ta urdhërojë regjistrimin e çdo të drejte në pronë në regjistrin përkatës publik;

(d) Kur është e domosdoshme për ta zgjidhur lëndën, t'i ndryshojë kushtet e çfarëdo kontrate të bërë me qëllim për t'iu shmangur ligjit diskriminues në mënyrë që ta pasqyrojë qëllimin e vërtetë të palëve në kontratë;

(e) Ta anulojë çdo marrëveshje për dhënie me qira sa i përket pronës e cila është objekt i një urdhërese nga kjo Rregullore dhe të bëjë urdhëresa plotësuese që do ta mundësojnë anulimin e saj;

(f) Ta refuzojë kërkesën;

(g) Të bëjë çfarëdo urdhërese tjetër të domosdoshme për t'u zbatuar kjo rregullore;  
22.8 Vendimi përmban:

(a) Datën e miratimit;

(b) Emrat e palëve dhe të përfaqësuesve të tyre;

(c) Objektin e kërkesës;

(d) Arsyet e vendimit, duke përfshirë faktet materiale dhe të drejtat pronësore të gjetura nga Komisioni;

(e) Urdhërat e Komisionit.

22.9 Vendimet nënshkruhen nga kryetari duke siguruar se nëse numri i kërkesave të vendosura nga kolegji në sesion është i lartë, kryetari mund ta nënshkruaj një vendim të përbashkët duke i vërtetuar të gjitha vendimet individuale të identifikuara në këtë vendim të përbashkët. Vendimet individuale vërtetohen nga Sekretari. Një kopje e dokumentit origjinal e nënshkruar nga kryetari, e cila i është dërguar Sekretarit me anë faksit, është autorizim i mjaftueshëm për çfarëdo aktiviteti të ndërmarrë konform këtij dokumenti.

22.10 Sekretari do t'i publikojë vendimet e Komisionit ose përmbledhjet e vendimeve.

22.11 Sekretari është i autorizuar t'i ndreqë të gjitha gabimet teknike në vendimin e Komisionit, të cilat nuk e cenojnë materialisht të drejtën e asnjërës palë, nëse kryetari i Komisionit pajtohet me këtë.

Neni 23

#### **PROCEDURA E SHKURTUAR**

23.1 Sipas paragrafit 1.2 (c) e Rregullores 1999/23 të UNMIK-ut, çdo kërkesë e cila është e pakontestueshme mund të shqyrtohet nga Komisioni sipas procedurës së shkurtuar.

23.2 Në procedurën përmbledhëse, Komisioni mund të marrë çfarëdo urdhëri për riposedimin e pronës nëse bindet se ka prova të mjaftueshme se kërkuesi ka pasur posedim të pakontestueshëm mbi pronën para datës 24 mars 1999.

23.3 Vendimi i shkurtuar përmban:

(a) Datën e miratimit;

(b) Emrat e palëve dhe të përfaqësuesve të tyre;

(c) Dispozitat e vendimit në fuqi.

23.4 Neni 23 nuk e ndalon Komisionin për të marrë vendime për ndonjë kërkesë jo kontestuese në mënyrë përmbledhëse.

Neni 24

#### **MASAT E PËRKOSSHME**

24.1 Me rekomandimin e Drejtorisë, në bazë të kërkesës së palës apo në ndonjë bazë tjetër, Komisioni mund të fusë masa të përkohshme të mbrojtjes aty ku ka të ngjarë që, në mungesë të masave të përkohshme, pala mund të dëmtohet në atë mënyrë sa dëmi të mos kompensohet më vonë.

24.2 Në raste të jashtëzakonshme, me rekomandimin e organeve përgjegjëse për ekzekutimin e ligjit dhe kur është e nevojshme të parandalohet kërcënimi i vazhdueshëm i sigurisë publike, masat e përkohshme mund të përfshijnë largimin e banuesit aktual nga prona e kontestuar, kur Komisioni vlerëson se ka prova mbi banimin e pakontestueshëm të mëparshëm të kërkuesit në atë pronë. Urdhëri i largimit nga banesa i lëshuar në pajtim me këtë paragraf mund të ekzekutohet nga organet përkatëse të rendit pa paralajmërim.

Neni 25

#### **RISHQYRTIMI I VENDIMEVE**

25.1 Mbas themelimit të dy ose më shumë kolegjeve të Komisionit, rishqyrtimi i vendimeve bëhet prej një kolegji tjetër nga ai që ka vendosur për kërkesën, përveç nëse Kryetari i Kolegjit i caktuar të shqyrtojë rishqyrtimin në konsultim me Kryetarin e Komisionit përcakton se ajo duhet të shqyrtohet në sesionet plenare.

25.2 Në procedurën e rishqyrtimit, Komisioni ose kolegji i themeluar nga Komisioni shqyrton çdo provë dhe material lidhur me kërkesën e mëparshme dhe çfarëdo dëshmie në lidhje me kërkesën për rishqyrtim. Komisioni ose kolegji përkatës ose e hudhë poshtë kërkesën për rishqyrtim ose lëshon një vendim të ri për atë kërkesë.

Neni 26

#### **REGULLAT SHITESË**

Komisioni mund të miratojë rregulla plotësuese për ekzekutimin e funksioneve të veta, përderisa ato janë në pajtim me Rregulloren.

### **KAPITULLI IV: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

Neni 27

#### **ZBATIMI**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerrë urdhëresa administrative për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 28

#### **LIGJI NË FUQI**

Kjo rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.



Neni 29  
**HYRJA NË FUQI**

Kjo rregullore hyn në fuqi më 31 Tetor 2000.

*Bernard Kouchner*  
*Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm*

## ANEKSI III

### RREGULLA SHITESË TË KOMISIONIT PËR KËRKESA

#### PRONËSORE DHE BANESORE

Rregullat si vijojnë janë përpiluar nga Komisioni për Çështje Pronësore dhe Banesore në kuader të alinesë 26 të Rregullores nr.2000/60 mbi Kërkesat Pronësore Banesore dhe Rregullat e procedurës dhe të evidences të Drejtoratit për Çështje Pronësore dhe Banesore dhe të Komisionit për Kërkesat Pronësore:

##### Rregulla 1 Definicioni

Në këto rregulla, përveq nëse përmbajtja tregon ndryshe-

“Komisioni” është Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore i themeluar sipas nenit 2 të Rregullores 1999/23, i cili parasheh se “Komisioni” dhe “ Kryetari” janë “Komisioni” dhe “Kryetari i Komisionit” sa i përket seancave plenare, dhe “kolexhi” dhe “Kryetari i kolexhit” sa i përket seancave të kolexhit;

“Drejtorati” është Drejtorati për Çështje Pronësore Banesore i themeluar sipas nenit 1 të Rregullores 1999/23 mbi themelimin e Drejtoratit për Çështje Pronësore Banesore dhe Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore;

“Kolexh” është kolexhi i Komisionit i themeluar sipas nenit 2.2 të Rregullores 1999/23;

“Sekretar” është Sekretari i Komisionit;

“Rregullorja 1999/23” është Rregullorja 1999/23 mbi themelimin e Drejtoratit për Çështje Pronësore Banesore dhe Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore;

“Rregullorja” do të thotë Rregullorja nr.2000/60 mbi Kërkesat Pronësore Banesore dhe Rregullat e procedurës dhe të evidences të Drejtoratit për Çështje Pronësore dhe Banesore dhe të Komisionit për Kërkesat Pronësore:

##### Rregulla 2 Udhëzimi i çështjeve

2.1 Një kërkesë, kërkesa për këshillë, për masa të përkohshme ose për rishqyrtim, e cila është e gatshme për shqyrtim nga Komisioni, duhet t'i referohet Sekretarit.

2.2 Në rastet kur kërkesat e kategorisë B dhe C paraqiten të dyja për të njejtën pronë, kërkesat duhet t'i referohen Komisionit për vendim si një përjashtim ndaj juridiksionit të Drejtoratit në lidhje me kërkesat e kategorisë B sipas nenit 11.1 të Rregullores 2000/60.

### Rregulla 3 Mendimet

3.1 Drejtorati mund të kërkoj prej Komisionit që të ofrojë një këshillë mbi interpretimin e:

- a). Rregullores 2000/60;
- b). Rregullores 1999/23; ose
- c) këtyre rregullave.

3.2 Kërkesa për këshillë duhet të:

- a). të bëhet jo më vonë se 14 ditë para seancës së ardhshme të Komisionit ose ndonjë kolexhi të Komisionit;
- b) të identifikoj çështjen ligjore për zgjidhje;
- c). të sqaroj se si do të ndikon interpretimi potencial i ndryshëm i dispozitës në fjalë në punën e Drejtoratit;
- d). të cekë nëse të drejtat e ndonjë pale në kërkesën aktuale ose në ndonjë kërkesë të paraparë para Drejtoratit ose Komisionit mund të afektohen nga opinioni; dhe
- e). të jepë arsye pse dispozita në fjalë nuk duhet të pret interpretimin në kontekstin e një kërkesë.

3.3 Kryetari përcakton nëse kërkesa do të shqyrtohet në një kolexh ose në një seancë plenare të Komisionit.

3.4 Komisioni mund-

- a). të kërkoj informata plotësuese ose shkresa lidhur me aplikacionin, ose para Seancës së Komisionit ose gjatë Seancës e cila e shqyrton aplikacionin;
- b). refuzojë të jep këshillën e kërkuar;
- c). të jep këshillë;
- d). kufizojë këshillën në pikpamjen preliminare; dhe
- e). bëjë rekomandim të tillë nëse mendon se është e duhur në ato rrethana.

Rregulla 4  
Masat e përkohshme

4.1 Paraqitësi I kërkesës ose një person tjetër i cili, ose agjencioni i cili, kërkon masa të përkohshme të mbrojtjes sipas nenit 24 të Rregullores 2000/60 duhet të kompletoj dhe të paraqes pranë Drejtoratit një formular, të përcaktuar nga Drejtorati, duke inkorporuar një deklaratë betimi e cila parasheh si vijon:

- a). bazat ,mbi të cilat kërkohen masat e përkohshme
- b). çfarë dëmi parashihet i cili më pas nuk mund të kompenzohet;
- c). në çështjen që I referohemi nenit 24.2, natyrën e kërcënimit ndaj sigurisë publike dhe dëshmit mbi banimin e pakontestueshëm të mëparshëm të paraqitësit të kërkesës.

4.2 Drejtorati mund ta refuzojë kërkesën për masa të përkohshme, e cila është dukshëm pa merita, përveq nëse kërkesa është bërë sipas nenit 24.2.

4.3 Në rastin kur Drejtorati mendon se kërkesa nuk është dukshëm pa merita, ose në rastin kur kërkesa është bërë në pajtim me nenin 24.2, duhet të :

- (a) njoftohet kryetari përmes kryesekretarit;
- (b) përpunohet kërkesa në përputhje me rregullat; dhe
- (c) kërkesa t'i referohet Komisionit për vendim.

4.4 një rekomandim për Komisionin që të aprovohet një masë e përkohëshme duhet të shoqërohet me të gjithë dokumentacionin përkatës, duke përfshirë:

- (a) kërkesën;
- (b) rekomandimin dhe arsyen për për të;
- (c) në rastet kur nuk ka palë të interesuara, arsyet lidhur me këtë vendim;
- (d) në një çështje të cilës i referohemi në nenin 24.2 të Rregullores 2000/60, ndonjë rekomandim të agjensive për zbatimin e ligjit; dhe
- (e) një projekt vendim .

4.5 Kryetari i Komisionit në konsultim me kryesekretarin, e përzgjedhë një kolegji, që ta shqyrtojë kërkesën dhe të vendosë procedure për udhëheqjen e mëtutjeshme të çështjes për shkak të urgjencës.

4.6 Komisioni –

- (a) Mund të refuzojë që të urdhërojë ndonjë masë të përkohëshme;
- (b) Mund të japë urdhër për masa ndryshe nga ato që janë kërkuar ;
- (c) Mund ti aprovojë masat e kërkuara në vartësi të kushteve ; dhe

- (d) Duhet , në rastin kur janë urdhëruar masat e përkohëshme pa ua dhënë mundësinë palëve të interesuara që të përgjigjen në kërkesën origjinale, që ta parashikojë në urdhërin e vet për anulim ose amendament të masave të përkohëshme, me kërkesën e ndonjë pale të interesuar , nëse ka ndonjë arsye të fortë për të vepruar ashtu.

Rregulla 5  
Kërkesat për rishqyrtim

5.1 Cilido person i cili e kërkon rishqyrtimin e vendimit të Komisionit në përputhje me-

- (a) Nenin 14.1 të Rregullores 2000/60, duhet të regjistrojë kërkesën e cila të përfshin-
- (i) Detajet e personit i cili ka bërë kërkesë për rishqyrtim, palët e tjera të interesuara dhe pronën në fjalë; dhe
  - (ii) Dëshmitë të cilat nuk janë shqyrtuar më parë nga Komisioni; dhe
  - (iii) Arsyet pse dëshmitë nuk janë prezantuar përpara Komisionit, në rastin e kërkesës të cilës I referohemi në nenin 14(1)(a) të Rregullores 2000/60; ose
  - (iv) Baza mbi të cilën pohohet se Komisioni ka gabuar, në rastin kur kërkesa është referuar sipas nenit 14(1)(b) të rregullores 2000/60.
- (b) neni 14.2 I rregullores 2000/60, duhet të paraqes kërkesë sipas formës së përcaktuar nga Drejtorati, duke përfshirë detajet në vijim-
- (i) personin I cili kërkon rishqyrtim, palët tjera të interesuara dhe pronën në fjalë;
  - (ii) kur, për herë të parë, personi I cili kërkon rishqyrtim, ka kuptuar për kërkesen origjinale dhe shkaqet pse ai/ajo nuk ka marr pjesë në procedurën lidhur me kërkesën origjinale; dhe
  - (iii) bazat në të cilat ai/ajo kërkon rishqyrtimin e vendimit të Komisionit.

5.2 Drejtorati duhet të –

- (a) pranoj dëftesën mbi kërkesën e bërë me shkrim; dhe
- (b) t'i njoftoj palët tjera mbi kontestin e kërkeses për rishqyrtim, përvec nëse përcaktohet nga Sekretari, se kontesti është dukshëm pa merita.

5.3 Secila palë që dëshiron të kundërshton kërkesen për rishqyrtim duhet të paraqes përgjigjen e kërkeses për rishqyrtim në form të përcaktuar nga Drejtorati jo më vonë se 15 ditë pas njoftimit për kërkesën.

5.4 Nëse kërkesa e paraqitur është formalisht e titulluar si “rishqyrtim” ose ankesë”, ose përmbajtja e shkresës esfidon vendimin e Komisionit, dokumenti duhet t'i referohet Sekretarit.

5.5 Kërkesat të cilat nuk janë të titulluara si “rishqyrtim” ose “ankesë” dhe nuk e sfidojnë vendimin e Komisionit nuk konsiderohen si kërkesa për rishqyrtim sipas nenit 14 të UNMIK/REG/2000/60. Drejtorati mund të ndërmerr ndonjë veprim përkates mbi shkresat e tilla.

- 5.6 Nëse Sekretari përcakton se kërkesa e referuar nga Drejtorati është dukshëm pa merrita, vendimi duhet të merret duke e refuzuar kërkesën mbi këto baza.
- 5.7 Vendimi I referuar sipas nenit 5.6 do të rishqyrtohet dhe do të nënshkruhet nga Kryetari i Komisionit gjatë ose ndërmjet seancave të Komisionit. Nëse numri I kërkesave të zgjidhura në vendim është i madh, Kryetari mund të nënshkruaj vendimin grupor duke I zgjidhur të gjitha kërkesat individuale të identifikuar në vendimin grupor.
- 5.8 Nëse Sekretari përcakton se kërkesa nuk është dukshëm pa merrita, kërkesa duhet të hulumtohet nga Drejtorati.
- 5.9 Nëse Drejtorati rekomandon që kërkesa të refuzohet, ai duhet t'ia referojë kërkesën Komisionit së bashku me raportin referues dhe dokumentet shtesë të përcaktuara nga Komisionit.
- 5.10 Nëse Drejtorati rekomandon që kërkesa të aprovohet, ai duhet t'ia referojë kërkesën Komisionit së bashku me projekt vendim dhe dokumentet shtesë të përcaktuara nga Komisioni.
- 5.11 Kryetari duhet t'i raportojë Komisionit në Seancen e ardhshme të tij lidhur me të gjitha vendimet e marra ndërmjet seancave sipas rregullës 5.7.

#### Rregulla 6

#### Ekzekutimi i Vendimeve të Komisionit

6.1 Pas skadimit të periudhës 30 ditëshe të dhënë në nenin 13.3 të Regullores 2000/60, Sekretari duhet të lëshojë urdhër për dëbim.

6.2 Urdhëri për dëbim duhet të jetë në formularin e përcaktuar nga Sekretari, dhe duhet të përfshij:

- (a) numrin dhe datën e Vendimit të Komisionit që kërkon ekzekutimin;
- (b) numrin e kërkesës;
- (c) numrin e urdhërit;
- (d) emrat e palëve në kërkesë;
- (e) adresën e pronës;
- (f) datën kur vendimi i është dërguar palës që të dëbohet;
- (g) datën e lëshimit;
- (h) nënshkrimin e Kryesekretarit;
- (i) vulën e Komisionit; dhe
- (j) një hapësirë për nënshkrim dhe një hapësirë për shënime lidhur me hapat e ndërmarrë sipas urdhërit të zyrtarit ekzekutiv;

Rregulla 7  
Deklaratat nën betim

Secili person që jep deklaratë nën betim për qëllimet e këtyre rregullave apo për ndonjë qëllim tjetër në lidhje me procedurat para Komisionit, do ta bëjë ate para një zyrtari të Drejtoratit, duke deklaruar si vijon:

“Unë solemnisht deklaroj se përmbajtja e kësaj deklarate është e vërtetë, dhe se unë nuk kam falsifikuar apo ndryshuar në mënyrë të paligjshme asnjë dokument, të bashkangjitur në këtë deklaratë.”

Rregulla 8  
Kopjet e vërtetuara

Komisioni do ta pranojë si kopje të vërtetuar të origjinalit –

- (a) secilin dokument të vërtetuar nga Drejtorati, si kopje e vërtetë e origjinalit, sipas nenit 8.2 të Rregullores 2000/60; dhe
- (b) secilin dokument që është i vërtetuar sipas Ligjit mbi Vërtetimin e Nënshkrimeve, Dorëshkrimeve dhe Kopjeve (Gazeta Zyrtare SAPK Nr. 37/71).

**ANEKSI IV**  
**DREJTORET EKZEKUTIV TË HPD-SË DHE KRYESEKRETARËT**

**Drejtorët Ekzekutiv**

Daniel Lewis, (Ushtrues I Detyrës), 2000-korrik 2001  
Lynn Hastings, (I emruar), Korrik 2001 – korrik 2002  
Knut Rosandhaug, (Ushtrues I Detyrës), gusht 2002 – nëntor  
Martin Drake, (I emruar), nëntor 2002 – nëntor 2003  
Jay Carter, (Ushtrues I Detyrës), dhjetor 2003 – mars 2004  
Knut Rosandhaug, (I emruar), prill 2004 deri më tani

**Kryesekretarët**

Sandra Baffoe-Bonnie  
Emmanuel Cole  
Grete Dahlgard Berntzen  
Jenna Mace  
Monica Furustol  
Charles Ehrlich  
Kathinak Both  
Adam Juszczak  
David Chikovani  
Tove Nilsen  
Geir Johansen  
Beshir Islami  
Geir Johansen

Christine Buchman



## ANEKSI V

### STATISTIKAT E KËRKESAVE DHE VENDIMEVE

#### Kërkesat e zgjidhura

<b>Kategoria A</b>	<b>1205</b>
<b>Kategoria B</b>	<b>365</b>
<b>Kategoria C</b>	<b>25283</b>
<b>Totali</b>	<b>26853</b>
<b>Vendimet e ndryshuara</b>	<b>-63</b>
<b>Numri total i vendimeve të shkallës së pare të HPCC</b>	<b>26790</b>

#### Kërkesat për Rishqyrtim

<b>Kërkesa për Rishqyrtim</b>	
<b>E refuzuar/qartësisht pa meritë</b>	<b>3371</b>
<b>Kërkesa për rishqyrtim e aprovuar</b>	<b>1134</b>
<b>Totali</b>	<b>4505</b>
<b>Vendimet e ndryshuara</b>	<b>-25</b>
<b>Numri total i vendimeve rishqyrtuese të HPCC-së</b>	<b>4480</b>

#### Vendimet

<b>Vendimet e Shkallës së Parë</b>	<b>266</b>
<b>Vendimet rishqyrtuese</b>	<b>95</b>
<b>Totali</b>	<b>361</b>